

1 E martë, 25 qershor 2024

2 [Seancë e hapur]

3 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

4 [I akuzuari Krasniqi merr pjesë përmes
5 videolidhjes]

6 --- Seanca fillon në orën 09.00

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sekretar i
8 seancës, ju lutem paraqisni lëndën.

9 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar
10 Gjykatës. Kjo është çështja KSC-BC-2020-06, Prokurori i
11 Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep
12 Selimit dhe Jakup Krasniqit. Ju faleminderit.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vërej për
14 procesverbal që të gjithë të akuzuarit janë të pranishëm në
15 sallën e gjyqit me përjashtim të z. Krasniqi, i cili ka marrë
16 leje për të na ndjekur mes videolidhjes. Sikurse dhe Gjykatësi
17 Barthe po na ndjek për arsye personale përmes videolidhjes.

18 Sot do të vazhdojmë me dëshminë e Dëshmitarit 4744.

19 Por përpara se të bëjmë këtë, më duket se z. Roberts
20 kishit diçka të thënë.

21 Z. ROBERTS: [Përkthim] Po, shkurtimisht, por duhet të
22 kalojmë në seancë private në mënyrë që të bëjë parashtrimet e
23 mia shkurtimisht.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
25 Kalojmë në seancë private.

1 [Seancë private]

2 [Seancë private teksti i fshirë]

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14 [Seancë e hapur]

15 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

16 [Dëshmitari hyn në sallën e gjyqit]

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëmëngjes,

18 z. Fondaj.

19 DËSHMITARI: Mirëmëngjesi.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Urojmë të

21 keni pushuar pak.

22 DËSHMITARI: Faleminders.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sot do të

24 vazhdojmë me kundërpjetjet, z. Misetic ka ende pyetje ju,

25 kështu që seanca do të filloj me z. Misetic.

1 Z. Misetic, fjala është për ju.

2 DËSHMITARI: KURTESH FONDAJ [Vijon]

3 Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic:

4 [Vazhdim]

5 Z. MISETIC: [Përkthim]

6 PY. Mirëmëngjes, Dëshmitar nga ana ime.

7 PË. Mirëmëngjesi.

8 PY. Kam një aspekt për të cilin do të doja të më jepje disa
9 sqarime dhe me këtë do të përfundoj.

10 Dua të flasim intervistën që keni dhënë për ZPS-në.

11 Z. MISETIC: [Përkthim] Dhe këtë do të doja që intervista
12 dhe në anglisht dhe në shqip të shfaqej në ekran. Bëhet fjalë
13 për materialin me numër P01327.6, faqja 12 në anglisht, e
14 njëjta gjë dhe në shqip.

15 PY. Dëshmitar, do të jap një herë kontekstin. Prokuroria ju
16 ka bërë disa pyetje lidhur me disa akuza që ka bërë Halil
17 Qadraku për ju personalisht dhe për FARK-un dhe ju i keni
18 dhënë një dokument ZPS-së, që besoj më duket se e kishte
19 përgatitur Halil Qadraku.

20 Z. MISETIC: [Përkthim] Ju lutem tek anglishtja tek
21 rreshti 18. Në shqip fillon tek rreshti 23 dhe kalon tek faqja
22 tjetër.

23 PY. Megjithatë pyetja ka qenë kjo:

24 "Është një akuzë këtu që keni qenë FARK-ist apo të paktën
25 duket sikur ju keni qenë anëtar i FARK-ut, kështu? Dhe në një

1 farë forme ju keni qenë shumë më i mirë për ta. A mund të na
2 tregoni diçka më shumë për këtë”.

3 Tek rreshti 18 tek anglishtja dhe 23 shqipja ju i keni
4 thënë:

5 “Pjesërisht. Dhe në këtë periudhë realisht kemi dasht që
6 ministria të ketë qenë Ministria e Mbrojtjes dhe e Qeverisë,
7 nuk kishte rëndësi se kush e drejtonte. Prandaj e kanë
8 interpretu në këtë formë.”

9 Së pari, a mund të na shpjegoni çfarë keni dash të thonit
10 që ju donit që ushtria të ishte Ministri e Mbrojtjes dhe e
11 Qeverisë dhe nuk kishte rëndësi se kush e drejtonte, dhe ma
12 merr mendja kur keni thënë “ushtri” e keni pasur fjalën për
13 UÇK-në. A mund të na e shtjelloni diçka më shumë këtë?

14 PË. Po, z. Avokat. Është e vërtetë se ka ekzistue formacioni
15 UÇK dhe fillimisht ka ekzistue edhe Ministria e Mbrojtjes në
16 Qeverinë Bukoshi. Mirëpo edhe informacionet, pra, që janë
17 vepru në kuadër të Ministrisë së Mbrojtjes janë quajt FARK,
18 pra, Forcat e Armatosura të Republikës së Kosovës.

19 Në periudhën tetor, nëntor, ka pas iniciativa edhe goxha
20 shumë përpjekje që këto dy subjekte ushtarake të unifikohen në
21 një. Dhe gjatë fazës së muajit nëntor është arrit një
22 marrëveshje ushtarake për unifikim të ushtrisë.

23 Për sa i përket me, unë si pjesëtar i FARK-ut nuk kam
24 qenë kurrë. Unë kam qenë pjesëtar i Ushtrisë Çlirimtare të
25 Kosovës.

1 Po edhe dje gjatë intervistave e përmenda që ushtria --
2 se FARK-u, respektivisht Forcat e Armatosura të Republikës së
3 Kosovës në territorin e Kosovës kanë veprue si njësi e UÇK-së.
4 Pra, ata kanë pas edhe emblemën edhe i kanë raportue Shtabit
5 të Përgjithshëm në nivel të Kosovës, jo edhe Ministrisë së
6 Mbrojtjes. Këtë kur them edhe jo, kjo mundet me qenë me
7 rezervë, mirëpo për atë që i kanë raportue Ministrisë,
8 domethënë, Shtabit të Përgjithshëm kjo është evidente, kjo
9 është më se e vërtetë.

10 Prandaj, pretendimi i Qadrakut mundet me qenë për atë se
11 pak a shumë unë vërtetë kam kërku unifikimin e këtyre dy
12 faktorëve edhe me një farë forme kam qenë si një urë lidhëse
13 ose kam kontribu që në fund të nëntorit në territorin e
14 komunës së Suharekës të kyçen edhe ushtarakë edhe ushtarë që
15 kanë qenë pjesë e njësisë së ish-FARK-ut.

16 Por FARK edhe një herë po e përmendi, ka figuru në
17 Shqipëri, në Kosovë, jo. Prandaj Halili sigurisht këto ka
18 mendu.

19 PY. Në rregull. Përpara se të bëj pyetjen e radhës, fjalia që
20 thotë:

21 "E vetmja që donim ne ishte që ushtria të ishte pjesë e
22 Ministrisë së Mbrojtjes dhe e Qeverisë ...".

23 Kur thua e vetmja gjë që ne donim për kë e kishit fjalën
24 përemri "ne" kujt i referohej?

25 PY. Unë kam pas dëshirë e cila mu është realizu që të jetë

1 një ushtri. Se ajo kujna i raporton dhe qysh i raporton për mu
2 ka qenë pak më rëndësishmja. Me rëndësi ka qenë që të jetë një
3 ushtri dhe në fund ajo dëshirë mu më është plotësu. Edhe
4 realisht unë e kam kërku që edhe jeta në ushtri të jetë
5 institucionale. Për këtë jam përpjek edhe mendoj që ja kemi
6 arrit.

7 PY. Sot paradite, sot në mëngjes, pra, në një nga përgjigjet
8 thatë që ishte arrit një marrëveshje në nëntor për të
9 unifikuar, të bërë një unifikim. Unë dua të di tani pasi u bë
10 marrëveshja në nëntor, sipas teje çfarë marrëdhënie do të
11 kishin forcat e unifikuara tashmë me Ministrinë e Mbrojtjes
12 dhe me Qeverinë Bukoshi?

13 PË. Duke pas parasysh bisedat që unë kam pas me Bislim
14 Zyrapin, ish-shef shtabi, ai më ka thënë se në territorin e
15 Kosovës do të futen forcat që janë nën kontrollin e Ministrisë
16 së Mbrojtjes, por ato në territorin e Kosovës do të sistemohen
17 sipas urdhrave të Shtabit të Përgjithshëm dhe do t'i
18 raportojnë Shtabit të Përgjithshëm edhe kështu ka ndodhë.

19 PY. Po. Po pyetjen e kisha më shumë këtu, në këtë marrëveshje
20 të re ose më saktë kjo marrëveshje si i organizonte këto forca
21 me Ministrinë e Mbrojtjes dhe me qeverinë Bukoshi, pra, forcat
22 që ishin nën Shtabin e Përgjithshëm si do të punonin me
23 qeverinë e Bukoshit dhe Ministrinë e Mbrojtjes sipas kësaj
24 marrëveshjeje?

25 PË. Unë detajet e marrëveshjes nuk i di. S'e kam pas kopjen e

1 marrëveshjes. Por sa i përket dy elementëve që më janë thënë i
2 kam mbajtur mend që marrëveshja ushtarake hyn në fuqi në një
3 datë të caktuar, të cilën e kam harruar dhe pritet marrëveshja
4 politike. Edhe nëse marrëveshja politike nuk arrihet në datën
5 e caktuar, marrëveshja ushtarake hyn në fuqi dhe realisht kjo
6 ka ndodhur.

7 Domethënë, marrëveshja ushtarake ka hyrë në fuqi pa u arritur
8 marrëveshja politike. Marrëveshja politike nuk është arritur
9 kurrë. Këto janë detajet që unë i di për sa i përket këtij
10 dokument. Edhe e di që realisht autoritet për komandë edhe
11 sistemim është Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Çlirimtare të
12 Kosovës, sipas asaj marrëveshjeje.

13 PY. Të bëj një pyetje ndryshe. Ju thatë që:

14 "Ne donim që ushtria të ishte pjesë e Ministrisë së
15 Mbrojtjes e Qeverisë dhe nuk kishte rëndësi se kush do ta
16 udhëhiqte."

17 Mesa keni ju dijeni, UÇK-ja u bë ndonjëherë pjesë e
18 Ministrisë së Mbrojtjes apo e Qeverisë, u inkorporua
19 ndonjëherë?

20 PË. Në kuadër të qeverisë Bukoshi jo. Përkundrazi forcat e
21 ministrisë, ish, domethënë, Ministrisë së Mbrojtjes së
22 Qeverisë Bukoshi u shkrinë në kuadër të UÇK-së.

23 PY. Faleminderit që u përgjigjët pyetjeve të mia.

24 Z. MISETIÇ: [Përkthim] I nderuar Kryegjykatës, me kaq
25 mbyll kundërpjetjet.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Emmerson.

2 Pyetje të palës tjetër nga z. Emmerson:

3 Z. EMMERSON: [Përkthim]

4 PY. Faleminderit, Dëshmitar. Unë pak pyetja kam. Unë mbroj z.
5 Veseli.

6 Z. EMMERSON: [Përkthim] Ju lutem që të dali në ekran
7 materiali P500. Është një dokument që e kemi parë disa herë.

8 PY. Jam i bindur që e njihni që nga ballina këtë dokument,
9 është një shkresë e 14 marsit e nënshkruar nga Sadik Halitjaha
10 dhe Halil Qadraku. Këto dy emra shfaqen.

11 Fillimisht dua t'ju pyes kështu, keni dhënë dëshmi dje se
12 ka pasur dy probleme në veçanti me Qadrakun me sa kishit
13 evidentuar ju pavarësisht fjalën "raportim" paqartësisë me
14 këtë. Po unë dua të jem 100 qind i qartë.

15 Një nga problemet mesa kuptova unë nga dëshmia juaj, ishe
16 fakti që Qadraku kontaktonte drejtpërdrejt ZKZ-të lokale
17 brenda brigadës pa marrë leje paraprakisht nga komandant
18 Drini. E kam kuptua saktë?

19 PË. Pjesërisht, zoti Avokat. Kur bëhet fjalë është më te pa
20 koordinim me komandantët e brigadave në kuadër të të cilave
21 kanë qenë strukturat e ZKZ-së. Kjo ma te qëndron ndërsa
22 çështjet gjithashtu kanë të bëjnë edhe me atë se realisht së
23 paku një prej komandantëve të brigadave kish bë një ankesë te
24 Ekrem Rexha, si komandant zone, se Halit Qadraku shkon dhe i
25 drejtohet punëtorëve, respektivisht ndihmëskomandanti të

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Kurtesh Fondaj (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Emmerson

Faqe 11

1 sektorit për zbulim dhe kundërzbulim, pa e lajmëruë
2 komandantin e brigadës. Dhe kërkon informacion prej tyne po
3 ashtu në mënyrë të pakontrolluar pa ndonjë farë leje apo
4 udhëzimi nga komandanti Ekrem Rexha. Pak a shumë kjo është.
5 PY. Nëse e kuptova qartë, ky nuk ka qenë një rast i vetëm. Po
6 ishte një sjellje e përsëritur prej tij, pra, që ai fliste me
7 përfaqësues të ZKZ-së nga brigadat e ndryshme pa marrë leje
8 paraprakisht nga komandantët e brigadave, edhe pa marrë edhe
9 lejen e Ekrem Rexhës, kështu sikur thatë?
10 PË. Del kjo, ky konkludim. Po megjithatë, unë sa di, kjo
11 çështje u trajtu në një takim që kemi pas në nivel zone, dhe
12 komandanti Ekrem Rexha i ka tërhek vërejtjen që nuk bën të
13 veprojë kësi lloji. Rendi dhe rregulli e kërkon që ai të ketë
14 një leje, respektivisht një shkresë, një urdhër nga komandant
15 zone, komandanti i zonës, në atë urdhër t'i drejtohet
16 komandantit të brigadës edhe ai t'i lejojë komunikimin pastaj
17 me sektorin e ZKZ-së. Kjo ka qenë ajo që e ka kërku Ekremi,
18 Ekrem Rexha. Prandaj edhe në këtë shkresë ky Halit Qadraku e
19 përmend këtë fakt edhe tu e mendue se kjo ka të bëjë me
20 bllokim të punës e jo me vendosje të rendit edhe rregullit
21 ushtarak.
22 PY. Do të flasim edhe për këtë, se e shohim që është një nga
23 ankesat që ka ngritur në këtë dokument. Megjithatë sa i takon
24 këtyre ngjarjeve, domethënë, fakti që ai kontaktonte ZKZ-në pa
25 marrë pëlqimin e drejtuesve në brigada, do të doja të më thoje

1 nga përvoja juaj personale nga Brigada 123, dje në dëshminë
2 tuaj thatë që keni angazhuar Musli Kolollin si pjesë të
3 komandës të Brigadës 123 dhe ai ishte përgjegjës për zbulimin
4 lokal, kështu?

5 PË. Po.

6 PY. Pra, ai ishte një person që emëruat ju? Ishte një
7 zgjedhje e juaja, apo jo?

8 PË. Sigurisht.

9 PY. A ishte e zakonshme kjo që vetë komandantët e brigadave
10 të vendosnin në nivel lokal se kë do të përfshinin në komandën
11 e tyre dhe se kush do të ishte gjegjës për zbulimin, siç bëtë
12 edhe ju?

13 PË. Jo vetëm për zbulimin po për të gjitha resorët. Pra,
14 komandanti i brigadës është autoriteti i cili bën përzgjedhjen
15 e ekipës. Ndërsa vetëm ka kërkuar verifikimin nga strukturat e
16 më larta për atë ekip. Çka dhe dje e përmenda, në rastin tem
17 unë e kam pas autorizimin e plotë me formu pa pas nevojë me
18 kërkuar verifikim se kanë qenë situatat që, domethënë,
19 administrative të panevojshme, respektivisht goxha komplekse
20 në fazën e luftës.

21 PY. Pra, këta nuk ishin persona të zgjedhur prej Shtabit të
22 Përgjithshëm, nuk ishin përzgjedhur nga Shtabi i Përgjithshëm
23 në brigada, apo jo?

24 PË. Duhet parë në fazën sa unë kam qenë komandant brigade
25 ekipën e kam formu unë. Sesi ka funksionue në brigada tjera

1 nuk e di, por në princip ka funksionu njësoj. Po këtë po e
2 përmendim në fazën e janarit, në fund të dhjetorit dhe
3 janarit, domethënë, dhjetorit 1998 dhe janar 1999.

4 Unë kam qenë në ndihmesë edhe të Brigadës 122 edhe
5 Brigadës 124. Edhe atje emërimet nuk janë bë, po unë vendosja
6 e stafit të komandës është bë me pëlqim të komandantit të
7 brigadës edhe realisht pa ndonjë interferencë nga strukturat e
8 më lartë, domethënë, e epërme ose komanduese të nivelit ma të
9 lart.

10 PY. Meqë kjo ishte praktika, atëherë kush i jepte urdhrat,
11 për shembull, në brigadën tuaj, përfaqësuesi juaj i ZKZ-së
12 prej kujt i merrte urdhrat brenda brigadës suaj?

13 PË. Nga komandanti i brigadës.

14 PY. Faleminderit. Dhe kështu ka vazhduar të paktën deri nga
15 janari, apo jo?

16 PË. Kështu kam vepru unë. Po kështu kam bindjen që kanë
17 vazhdu punën edhe ma vonë.

18 PY. Faleminderit. Që të mos kemi asnjë dyshim për
19 transkriptin, kjo është përgjigja juaj sa i takon praktikës së
20 përgjithshme brenda një zone, apo jo?

21 PË. Po. Edhe në fazën derisa unë kam qenë komandant brigade
22 është vepru dhe është punu kësi lloj. Ndërsa për periudhën
23 tjetër e përmendi praktikën, se nuk kam informacion sesi ka
24 rrjedhë dhe a ka pas ndonjë pengesë a problem. S'kam
25 informacion.

1 Po dhe një për çështje të korrektësisë, nëse e bën me e
2 përmend. Këtu kemi të bëjmë me një dokument që është i datës
3 14 mars 1999, kur z. Veseli nuk ka ndodhë në territorin e
4 Kosovës në këtë periudhë. Kështu është, domethënë, mendimi
5 jem.

6 PY. Në fakt nuk të kisha pyetur për vendndodhjen e z. Veseli,
7 po meqë e thatë a mund të na thoni diçka më tej në lidhje me
8 këtë çfarë dini ju për këtë?

9 PË. Jo, vetëm e di se ai nuk ka qenë në territor të Kosovës.
10 Kaq.

11 Sa, ku ka ndodhë e çka, nuk e di.

12 PY. A pranoni ju nëse unë bëj këtë propozim ose më saktë mund
13 të thoni ju diçka më shumë që z. Veseli është larguar nga
14 Kosova në periudhën e vjeshtës shkurtimisht pasi u emërua shef
15 i zbulimit për Shtabin e Përgjithshëm dhe është kthyer në
16 Kosovë diku nga mesi i marsit? Mesa keni ju dijeni, ka qenë
17 kështu?

18 PË. Kur është shku nuk e di, po realisht unë dikun e kam taku
19 atë pas, diku në muajin prill të 1999. Deri atëherë nuk kam
20 qenë në dijeni që është kthy. Dhe kontakti i parë me të ka
21 qenë në muajin prill, në fund të muajit prill.

22 PY. Faleminderit. Të flasim sërish për problemet me Qadrakun.
23 Të gjithë e kemi parë këtë shkresë. Siç thatë edhe ju dje, ka
24 disa ankesa për komandant Drinin, disa për ju. I ka
25 karakterizuar, pra, ka thënë ka pasur ankesa për mënyrën sesi

1 ju vepronit.

2 Së pari, a e kam kuptuar unë drejtë dëshminë tuaj të
3 djeshme se kjo është hera e vetme që keni parë një dokument ku
4 Qadraku i ka shkruajtur drejtpërdrejt Shtabit të
5 Përgjithshëm?

6 PË. Po. Këtë dokument unë pas luftës e kam pa. Nuk e kam pa
7 gjatë fazës së luftës. Edhe, po, është i vetmi dokument.

8 PY. Mendoj se na e thatë dhe dje, por do të doja të na e
9 thonit dhe një herë që ju nuk keni ndonjë provë apo
10 informacion që ai i raportonte Shtabit të Përgjithshëm përveç
11 këtij dokumenti, domethënë, nuk është se dini ndonjë gjë
12 tjetër lidhur me faktin nëse ai i raportonte Shtabit të
13 Përgjithshëm ose me gojë ose në mënyrë tjetër. A e kam kuptuar
14 drejtë këtë pjesë të dëshmisë tuaj, Dëshmitar?

15 PË. Unë nuk kam informacion. Dhe s'di për veprimtarinë edhe
16 punën e tij.

17 PY. Dhe me të drejtë siç na e theksuat dhe dje, arsyeja sepse
18 ju e dini se çfarë ndodhte në nivel brigade ishte se Ekrem
19 Rexha dhe ti vetë u informuat për këto zhvillime nga
20 komandantët e brigadave, apo jo?

21 PË. Ekrem Rexha është njoftu nga komandantët e brigadave dhe
22 e ka ngrit këtë çështje në një takim në nivel zone.

23 PY. Në qoftë se ka pasur biseda midis z. Qadraku dhe ndonjë
24 personi nga Shtabi i Përgjithshëm që nuk kanë qenë me shkrim
25 por kanë qenë biseda me gojë, mund të përcaktohen dy gjëra: Së

1 pari që këto biseda nuk mund të kenë qenë me z. Veseli se z.
2 Veseli nuk ka qenë brenda vendit dhe e dyta, është që ju nuk e
3 dini në qoftë se biseda të tilla kanë ndodhur apo jo.

4 Z. HALLING: [Përkthim] Kundërshtojmë.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem,
6 ndajeni pyetjen.

7 Z. EMMERSON: [Përkthim]

8 PY. Hipoteza apo teoria për të cilën ju bëri pyetje z.
9 Halling lidhet me nocionin se ka pasur një lloj praktike të z.
10 Qadraku që i raportonte Shtabit të Përgjithshëm përtej
11 strukturës raportuese me zinxhirët përkatës. Domethënë, këtë
12 gjë ose këtë lloj propozimi jua bëri Prokurori dje.

13 Besoj që pajtoheni me mua, ose të paktën këtë thatë dje,
14 që çdo gjë është e mundur. Megjithatë, ju nuk e dinit të
15 konstatuar këtë gjë sepse si mund ta dish ti, nga mund ta
16 merrje vesh ti, që anashkalohej udhëheqja, për shembull, dhe
17 që bëhej raportimi drejtpërdrejt dhe jo sipas zinxhirëve të
18 raportimit, apo jo, Dëshmitar?

19 PË. Zoti Avokat, unë nuk kam qenë në dijeni të punës së
20 Qadrakut por vetëm informacionin që e bazoj unë, respektivisht
21 pohimet e mia që i bazoj janë në q'atë dokumentin që ju e
22 mbani në dorë. Asgjë tjetër. Edhe nuk kam dyshu unë që
23 realisht ai nuk po punon ose po punon keq. Por megjithatë nëse
24 i ka bë lëshimet i ka bë për mosdijes, nuk i ka -- edhe
25 realisht kur njëri nuk di atëherë vjen dhe të injoron thotë

1 elemente tjera. Përndryshe, nuk besoj që ka pas ndonjë
2 tendencë të caktume.
3 PY. Megjithatë pavarësisht kësaj, gjëja e dytë për të cilën
4 mund të jemi të sigurt mbështetur në dëshminë tuaj, që edhe po
5 të kenë ngjarë biseda të tilla, këto biseda nuk kanë ndodhur
6 me z. Veseli se z. Veseli nuk ka qenë fare brenda Kosovës në
7 atë kohë, apo jo?

8 Z. HALLING: [Përkthim] Kundërshtojmë sepse mungon
9 themelësia e kësaj pyetjeje.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim]
11 Kundërshtohet. Mund të vazhdoni me pyetjen, z. Emmerson.

12 Z. EMMERSON: [Përkthim]

13 PY. Në qoftë se z. Qadraku do ketë folur në mënyrë private me
14 dikën që ishte anëtar i Shtabit të Përgjithshëm gjatë
15 periudhës përpara sesa të shkruhet kjo shkresa, nuk është e
16 mundur që ai të ketë biseduar me z. Veseli sepse, sikur na e
17 thatë edhe pak më herët, z. Veseli nuk ka qenë në Kosovë në
18 atë kohë. A pajtoheni me mua lidhur me këtë, Dëshmitar?

19 PY. Në princip pajtojna, është e vërtetë se Veseli nuk ka
20 qenë në Kosovë në këtë periudhë.

21 PY. Tema e fundit për të cilën do të doja t'ju pyesja sepse
22 besoj që e keni lexuar dokumentin, nuk është dokument që
23 përmban shumë informacion. Gjykata nuk është se do diskutojë
24 çështje që ngrihen në këtë dokument. Megjithatë dua t'ju bëj
25 këtë pyetje: Ky nuk është një dokument zbulimi ose nuk është

1 se ka informacion inteligjent ose informacion operativ që të
2 shërben diçka, por është thjesht një dokument që të përshkruan
3 ankesat që kanë të bëjnë me funksionimin e brigadës dhe faktin
4 që Qadraku dhe Halitjaha, domethënë, kishin mundësi që ta
5 bënin punën siç e shikonin ata të përshtatshme. A pajtoheni me
6 mua, Dëshmitar, që ky është një përshkrim i dokumentit që kemi
7 përpara?

8 PË. Po realisht ky është edhe i titullume si një deklaratë.
9 Nuk është raport.

10 PY. Ne biseduam për arsyen sepse një dokument mund të jetë
11 dërguar Shtabit të Përgjithshëm në mënyrë të drejtpërdrejt,
12 megjithatë në rastin në fjalë ne kemi të bëjmë me një ankesë
13 komandantin e zonës, pra, është një ankesë për komandantin e
14 zonës dhe për ty, për shembull, që ishe goxha i afërt me të. A
15 pajtohesh me mua që do të ishte befasuese në qoftë se anëtarët
16 e vartës të shtabit, domethënë, anëtarët e varësisë së shtabit
17 do të bënin një ankesë dhe do ankoheshin për komandantin për
18 të cilin janë ankuar, domethënë, a do ishte befasuese që
19 dikush nga anëtarët e shtabit ta bënte këtë ankesë në emër të
20 personave që përmban shkresa?

21 Doni që ta bëj ndryshe pyetjen apo e kuptuat, Dëshmitar?

22 PË. Ndoshta e kam kuptu. Po është ndoshta më mirë ma bë edhe
23 pak më ndryshe pyetjen.

24 PY. Ajo çfarë po them unë është kjo: Ky është dokument i cili
25 është paraqitur si informacion inteligjent që i është dhënë

1 Shtabit të Përgjithshëm. Por në realitet, ky nuk është
2 informacion inteligjent, nuk është informacion zbulimi, por
3 është një ankesë për komandant Drinin dhe për persona të tjerë
4 që ishin pranë tij. Mund të jetë ankesë e pajustificuar, po në
5 fund të ditës është një ankesë e mirëfilltë që ka të bëjë me
6 udhëheqjen e zonës operative, konkretisht është një ankesë
7 ndaj Ekrem Rexhës.

8 Për pasojë, pyetja që kam për ty është kjo: A pajtohesh
9 me mua që ka shumë gjasa që dikush nga radhët e personave që
10 është ankuar kundër Ekrem Rexhës mund të kërkonte që këtë
11 ankesë ta merrte? Pra, me fjalë të tjera, në qoftë se unë
12 ankohe për eprorin tim, për shefin tim, personi që mund të
13 ankohe unë për këtë është ky person, domethënë, eprori im ose
14 shefi im, por, domethënë, nuk ka vlerë që t'ia dërgoj ankesën
15 këtij personi dhe si rezultat e dërgoj në instanca më të
16 larta. Nuk e di në qoftë se jam i qartë, apo jo, Dëshmitar?

17 Po mund të mundohem ta shpreh dhe ndryshe në qoftë se nuk
18 e kuptuat pyetjen. Ekziston dhe një shpjegim alternativ sepse
19 Halil Qadraku dhe Halitjaha mund t'ia kenë drejtuar këtë
20 Shtabit të Përgjithshëm dhe kjo arsye është që kanë dashur të
21 ankohen së tepërmi për komandantin e zonës. Dhe ata mund të
22 kenë pasur të njëjtën qasje si persona të tjerë që nuk ia vlen
23 që ti ankesën t'ia drejtosh personit ndaj të cilit ti ke
24 ankesë, domethënë, duhet ta çosh diku tjetër, nuk ia vlen që
25 ankesën t'ia japësh atij personi me të cilin ti nuk je i

1 kënaqur, a më kuptove, Dëshmitar?

2 PË. Po, z. Avokat, e kuptova. Por edhe në këto raste, ankesa
3 është dashtë me u drejtue shefit të shtabit, në rast se kemi
4 të bëjmë me ankesë. Ndërsa kjo nuk i atribuohet shefit të
5 shtabit, por edhe në fund të listës përmenden disa persona që
6 janë pjesë, domethënë, e ekipës së zonës operative të
7 Pashtriku, në mënyrë tinzare që dokument sot mundet me pas
8 peshë shumë të madhe për fakt se emna janë aty. Por është
9 pikëpyetje e madhe nëse ata kanë qenë në dijeni të përpilimit
10 të kësaj shkrese.

11 PY. Në rregull. Në qoftë se do e shikojmë në ndonjë tjetër
12 këndvështrim, kjo ishte në shkelje të protokollit që të paktën
13 duhet të ishte dërguar kjo si ankesë shefit të shtabit,
14 megjithatë, sikurse na e thatë pak më herët, një prej tipareve
15 kryesore të Halitjahës dhe Qadrakut ishte që ata dukej sikur
16 nuk e njihnin procesin ose të paktën nuk e njihnin ashtu siç
17 ishte në realitet ose siç duhet të ishte procesi, a është e
18 vërtetë kjo, Dëshmitar?

19 PË. Këto janë edhe dyshimet e mia, se ata nuk e kanë njohë
20 punën dhe prandaj i kanë dhënë të drejt vetit për interpretim
21 sipas asaj që ata kanë mendu që duhet të veprohet dhe të
22 punohet. Kjo është bindja jeme.

23 PY. Faleminderit, Dëshmitar.

24 Z. EMMERSON: [Përkthim] Nuk kam pyetje të tjera.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,

1 z. Emmerson.

2 Z. Roberts, fjala për ju.

3 Z. ROBERTS: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

4 Dua t'ju pyes në qoftë se do bëjmë pushim në orën 10.00 apo do
5 vazhdojmë deri në orën 11.00 si zakonisht?

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
7 vazhdojmë, si zakonisht.

8 [Mikrofoni çaktivizuar].

9 Megjithatë në qoftë se dikush do të bëjë një pushim të
10 shkurtër më thoni dhe mund të bëjmë pushimin.

11 Pyetje të palës tjetër nga z. Roberts:

12 Z. ROBERTS: [Përkthim]

13 PY. Mirëmëngjes, z. Fondaj. Unë quhem Geoff Roberts. Jam
14 Avokati Mbrojtës i z. Selimi. Kam rreth një orë, një orë e
15 gjysmë pyetje për ju sot paradite. Ju lutem më dëgjoni me
16 kujdes, jepini përgjigje pyetjeve që jap unë. Por në qoftë se
17 pyetjet e mia nuk janë të qarta, mos hezitoni që të më bëni
18 pyetje dhe të më kërkoni t'i përsëris ato. A është e qartë
19 kjo, z. Fondaj?

20 PË. Mirëdita fillimisht. Po, faleminders.

21 PY. Sa i takon historikut tuaj ose përvojës tuaj. Sikurse i
22 thatë kolegut im z. Misetiç, ju keni pasur përvojë me armatën
23 jugosllave nga periudha e vitit 19985 deri në 19987, a është e
24 vërtetë kjo, Dëshmitar?

25 PË. Po. Unë në vitin 1987 unë e kam ndërpre punën në armatën

1 jugosllave.

2 PY. Kur u kyçët në UÇK në periudhën qershor apo korrik, apo
3 gusht një prej roleve kryesore tuaja ishte që të stërvitnit
4 njësitet e ndryshme, apo jo, Dëshmitar?

5 PË. Po. Kryesisht jam marrë me gatitje të ushtarëve në
6 aspektin operativ.

7 PY. Ka pasur goxha mungesë stërvitjeje ose përgatitjeje
8 profesionale të ushtarëve të UÇK-së në atë kohë, të paktën nga
9 përvoja juaj, mund ta konstatooni këtë, apo jo, Dëshmitar?

10 PË. Po. Edhe dje gjatë bisedës që patëm këtu unë e përmenda,
11 që në periudhën prej vitit 1990, djemtë tanë, domethënë, prej
12 Kosovës nuk shkonin në shërbimin ushtarak të ish-Jugosllavisë.
13 Kështu që një numër të konsiderueshëm të ushtarëve të UÇK-së
14 ne i kemi pas pa shërbim ushtarak dhe ata kanë pas probleme
15 bazike me përdorim të armës, domethënë, pushkës, të mos flas
16 edhe elementëve tjera sa i përket kryerjes së veprimeve të
17 marshimit, sulmit, mbrojtjes e kështu me radhë.

18 PY. Sa ushtarë keni përgatitur gjatë kësaj periudhe,
19 Dëshmitar, gjatë korrikut dhe gushtit, korrikut, gushtit dhe
20 shtatorit më saktë?

21 PË. Po realisht unë ma tepër kam qenë një farë periudhe, në
22 një farë faze organizative sesa që kam arrit me i trajnu vetë.
23 Por, domethënë, në një periudhë dikun tre-katër javë kam
24 punue, pastaj kam marrë për detyrë ta udhëheqim një tog të
25 minahedhësve, respektivisht granatahedhësve. E me atë togun

1 kam punu gjithashtu dikun nja tri-katër javë. Kur është fjala
2 muajin qershor, korrik edhe gusht. Këto janë kryesisht ato
3 veprime.

4 Gjatë muajit gusht kam mare detyrën e shefit të shtabit
5 në kuadër të Brigadës 123.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vetëm një
7 çast, z. Roberts.

8 Do bëjmë një pushim në orën 10.00 që ta dimë të gjithë.

9 Z. ROBERTS: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

11 Z. ROBERTS: [Përkthim]

12 PY. Do kalojmë tek jo pikë pak më vonë në dëshminë tuaj,
13 Dëshmitar. Pra, ju jeni fshirë gjerësisht në përgatitjen e
14 ushtarëve. Dhe ndërkohë, dje i keni thënë ZPS-së, që nevoja
15 për përgatitje të vazhdueshme ishte me rëndësi të
16 jashtëzakonshme gjatë gjithë luftës, a është e vërtetë kjo,
17 Dëshmitar?

18 PË. Shumë e vërtetë. Jo vetëm që kam thënë po edhe ka qenë e
19 tillë. Edhe sot po e pohoj.

20 PY. Tani do të kalojmë tek ndërveprimi i parë me anëtarët e
21 Shtabit të Përgjithshëm.

22 Në fillim i keni thënë ZPS-së në intervistën e dhënë për
23 ZPS-në që ishte një grup që njihej me emrin e Shtabit të
24 Përgjithshëm në fillim fare, që thatë që ishte diku nga prilli
25 ose maji i 1998 dhe Blerim Kuqi ishte udhëheqësi i njësisë

1 ushtarake që ishe në kontakt me të gjithë këta persona. Por më
2 pas ti sqaron se z. Zyrap i nuk ka mbërritur në Kosovë deri në
3 maj, kështu që nuk ju kujtohen ekzaktësisht datat. A është e
4 saktë kjo, Dëshmitar? Domethënë, siç e keni pranuar dhe në
5 intervistën që i keni dhënë ZPS-së, ju jo gjithmonë keni qenë
6 shumë të saktë me datat, nuk ju janë kujtuar gjithmonë datat,
7 a është e vërtetë kjo, Dëshmitar?

8 PË. E vërtetë është.

9 PY. Po ashtu i keni thënë ZPS-së në seancën gatitore që nuk
10 jeni në dijeni të ndonjë kontakti që z. Kuqi ka pasur me z.
11 Zyrap i përpara takimit më datë 10 qershor.

12 Z. ROBERTS: [Përkthim] Për procesverbal, kjo është dhënë
13 në provën materiale P1328, paragrafi 3.

14 PY. A është e saktë kjo, Dëshmitar?

15 PË. Po, është e saktë. Edhe këtë e lidhi me faktin se unë jam
16 kyç në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës pikërisht më 10 qershor.
17 Ndërsa kyçjen teme ose kyçja jeme ka të bëjë direkt edhe me
18 Blerim Kuqin, i cili, po të njëjtën ditë, më ka shoqëru deri
19 në fshatin Negroc edhe i ka njoftue krerët e UÇK-së për
20 veprimet ushtarake që ka ndër marrë në atë periudhë.

21 PY. Po. Pra, ju e pranoni që nuk keni njohuri të
22 drejtpërdrejt lidhur me atë çfarë ka ndodhur përpara 10
23 qershorit sa i takon rolit të Shtabit të Përgjithshëm, a është
24 e drejtë kjo, Dëshmitar?

25 PË. Ju jeni veç e keni pas pak a shumë ndoshta informacione

1 të pakonfirmume, respektivisht hamendje tona, paragjykime të
2 cilat ndoshta po na përcjellin edhe sot.

3 PY. Edhe kur jeni takuar me anëtarë të Shtabit të
4 Përgjithshëm më datë 10 qershor jeni takuar vetëm me disa prej
5 anëtarëve të Shtabit të Përgjithshëm, apo jo, domethënë, jeni
6 takuar me z. Bashota, z. Krasniqi dhe z. Zyrapi, a është e
7 vërtetë kjo, Dëshmitar?

8 PË. Unë kur jam -- atë ditë kur kam udhëtue, kam udhëtu me u
9 takue me Sokol Bashotën. Domethënë, paraprakisht është
10 përmend, është laku emni jem edhe ka mbet që unë me u taku me
11 Sokol Bashotën për me u sistemue brenda Ushtrisë Çlirimtare të
12 Kosovës. Domethënë, për q'atë qëllim edhe kam shku. Nuk kam
13 shku të kontaktoj me të tjerët. Por kontakti është bë në
14 shtëpinë e Jakup Krasniqit, ku prezent ka qenë edhe z.
15 Krasniqi aty. Ndërsa më vonë, është ardhë prej lëvizjes që ka
16 pas në terren edhe Bislime Zyrapi. Edhe unë atë ditë kam
17 vazhdue me Bislime Zyrapin edhe me Agim Çelën, një epror
18 tjetër. Edhe me ta kam bujt atë natë në Negroc në një shtëpi
19 tjetër, jo në shtëpinë e z. Krasniqi, po me një shtëpi tjetër.

20 PY. Faleminderit. Do ju kërkoja që të jeni sa më konciz të
21 jetë e mundur me përgjigjet tuaja dhe duhet të jeni të
22 përqendruar në përgjigjet e pyetjeve që ju bëj, në mënyrë të
23 tillë që të mund të vazhdoj me pyetjet e planifikuara për ju.

24 Kur u takuat me z. Bashota, kam përshtypjen që i keni
25 thënë ZPS-së që ai kishte një nofkë si Dhjetëshi, a është e

1 vërtetë kjo, Dëshmitar?

2 PË. Ka mujt me thanë. Sigurisht, nuk po them që nuk kam
3 thënë. Q'ashtu e kemi njoft. Edhe unë kur kam kontakt me të
4 qështu kam kontakt si me Dhjetëshin, nuk e kam ditë
5 fillimisht kush është Dhjetëshi. Fillimisht nuk e kam ditë
6 shumë ma vonë kur jemi taku për raste tjera e kam pa si kemi
7 të bëjmë me një person i cili emri i tij i vërtetë është Sokol
8 Bashota

9 PY. Ai e përdorte këtë nofkë ose atij i drejtoheshin me këtë
10 nofkë ose jeni drejtuar juve me këtë nofkë kur jeni drejtuar,
11 kur keni bashkëbiseduar me të, apo jo?

12 Z. HALLING: [Përkthim] Përsëri në paragrafin 6 në
13 Shënimin Përgatitor jepet konteksti përkatës për këtë pyetje.

14 Z. ROBERTS: [Përkthim]

15 PY. Mund të vazhdoni me përgjigjen e pyetjes, Dëshmitar? Në
16 qoftë se nuk e kuptuat mund t'jua përsëris edhe një herë. E
17 kuptuat, apo jo?

18 PË. Realisht pat disa ndërhyrje, nëse bën ma përsëritni edhe
19 një herë pyetjen.

20 PY. Pa diskutim. Pyetja ime ishte kjo: Sokol Bashota e
21 përdorte këtë nofkë ose të tjerët i drejtoheshin me këtë nofkë
22 kur ti ke biseduar me të, apo jo, Dëshmitar?

23 PË. Po.

24 PY. Më vonë, besoj më 21 ose rreth datës 21 shtator 1998, ju
25 jeni takuar me z. Selimi në Arbri ku ai ka qenë së bashku me

1 z. Thaçi. A ju kujtohet që t'ia keni thënë këtë gjë ZPS-së, në
2 intervistën me ZPS-në dhe që e keni përsëritur përsëri në
3 seancën gatitore me ZPS-në, Dëshmitar?

4 PË. Po.

5 PY. Ju shpjegoni se gjatë këtij takimi ata ju dhanë disa
6 detyra për konsolidimin e Brigadës 123. Këtë i keni thënë ZPS-
7 së, domethënë, që ata të kanë caktuar disa detyra ty.

8 Tani dua që t'ju kërkoj që të jeni të qartë lidhur me
9 detyrat që ju kanë kërkuar, domethënë, a ju kanë kërkuar
10 këshillim ose ndihmë sa i takon ofensivës në vijim e sipër
11 serbe në atë kohë dhe ajo çfarë duhet të bëje ti, domethënë, a
12 mund të na e shpjegosh pak çfarë detyrash ju kanë caktuar?

13 PË. Unë kam udhëtu në Abri për këshillim me këta dy persona
14 se e kam ditë që janë atje. Sepse paraprakisht e kam pa
15 situatën bukur të komplikume në zonën ku unë kam vepru. Edhe
16 unë kam shkue për konsultim dhe kam konsultue dhe kam bisedue
17 në për mënyrat edhe format sesi munden me u gjet ma së miri në
18 atë situatë.

19 Kështu që ma tepër ka qenë këshillim sesa marrje
20 detyrash. Edhe tash interpretimi si kam mujt me rrjedhë që ata
21 më kanë caktu mu detyra. Në atë periudhë, ata nuk më kanë
22 caktu detyra por kemi komunikuar për hallet edhe problemet që ne
23 i kemi pas në atë periudhë edhe kryesisht janë dhënë
24 këshillime. Jo. Edhe vërejtje por ma shumë këshillime sesi me
25 vepru në ato situata.

1 PY. Pra, nuk është se ishte një detyrë ose nuk është një
2 urdhër që të ishte dhënë nga këta dy persona, po ishte thjesht
3 këshillim siç e thatë edhe juve, apo jo, Dëshmitar? Të lutem
4 thoni po ose jo se duhet që të caktohet --

5 PË. Po.

6 PY. -- në procesverbal se e shikoj që po tundni kokën, po
7 duhet ta thoni me zë, Dëshmitar.

8 Pra, po. Thatë po? Domethënë nuk ishte detyrim ose nuk
9 është urdhër që ju dha juve prej këtyre personave, kështu?

10 PË. Unë e prita derisa të përfundon përkthimi prandaj ishte
11 ajo pjesa e qetësisë ndoshta mospërgjigjes. Por pohimi është
12 po.

13 PY. Atëherë, domethënë, e kuptoj që doni të prisni ose që
14 prisni zakonisht për përkthimin që të mbaroj.

15 Tani, për të qenë të qartë, ju në qoftë se do të merrnit
16 një rrugë tjetër ose të kishit bërë ndonjë gjë ndryshe në
17 rolin që kryenit, për ju nuk është se do kishte ndonjë pasojë
18 në qoftë se nuk do të ndiqnit këshillat që ju dhanë, apo jo,
19 Dëshmitar?

20 PË. Sigurisht ka qenë një situatë e jashtëzakonisht e
21 vështirë edhe format e veprimit më të vërtet kanë qenë pak a
22 shumë si kanë ditë komandanti, i ka realizu edhe kanë kry
23 veprimet. Por unë kam qenë thjesht adhures i asaj që të
24 respektohet në një farë forme që ajo vijë e vogël që kemi pas
25 ushtarake edhe ma tepër ka qenë në respekt edhe në koordinim

1 të plotë të punës teme me strukturat komanduese të bëhet, pra,
2 me strukturat komanduese.

3 PY. Por është më te respekt në nivel personal më shumë sesa
4 detyrim, apo jo, Dëshmitar?

5 PË. Po.

6 PY. Kur ka ndodhur ky takim me datë 21 shtator, ti i ke
7 thënë qartazi ZPS-së që kjo ka qenë hera e vetme që jeni
8 takuar me z. Selimi gjatë luftës. Këtë e keni thënë në
9 intervistën e ZPS-së në pjesën 8, faqja 20 në anglisht dhe
10 faqja 24 deri në 26 në shqip.

11 Do citoj pjesën e fundit në mënyrë të tillë që ta keni
12 shumë të qartë atë çfarë keni thënë në lidhje me këtë temë,
13 Dëshmitar. Atëherë duke folur për këtë takim të datës 21
14 shtatorit:

15 "PY. Kur thoni që Rexhep Selimi ka qenë aty i
16 pranishëm, a është e saktë kjo?

17 "PË. Po, në shtator po nuk e kam parë më herë tjetër.
18 Nëse nuk e kam gabim Rexhep Selimi ka qëndruar gjatë gjithë
19 kohës në Kosovë. Megjithatë unë atë e kam takuar vetëm një
20 herë në shtator".

21 Dua që të jem i qartë lidhur me këtë, Dëshmitar, kjo ka
22 qenë hera e vetme kur jeni takuar me z. Selimi gjatë gjithë
23 luftës, apo jo?

24 PË. Me z. Selimi jam takue paraprakisht diku më datën 10, 11
25 shtator në fshatin Dobërdolan. Ai ka qenë bashkë me Hashim

1 Thaçin dhe ata kanë vazhdu për Abri, prandaj e kam ditë që
2 janë në Abri. Edhe ndërsa takimi i Abrisë më Rexhep Selimin ka
3 qenë kontakti i fundit. Pra, me të jam taku vetëm dy herë
4 gjatë tërë luftës në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës.

5 PY. Në rregull. Megjithatë pas datës 21 shtator ju s'e keni
6 takuar asnjëherë Rexhep Selimin, domethënë, pas 21 shtatorit
7 të 1998 deri -- ose 1999 se e thashë gabim, ju kërkoj ndjesë,
8 ju s'e keni takuar asnjëherë z. Selimi, kështu, Dëshmitar?
9 PË. As gjatë luftës as mbas luftës deri dje.

10 PY. Faleminderit.

11 Z. ROBERTS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, në qoftë se
12 mendoni të përshtatshme është momenti i përshtatshëm për të
13 bërë pushim tani.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar, do
15 bëjmë pushim prej dhjetë minutash tani. Në fakt më shumë sesa
16 dhjetë minuta. Do të takohemi në orën 10.10 të gjithë.

17 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëhere do
19 bëjmë pushim deri në orën 10.10.

20 --- Seanca ndërpritet në orën 09.57

21 --- Seanca rifillon në orën 10.10

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
23 sillni dëshmitarin në sallë.

24 Z. ROBERTS: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, desha t'ju
25 informoja që ka të ngjarë që të përfundoj të gjithë seancën e

1 radhës mbase edhe diçka më shumë, në vartësi të përgjigjeve të
2 dëshmitarit.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

4 [Dëshmitari vijon dëshminë]

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirë, z.

6 Fondaj, do të vazhdojmë.

7 Vazhdoni z. Roberts.

8 Z. ROBERTS: [Përkthim]

9 PY. Mirë se u kthyet z. Fondaj. Para pushimit po flisnim për
10 takimin në Abri. Në intervistën për ZPS-në keni përshkruar në
11 atë kohë z. Selimin si një nga përfaqësuesit kryesor të
12 Shtabit të Përgjithshëm në Kosovë. A ju kujtohet t'ia keni
13 thënë këtë ZPS-së?

14 PË. Po.

15 PY. Në këtë kohë shef i Shtabit Operativ ishte Bislim Zyrap
16 apo jo, sipas dëshmisë tuaj?

17 PË. Po.

18 PY. Edhe në atë kohë Bislim Zyrap i ishte në Kosovë, apo jo?

19 PË. Jo, pikërisht para tri, katër ditësh ai kishte udhëtu për
20 Shqipëri dhe unë e kisha situatën me të vërtetë gati jashtë
21 kontrollit, prandaj e ndjeva shumë të nevojshme ta bëj
22 udhëtimin për në Abri.

23 Pra, në momentin kur unë e kam komunkue, respektivisht,
24 jam këshillue me Rexhep Selimin edhe Hashim Thaçin, Bislim
25 Zyrap i ka qenë në Shqipëri.

1 PY. Në rregull. Deri në atë moment, deri afër takimit, katër
2 ditë para takimit, tri-katër ditë para takimit, apo jo?

3 Dhe me sa keni kuptuar ju, ai ka qenë në atë kohë epror i
4 z. Selimi. Pra, z. Zyrapin ka qenë epror i z. Selimi, si shef i
5 Shtabit të Përgjithshëm, i shtafit [Sipas përkthimit]
6 operativ, apo jo?

7 PË. Po në konceptin që ne e kemi pas, ai ka qenë ekip i
8 lartë, domethënë, që na e kanë përbën pjesën më të lartë të
9 ushtrisë tonë, që tash po e quajmë ose shtab qendror ose që ma
10 vonë njihet me emrin Shtabi i Përgjithshëm. Se saktë çfarë
11 specifika dhe detyra kanë pas këta në nivel të asaj
12 problematike, sidomos kur bëhet fjalë për personin në fjalë,
13 domethënë, Rexhep Selimin, unë nuk e kam dit as atëherë e as
14 sot cilat kanë qenë detyrat e tij.

15 PY. Mirë. Pra, ju nuk e dini çfarë marrëdhënie kishte ai me
16 Zyrapin. Sa i takon marrëdhënies vartës-epror, apo jo?

17 PË. Sigurisht.

18 PY. Po a është e saktë që ju kishit perceptimin se ai ishte
19 një nga përfaqësuesit kryesorë për faktin se ishte ende në
20 Kosovë, kështu?

21 PË. Për faktin se ai ishte në Kosovë, nuk do me thënë kjo, po
22 do me thënë në atë kuptimin që realisht ka qenë një prej
23 luftëtarëve më trima që në rrethanat e muajit shtator me
24 qëndru në Kosovë, vërtetë ka qenë problematike. Sidomos në
25 mujin nëntë, shtator, po e përmendi.

- 1 PY. Që ta kuptoj siç duhet, me z. Selimi ju jeni takuar
2 pjesërisht për faktin se nuk ishte z. Zyrapi? Pra, meqë z.
3 Zyrapi ishte larguar drejt Shqipërisë, ju u takuat me z.
4 Selimin, kjo ishte arsyeja?
- 5 PË. Pikërisht. Jo veç me z. Selimi, po e dijsa që ata janë
6 bashkë edhe me zotëri Thaçin.
- 7 PY. Tani dua të flasim për situatën tuaj si shef i shtabit në
8 zonën e Pashtrikut. Ka qenë nga dhjetori 1998 e deri diku nga
9 marsi 1999, apo jo?
- 10 PË. Fillim marsi 1999.
- 11 PY. Ku ishit i vendosur ju si shef shtabi në atë kohë?
- 12 PË. Kemi -- ne kemi qenë të stacionum në fshatin Kasterc, që
13 është i lidhun me fshatin Nishor. Pra, kur thujm ndonjëherë
14 Nishor, Kasterc, ato janë dy fshatra që thjesht ndërhyrjnë
15 njëna me tjetrën për sa i përket edhe shtëpive të banimit.
- 16 PY. Sikurse na thatë më herët, nuk e keni takuar më z. Selimi
17 të paktën deri nga fundi i luftës.
- 18 PË. Unë nuk e mbaj mend që e kam takue Rexhep Selimin gjatë
19 luftës ma.
- 20 PY. Pra gjatë kësaj periudhe tremujore si shef shtabi nuk u
21 takuat asnjëherë me të. Edhe kjo kuptohet rrjedhimisht nga
22 dëshmia juaj, kështu?
- 23 PË. Saktë.
- 24 PY. Mirë. Nexhmedin Kastrati, për të cilin thatë dje se ju
25 zëvendësoi si shef shtabi i zonës së Pashtrikut, kështu?

1 PË. Jam në dijeni se më ka zëvendësu Nexhmedin Kastrati.

2 PY. Ai vetë ka thënë që z. Selimi shkonte çdo javë, edhe
3 prezumojmë se e ka takuar rregullisht. Por kjo nuk përputhet
4 aspak me atë që ju kujtohet ju nga periudha kur keni qenë ju
5 shef shtabi. Pra, nga dhjetori deri në mars 1999 -- dhjetori
6 1998, marsi 1999, nuk përputhet kjo gjë.

7 PË. Unë e kam respektu Rexhep Selimin dhe kam pas qejf me u
8 taku me të, së paku privatisht. Dhe sikur ta kisha dit që ai
9 ndodhet afër meje, unë do të insistoja që ta takoja, vetëm ta
10 përshëndesja. Kurr gjë ma tepër. Por nuk e di që ai ka qenë në
11 fazën sa kam qenë shef shtabi në Nishor, respektivisht, në
12 Kasterc.

13 PY. Kjo është interesante kur keni thënë që "po ta kisha dit
14 që do të ishte në atë zonë do të kisha shku për ta taku të
15 paktën, për ta përshëndetur". Po ju ishit shef shtabi, kështu
16 që afërmendsh do ju kishin thënë që ka ardhur z. Selimi në
17 zonën tuaj, në regjionin tuaj, dhe kjo nuk ndodhi asnjëherë
18 gjatë të gjithë kohës që ju ishit shef shtabi, të paktën sipas
19 asaj që na thatë, kështu?

20 PË. Unë nuk kam pas informacion se Rexhep Selimi në periudhën
21 sa kam qenë unë shef shtabi ai ka qenë në Nishor.

22 PY. Faleminderit. Tani do të flasim për një temë tjetër. Të
23 flasim për Rahovecin në korrikun 1998. Ju ka bërë pyetja
24 Prokuroria për këtë gjatë intervistës.

25 Në intervistën tuaj ju konferuat [Sipas përkthimit] se ka

1 pasur operacione në -- ushtarake në Opterushë, Reti dhe
2 Zeqishtë. Më falni për shqiptimin. Ju nuk keni qenë pjesë e
3 këtyre aksioneve. Ju keni thënë që granathedhësit tuaj, njësia
4 jua j me granathedhës nuk ka qenë operacionale deri nga 19
5 gushti, kështu?

6 PË. Unë me një grup të togut të minahedhësve, derisa e kam
7 udhëheq atë njësi, në këtë operacionin e marrjes të Zoçishtit
8 edhe Retisë unë kam pas për detyrë të siguroj krahun tonë të
9 djathtë, respektivisht rrugën Rahovec-Suharekë, mbi Zoçishtë,
10 me sigurie masë po ndërmirren ndonjë kundërsulm nga forcat
11 serbe. Dhe me atë grup jam vendos atje. A për sa i përket
12 çështje të përdorimit të njësisë të togut të minahedhësve
13 është e vërtetë që është përdor për herë të parë me 19 korrik.
14 Në gusht është përdorur, po edhe në korrik po. Jo, më falni,
15 në korrik nuk është përdor, por tek në gusht.

16 PY. 19 gusht, po, 19 gusht. Kjo është.

17 PË. Po, se kjo tash që po flitet kemi të bëjmë me të me 19
18 korrik. Pra këtë ditë nuk janë përdorur minahedhësit.

19 PY. Ju kanë treguar -- ju treguan një dokument që mendohet që
20 është një raport ushtarak nga Agim Kuqi.

21 Z. ROBERTS: [Përkthim] Do të doja që vendosej edhe një
22 herë në ekran. Është me numrin U001-7877 dhe në anglisht dhe
23 në shqip.

24 PY. Për ta kuptuar se ku e kam fjalën. Këtë ua ka treguar
25 Prokuroria gjatë intervistës me ta.

1 Z. HALLING: [Përkthim] Për procesverbal është prova
2 materiale me numër P1329.

3 Z. ROBERTS: [Përkthim]

4 PY. Që të jeni të qartë çfarë i keni thënë ZPS-së. I keni
5 thënë ZPS-së që këtë dokument nuk e kishit parë më përpara.
6 Kështu?

7 PË. Po, këtë dokument e kam pa për herë të parë në dhënien e
8 deklaratës ZPS-së në 2019.

9 PY. Dhe i keni thënë që ka pasur disa gabime në përmbajtje të
10 intervistës sa i takon rolit tuaj?

11 PË. Po, kam sqarue se sipas përshkrimit që e jep Agim Kuqi,
12 nuk përputhet detyra jeme në kuadër të grupit.

13 PY. Edhe ky dokument tregon çfarë ka ndodhur më 21 korrik,
14 disa ditë pasi kishin filluar luftimet në Rahovec më 17
15 korrik.

16 PY. Për dokumentin për të cilin po bëhet fjalë, unë e kam
17 bindjen që duhet me qenë 19 korrik, jo 20, respektivisht, 21
18 [E pakuptueshme]. Domethënë që ky raport që është, nëse
19 s'gaboje është për të njëjtën problematikë përshkruar, për të
20 cilën unë fola.

21 PY. Besoj se ju më herët thatë 19 gusht, apo e kuptova unë
22 gabim?

23 PË. 19 korrik.

24 PY. Qartë. Sidoqoftë, kjo është dy a tri ditë pasi kishin
25 filluar luftimet në Rahovec. Dhe ju nuk e dini si filluan

1 luftimet fillimisht, apo jo?

2 PË. Jo, jo, nuk e di. Realisht për atë po të them dy-tri
3 ditë, se luftimet në Rahovec kanë filluar me 17 korrik edhe
4 këtu tamam me datën 19 ka qenë, nëse s'gaboju unë, sipas asaj
5 që unë mbaj mend kemi të bëjmë me datën 19. Ne kemi marrë për
6 obligim respektivisht nën komandën si epror të Blerim Kuqit
7 edhe realisht kemi marrë për obligim edhe detyrë me e marrun
8 Zoçishtin, Retinë, edhe Rahovecin nën kontroll të Brigadës
9 123. Krejt me qëllim që pak a shumë forcat serbe të
10 shpërndajnë kapacitetet e tyre ushtarake edhe në këtë zonë,
11 sepse në atë periudhë Rahoveci ka qenë duke u granatu me
12 intensitet të jashtëzakonshëm.

13 PY. Po, që t'u jepet mundësia civilëve që të largoheshin, apo
14 jo?

15 PË. Ma tepër ka -- po edhe ajo, por sidomos ka qenë çështja e
16 vërtetë, Rahoveci filloi t'i përngjajë Vukovarit në periudhën
17 që po flas me 17, 18, 19 e në vazhdim disa ditë me radhë.
18 Fjala çdo herë është korrik 1998.

19 PY. Më falni që ju ndërpreva. Kur thoni "Bukovën" [Sipas
20 përkthimit] të mbledheshin në Ukovë [Sipas përkthimit] --
21 kishte artileri, më falni, ishin ndërtuar ngjashëm me
22 Vukovarin, në Kroaci. Këtë thatë, në 1991, kur u granatuan nga
23 forcat serbe. Këto po thoni, njësoj si Vukovari u dëmtuan?

24 PË. Pikërisht ka pas grantime sistematike në tërë rajonin e
25 qytetit të Rahovecit, ngjajshëm sikurse është granatu Vukovari

1 nga ushtria jugosllave në drejtim të Rahovecit.

2 PY. Tani pse ju pyeta unë për faktin që ju nuk e dinit si
3 kanë filluar luftimet në Rahovec, ju pyeta që të isha i qartë
4 sepse ju në intervistë keni folur për një sulm ndaj Rahovecit.

5 Z. ROBERTS: [Përkthim] Për procesverbal, është në Pjesën
6 3, faqja 14.

7 PY. Kur keni thënë "një sulm ndaj Rahovecit", dua të jem i
8 qartë sepse ju nuk e dini si filloi. Ju nuk po thoni që ka
9 qenë sulm prej UÇK-së ndaj Rahovecit. Nuk po thoni që e ka
10 bërë UÇK-ja këtë sulm ndaj Rahovecit, apo jo?

11 PË. Unë nuk jam në dijeni të vperimeve fillestare të
12 luftimeve se si janë fillu luftimet në Rahovec. Po e di që
13 jemi marrë me pasoja që neve na kanë kushtu shumë rëndë. Ne
14 kemi qenë në fazën e themelimit të brigadave dhe menjëherë
15 praktikisht neve na është dashtë me u marrë me operacione
16 shumë serioze ushtarake pa u konsolidu brigadat.

17 Prandaj, pavarësisht asaj a e ka bo Ushtria Çlirimtare e
18 Kosovës atë akt që ka hy në Rahovec apo ka qenë ndonjë
19 inskenim i forcave jugosllave, unë këtë nuk e di. Po e di që
20 ne e kemi pësu shumë keq prej luftimeve të Rahovecit.

21 PY. S'e vë në dyshim fare këtë. Si shpjeguat më herët, duke e
22 marrë parasysh edhe granatimet në Rahovec, e kam kuptuar unë
23 drejtë që ka pasur forca të konsiderueshme të armatës
24 jugosllave në atë zonë në atë kohë. Kështu?

25 PË. Sigurisht.

1 PY. Dhe në atë zonë kanë qenë qysh para 17 korrikut, apo jo?

2 PË. Po. Edhe përpara kanë qenë, po intensitetet e luftimeve
3 edhe luftimet kanë fillue pikërisht pas qëtyre betejave të
4 para në Rahovec. Domethënë, mbas datës apo me datën 17, 18 e
5 mbrapa.

6 PY. Po. Unë po dua të dal këtu, duke marrë parasysh që ka
7 pasur shumë njësite ushtarake ish-jugosllave në atë zonë, nuk
8 do të kishte qenë shumë me mend që të niste një sulm në
9 Rahovec sidomos duke marrë parasysh numrin e kufizuar të
10 ushtarëve, apo jo?

11 PË. Po derisa ne kemi qenë në fazën e themelimit edhe ende të
12 papërgatitur me armatim, me një armë shumë të pakët, me
13 armatim të pakët, normale që luftimet në Rahovec neve na kanë
14 kushtu shumë. Them nëse është ndërmarrë aksioni nga forcat e
15 UÇK-së ka qenë gabimi më i madh në atë periudhë që e ka bo
16 UÇK-ja. Nëse nuk ka qenë po ka qenë inskenim nga pushteti
17 jugosllav, atëherë ata e kanë realizu me shumë vetëdije këtë
18 intervenim edhe këtë luftë, sepse më pas, pasojën ofensivën
19 edhe luftime të tjera që neve na kanë kushtu, po e përmendi
20 edhe një herë, shumë, shumë, na kanë kushtu.

21 PY. Po duke marrë parasysh njohurinë ushtarake që kishte
22 Bislim Zyrapi, dhe fakti që trupat nuk ishin të trajnuar,
23 sipas teje në këto rrethana Bislim Zyrapi nuk do ta kishte
24 dhënë një urdhër të tillë, as nuk do t'i kishte shkuar mbase
25 në mendje në gjë e tillë, apo jo?

1 PË. Unë nuk kam pas bisedë kurrë me Bislim Zyrapin për këtë
2 çështje, por këtë që e përmenda është opinion jëm që ma vonë
3 kam pa që e kanë mbështetë edhe disa të tjerë ekspertë
4 ushtarakë.

5 PY. Kuptova. I kthehemi edhe një herë dokumentit. Në krye ku
6 thotë:

7 "20 korrik 1998, në orën 23:00, komandanti i shtabit
8 lokal të UÇK-së, Blerim Kuqi, me urdhër me Shtabit të
9 Përgjithshëm të UÇK-së dha urdhër që të sulmohen fshatet
10 Zaqisht dhe Hoqë të banuara me popullatë serbë."

11 E lexuat këtë në krye të dokumentit që keni përballë në
12 ekran?

13 PË. Po.

14 PY. Disa herë ju ka pyetur ZPS-ja gjatë intervistës nëse
15 urdhri i Blerim Kuqit ka dalë bazuar në një urdhër të Shtabit
16 të Përgjithshëm, dhe ju keni thënë se "Unë këtë nuk mund ta
17 konfirmoj sepse kjo mund të jetë e saktë teorikisht, por ama
18 nuk e di në të vërtetë".

19 A ju kujtohet që ja keni thënë këtë ZPS-së?

20 PË. Po, ja kam thënë edhe prapë qëndroj pranë të njëjtit
21 pohim sepse në atë periudhë që e përmenda detyra jeme në
22 kuadër të brigadës ka qenë komandant i togut të minahedhësve.
23 Kështu që nuk kam pas informacione në aspektin e këtij urdhri.

24 PY. Kur thoni "Mund të jetë e saktë teorikisht, këtë e bazoni
25 në atë që lexoni në dokument, por nuk është se bazoni në

1 ndonjë dijeni konkrete që kishit ju, apo jo?

2 PË. Jo, këtë veç e bazoj në përvojën teme ushtarake që
3 urdhrat mujn me ardhë nga një strukturë domethënë hierarkike,
4 në q'atë aspekt jam tuj e fol, e jo sepse kam ndonjë farë
5 indikacioni apo ndonjëherë -- sado pak njohuri se ka ardhë
6 urdhri nga niveli më i lartë.

7 PY. Në rregull. Për të qenë në qartë, ky dokument nuk është
8 se jep datën, referencën, përmbajtjen apo natyrën e supozuar
9 të këtij urdhri të Shtabit të Përgjithshëm apo jo, Dëshmitar?
10 Domethënë është një përshkrim shumë i përgjithshëm. Është një
11 referencë e përgjithshme dhe nuk i përmban të gjithë këto
12 elementë që unë përmenda, apo jo?

13 PË. Sipas kësaj që e shoh unë, Agim Kuqi mundohet me bo një
14 përshkrim në detal, por kam bindjen që në disa elemente ja ka
15 hup.

16 PY. Në rregull. Në deklaratën që i keni dhënë ZPS-së, i keni
17 thënë Prokurorit që Shtabi i Përgjithshëm ka koordinuar
18 përpjekjet në brigadën tuaj për të tërhequr vëmendjen nga
19 Rahoveci. Po ashtu keni konfirmuar se kjo mbështetet vetëm te
20 informacioni që ti ke marrë më mbrapa, më pas. Por nuk e dini
21 se si Shtabi i Përgjithshëm e ka bërë këtë bashkërendim që
22 supozohet që të ketë bërë. Edhe kjo është e vërtetë, apo jo,
23 Dëshmitar?

24 PË. Mu tash detaje të caktume nuk më kujtohen po megjithatë
25 ato ç'ka kam deklaruar mendoj që jam mbështet dikun një supozim

1 apo një ide teme, apo edhe një informacion. Por sot nuk po më
2 kujtohen detaje rreth kësaj problematike.
3 PY. Në rregull. Faleminderit. Mendoj që siç e keni thënë me
4 të drejtë për ZPS-në, që ajo çfarë mund të thoni me siguri
5 është që ju keni qenë pjesë e operacionit dhe jeni përpjekur
6 që të kontrolloni Zoçishten dhe Retinë, dhe kaq është i gjithë
7 roli juaj. Domethënë kjo a është përmbledhje e drejtë e asaj
8 çfarë keni dhënë juve në dëshminë e Prokurorisë, në faqen 4,
9 në Pjesën 3, Dëshmitar?

10 PË. Nëse s'gaboju unë kam thënë që detyra jeme me grupin tem,
11 nga togu [E pakuptueshme] një grup, jo komplet toga, kemi pas
12 për detyrë me e sigurue forcat tona nga ndonjë kundërsulm
13 eventua i forcave serbe në drejtimin tonë.

14 Pikërisht kjo është ajo që, pavarësisht qysh është thënë,
15 qëllimi është kjo që e përmenda tash.

16 PY. Pra, thjesht për të kuptuar kufijet e njohurive tuaja në
17 kuadrin e operacionit. Domethënë ju keni qenë thjesht i
18 kufizuar te veprimet tuaja. Me fjalë të tjera, dëshmia juaj
19 përqendrohet tek fakti se çfarë ke ditur ti lidhur me veten
20 tënde dhe me grupin e vogël rreth jush në atë kohë, apo jo,
21 Dëshmitar?

22 PË. Saktë.

23 PY. Në fund të këtij dokumenti --

24 Z. ROBERTS: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretarit që të
25 shkojmë në fund të faqes së dokumenteve në versionin shqip

1 edhe në anglisht.

2 PY. Tek paragrafi i fundit që fillon me "Rezultati", thuhet
3 që:

4 "Fshati Zeqishtë i pastruar nga forcat serbe plotësisht ka
5 të nxënë rob si dhe armatim dhe municion të fituar në luftë."

6 Për të qenë të qartë ju nuk është se keni parë rob të
7 zënë në kuadër të këtij operacioni, apo jo, Dëshmitar? Dhe
8 këtë i keni thënë edhe Prokurorisë. Domethënë nuk kemi
9 absolutisht asnjë lloj informacioni lidhur me personat e zënë
10 rob, apo jo?

11 PË. Jo, zoti Avokat, nuk ka pa. Edhe nuk -- as çështjen e
12 nxënies së robve, as marrjes së armatimit, municionit apo ç'ka
13 do tjetër unë nuk e kam pa. Ju keni përmendur që keni dëgjuar
14 fjalë nga persona të tjerë që po flisnin, pra keni dëgjuar
15 thashetheme për ekzistimin e këtyre gjërave, megjithatë ju
16 keni thënë se nuk jeni në dijeni të faktit se për kë bëhej
17 fjalë, për kë ushtar bëhej fjalë. A është saktë kjo,
18 Dëshmitar?

19 PË. Zoti Avokat, nuk e kuptova në kontekst, ç'ka [e
20 pakuptueshme] është kjo kërkesë.

21 PY. Të kërkoj ndjesë se nuk isha unë i qartë në pyetjen që
22 bëra. Keni thënë që keni dëgjuar disa fjalë sa i takon robërve
23 të zënë, megjithatë, nuk je i sigurt se nga kush i ke dëgjuar
24 këto fjalë dhe nuk e dini në qoftë se edhe këto ishin
25 thashetheme për ca fjalë të tjera të dëgjuara. Domethënë, kjo

1 është vërtetë, është një përmbledhje e saktë, apo jo,

2 Dëshmitar?

3 PË. Nuk muj me e pohu, nuk muj me e pohue, se gjatë fazës së
4 luftës kemi ndëgju lloj-lloj fjalësh, lloj-lloj trillimesh.
5 Trillime që realisht edhe dje e përmenda unë një që ne e kemi
6 krijue. Kështu që nuk jam -- nuk muj me u deklarë rreth asaj
7 që me thanë që ka qenë kjo apo ajo.

8 PY. Ky është rreziku i fjalëve që dëgjoen. I thashethemeve.
9 Sepse nuk ke bazë për të vlerësuar në qoftë se janë fjalë të
10 besueshme apo jo.

11 Z. HALLING: [Përkthim] Ju lutem a mund të na thoni
12 referencën ku e keni lexuar këtë fjalë, fjalë që qarkullojnë
13 ose thashetheme në intervistën e dëshmitarit?

14 Z. ROBERTS: [Përkthim] Ja më lejoni një çast që ta gjej.
15 Jo, nuk është referenca ose përmendja e thashethemeve,
16 megjithatë, për të qenë i qartë do të jap citimin e saktë.
17 Bëhet fjalë për intervistën me ZPS-në Pjesën 3, faqja 22.
18 Thuhet:

19 "Vazhdoni më tej.

20 "Pra, ndërmjet ushtarëve, kanë folur lidhur me këtë. kam
21 dëgjuar lidhur me këtë por nuk kam asgjë konkrete. Nuk kam as
22 prova dhe nuk di asgjë tjetër plus."

23 Atëherë për të qenë i qartë, fjalën -- "fjalë ose
24 thashetheme" thjesht i përmenda unë dhe janë fjalët e mia, në
25 kuadër e pyetjeve të bëra. Por kjo u pranua nga dëshmitari.

1 PY. Tani le të kalojmë te njësiti Guri që e përmendën dhe
2 dje. A ju kujtohet që folët për zonat e përgjegjësisë në harta
3 që iu tregoi Prokurori dje dhe juve përmendët njësitin Guri
4 dhe thatë që ai ishte batalion special i Shtabit të
5 Përgjithshëm. A ju kujtohet kjo, Dëshmitar?

6 PË. Po.

7 PY. Kur e përmendni batalionin Guri, a e kuptoj drejt unë që
8 ju nuk keni pas njohuri të drejtpërdrejtë sa i takon këtij
9 batalioni?

10 PË. Kam pas shumë pak njohuri.

11 PY. A është e mundur që në fakt ky njësit të ketë qenë pjesë
12 e Brigadës 121 dhe të mos ketë qenë fare i lidhur me Shtabin e
13 Përgjithshëm. A është mundësi kjo?

14 PË. Mundësi shumë e vogël. Fillimisht nëse s'gaboju unë ka
15 qenë pjesë e brigadës -- domethënë e njësive që kanë veprue në
16 kuadër të kontrollit të Fatmir Limës, që më vonë është quajti
17 Brigada 121. Por me formimin e brigadës, nëse s'gaboju, ky
18 batalion ka marrë epitetin, respektivisht, detyrat që të
19 veprojnë veçan edhe ka qenë i lidhur drejtpërdrejtë si një
20 njësi shtabore e Shtabit të Përgjithshëm.

21 PY. Në rregull. Megjithatë kur thoni që mendoni që është
22 pjesë e Shtabit të Përgjithshëm ju nuk është se keni pasur
23 ndonjë kontakt me ta të njësitetit Guri, Dëshmitar, apo jo? A
24 është e drejtë të thuhet kjo?

25 PË. Unë me komandant Gurin më ka ra me u taku disa herë po

1 nuk kemi pas ndonjë farë komunikimi rreth asaj se kujt ai i
2 referon edhe formës së veprimit dhe organizimit të tij.
3 PY. Pra, ai nuk është se e ka konfirmuar ndonjëherë që ka
4 raportuar, ka njoftuar, apo është i lidhur në mënyrë tjetër me
5 Shtabin e Përgjithshëm. Kjo është thjesht mënyra se si e keni
6 kuptuar ju. Është një prezumin ose supozim i juaji. A është e
7 vërtetë kjo, Dëshmitar?

8 PË. Mund të interpretohet edhe në atë formë. Por, pohimet e
9 mia që unë po e përmendni që ai është -- ka qenë si batalion i
10 Shtabit të Përgjithshëm, respektivisht, batalion që ka dhënë
11 përgjegjësi Shtabit të Përgjithshëm e jo në nivel në ndonjë
12 brigade të caktume, e lidhun nga fakti se dikund në fund të
13 nëntorit ne kemi pas një konsultim me Bislim Zyrapin që ai
14 batalion të kyçet në kuadër të Brigadës 123. Mirëpo,
15 megjithatë ajo nuk ka ndodh. Prandaj edhe ka vazhdu punën ai
16 të jetë prapë njësi e pavarur.

17 PY. A ju kujtohet që ka pasur një problem lidhur me kufijtë e
18 zonës së Pashtrikut dhe të Nerodimës në fund të vitit 1998, në
19 fillim 1999, kur keni qenë shef i shtabit të zonës së
20 Pashtrikut, lidhur me njësitin Gurin?

21 PË. Jo, jo, nuk më kujtohet.

22 PY. Në rregull. Për të qenë i qartë, unë ju parashtroj që
23 njësitin Guri nuk ka qenë në batalionin e Shtabit të
24 Përgjithshëm dhe në fakt ka qenë nën komandën e brigadës. E
25 vetmja çështje ose e vetmja pyetje për të besuar që ka qenë i

1 pavarur ishte që nuk ishte e qartë se nën cilën zonë bënte
2 pjesë Guri dhe kjo për shkak të faktit se komandant dëshironte
3 që të qëndronte nën kompetencën e brigadës 121, por në
4 aspektin gjeografik ndodhej në zonën e Nerodimës. A keni
5 ndonjë informacion lidhur me këtë që sapo ju shpjegova,
6 Dëshmitar?

7 PË. Është në kufi të zonës së Nerodimës, por fshati Grejçeq i
8 takon sipas zonave të ndarjes, zonave -- zonës operative të
9 Pashtrikut. Por nuk do me thënë tash që çështjet duhet të
10 ndahen me vizore, por ndarja ka mujt me qenë edhe duhet me
11 qenë në aspektin edhe të funksioneve, të funksionalitetit.

12 Kështu që nuk jam në rrjedha të kësaj. Kam harrue.
13 Ndoshta kam qenë i informum paraprakisht, po kam harru këtë
14 problematik në tërësi. Nuk e di.

15 PY. Në rregull.

16 PË. [E padëgjueshme]

17 PY. Do ta lemë mënjanë këtë çështje për tani. Mbase mund t'i
18 kthehem më pas. Megjithatë tani dua të kaloj në një tjetër
19 temë. Dua të diskutojmë lidhur me kompetencat e Shtabit të
20 Përgjithshëm sa i takon emërimeve.

21 Diskutuat gjerë e gjatë me kolegun tim, me z. Misetic,
22 dhe lidhur me krimin e njësiteve Lisit dhe Çelikut 50. Mënyra
23 si e kam kuptuar dëshminë tuaj Dëshmitar, këto janë njësite që
24 janë krijuar në fillim të qershorit dhe që kanë dalë dhe kanë
25 filluar të funksionojnë në qershor 1998. A është e vërtetë

1 kjo, Dëshmitar?

2 PË. Këto njësitate sa kam unë informacion janë krijuar gjatë
3 prillit të vitit 1998 dhe kanë vazhdu punën në maj edhe në
4 qershor të kanë arrit me kriju shtabin rajonal për Suharekë.
5 Por me sa di unë, ato kanë vepru prej prillit të vitit 1998.

6 PY. Në rregull. Megjithatë, askush nuk është se i ka udhëzuar
7 ata që të formonim njësitet dhe kur u bashkuan z. Kuqi u
8 zgjodh nga ushtarët e të tjerë në marrëveshje, siç e thashë
9 edhe juve dje, pra që të ishte komandant i njësitetit. A është e
10 vërtetë kjo, Dëshmitar?

11 PË. Po na dje e pamë një dokument që prezantoi Avokati për të
12 cilin realisht unë nuk kam qenë dijeni, por kam qenë në dijeni
13 të veprimeve që janë bo për unifikim të këtyne dy njësitiveve
14 edhe punën rreth unifikimit në një komandë. A për sa i përket
15 dokumentit, unë e përmenda, dje e kam pa.

16 PY. Megjithatë, ju thatë dje në dëshminë tuaj dhe kjo jepet
17 në transkriptin e përkohshëm në faqen 90, që rreth afërsisht
18 dhjetë ditësh që u bashkuan që ata u bënë Brigada 123. A është
19 e saktë kjo? E kam kuptuar drejtë?

20 PË. Q'ashtu kam thënë, realisht, me një farë matematike,
21 hamendje temen në kokë teme dhe në bazë të q'asaj hamendjes
22 unë e kam thënë këtë. Edhe kryesisht qëndron ajo që e kam
23 thënë.

24 PY. Dhe mendoj se e pranuat edhe pak më herët që jo gjithmonë
25 ke qenë i saktë me datat, Dëshmitar. A është e drejtë të

1 thuhet kjo?

2 PË. Sigurisht, sigurisht.

3 PY. Nuk dua t'ju kritikoj, por thjesht po mundohemi që të
4 vlerësojmë ekzaktësisht besueshmërinë e dëshmisë tuaj apo të
5 asaj çfarë ju kujtohet.

6 Z. ROBERTS: [Përkthim] Sa i takon dokumentit që pamë nga
7 Agim Kuqi. Do i kërkoja Sekretarit që ta paraqesë në ekran,
8 por më lejoni një çast sa të gjej numrin ERN. Është U001-7877.

9 PY. Tek rreshti i parë i këtij dokumenti, domethënë, është
10 një bisedë që ka ndodhur rreth datës 21, 22 korrik. Kjo i
11 referohet ende stafit lokal të UÇK-së, apo jo, Dëshmitar?

12 PË. Po, stafi lokal ka qenë q'atë muj, besoj korrik, në
13 korrik, fillimi -- nëse s'gaboju. Po nëse s'gaboju --

14 PY. Thuhet me 20 korrik.

15 PË. Po, këtu thotë 20 korrik, a unë nëse s'gaboju komanda e
16 brigadës është krijuar pikërisht sipas këtij dokumenti bash
17 është thënë mirë me e kthyer me e pa me 7 korrik 1998. Dje që e
18 prezantoi avokati.

19 PY. Ajo çka dua të them është që ky dokument që mendohet që të
20 jetë një dokument nga z. Kuqi, i referohet njësitit si shtab
21 lokal dhe nuk i referohet si pjesë e Brigadës 123, apo jo,
22 Dëshmitar?

23 PË. Q'ishte është e shkrime, [E pakuptueshme]

24 PY. Dhe këtu bëhet fjalë për datën 20 ose 21 korrik.

25 Z. ROBERTS: [Përkthim] Po ashtu në mënyrë të ngjashme do

1 i kërkoja Sekretarit që të paraqesë prova materiale P1342, që
2 është një dokument që ja u tregoi Prokurori dje. Është një
3 kërkesë nga shtabi i zonës së Dukagjinit. Për procesverbal ky
4 është një dokument që mban datën 28 korrik 1998.

5 PY. Domethënë është goxha më pas data 7 korrik. përsëri nuk
6 përmendet fare Brigada 123 këtu. Prapë thuhet që është një
7 kërkesë që i është drejtuar shtabit rajonal të Suharekës.

8 PË. Qëtu shkrun dokument.

9 PY. Atëherë duke marrë parasysh këto dokumente, a e pranoni
10 që formimi zyrtar i Brigadës 123 do të ketë ngjarë shumë më
11 pas 7 korrikut që ju sugjeruat dje?

12 PË. Mendja jeme më thonë që është kriju me 7 korrik brigada e
13 parë, megjithatë ndoshta është mirë ta ktheni q'atë dokument e
14 ta shikojmë të formimit të brigadës. Jo aty qenka formimi i
15 shtabit. Nuk e di, bëhet edhe ngatërresë.

16 PY. E kuptojmë. Arsyeja që pse po të bëj këtë pyetje, dua që
17 të sigurohem se cila është dëshmia juaj lidhur me datën e
18 formimit apo krijimit të brigadës. Unë do të sugjeroja që
19 dëshmia juaj që është krijuar brigada me datë 7 korrik është e
20 gabuar dhe se krijimi zyrtar i brigadës ka ndodhur goxha më
21 pas kësaj date. A e pranoni këtë si të mundur ose si me gjasa
22 bazuar apo mbështetur në këto dy dokumente që sapo ju tregova,
23 Dëshmitar?

24 PË. Por që kemi bo gabime, gabimet janë po shifet. Dikush
25 këtu e ka gabim. Ja e kam unë, ja e ka Ramush Haradinaj, ja e

1 ka Agim Kuqi gabim. Dikush është -- e ka gabim.

2 Z. ROBERTS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, shikoj që ka
3 një problem me transkriptin, të paktën transkripti në ekranin
4 tim ka ngrirë dhe nuk e di se cili është problemi dhe nuk e di
5 se çfarë është pasqyruar nga pyetjet dhe përgjigjet e dhëna së
6 fundi, por kam problem të paktën këtu përpara me transkriptin.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

8 Z. ROBERTS: [Përkthim]

9 PY. Ju kërkojmë ndjesë, Dëshmitar. Na dhuroni dy, tre minuta.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Duket sikur
11 nuk ka probleme tani, po punon prapë.

12 Z. ROBERTS: [Përkthim] Ta shoh për të parë se çfarë
13 pyetjesh janë pasqyruar.

14 PY. Dëshmitar --

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jo, i ka
16 dhënë të gjitha përgjigjet. Janë të pasqyruara përgjigjet.

17 Z. ROBERTS: [Përkthim] Faleminderit, se nuk e pashë në
18 qoftë se ishin të pasqyruara në transkript edhe përgjigjet nga
19 dëshmitari.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund t'ja
21 bësh përsëri pyetjen.

22 Z. ROBERTS: [Përkthim]

23 PY. Pra, pyetja ishte në qoftë se që:

24 "Në qoftë se dikush ka bërë një gabim, dikush mund të
25 ketë bërë ndonjë gabim, mund të kem qenë unë, Ramush Haradinaj

1 ose Agim Kuqi. Dikush mund ta ketë thënë gabim, ta ketë pasur
2 gabim.”

3 A është e plotë përgjigja juaj? Se kaq kemi të shkruar në
4 procesverbal, Dëshmitar. A doni të shtoni diçka tjetër, apo
5 kaq ishte përgjigja.

6 PË. Jo, realisht, ata që kanë shkru ma pak kanë mujt me gabu
7 në raport me ata që kanë majt mend, respektivisht, në këtë
8 rast unë.

9 PY. Pra, e pranoni që mund ta keni pasur gabim lidhur me
10 datën, Dëshmitar, apo jo?

11 PË. Mundet me pas qenë gabim. Nuk jam i saktë. Realisht kanë
12 kalu 25 vjet.

13 PY. E kuptoj. Edhe një herë nuk është se po të kritikoj,
14 Dëshmitar, por thjesht po përpiqem që të verifikoj dëshminë e
15 dhënë përpara Trupit Gjykses.

16 Sa i takon rolit tuaj më vonë si shef ose drejtues i
17 Brigadës 123, ju keni qenë i stacionuar në Breshanc në atë
18 kohë, apo jo, Dëshmitar?

19 PË. Po.

20 PY. Përpara asaj kohe, domethënë nga data 10 qershor deri kur
21 jeni emëruar në fillim të tetorit, ku keni qenë i stacionuar,
22 Dëshmitar?

23 PË. Edhe në atë periudhë kryesisht komanda e brigadës ka qenë
24 në Kosterc -- në Nishor, më falni, në fshatin Breshanc, por
25 zakonisht unë kam vepru në rajonin e Rreshtanit.

1 PY. Në rregull. Derisa e keni ndryshuar pozicionin ose rolin
2 tuaj kur keni përfunduar pozicionin tuaj si shef i shtabit të
3 zonës së Pashtrikut, ju gjatë të gjithë kohës ju keni qenë i
4 stacionuar në zonën e Pashtrikut, domethënë nga 10 qershori
5 1998 deri në mars 1999. Apo jo, Dëshmitar?

6 PË. Kryesisht rajoni i komunës së Suharekës, fshati Nishor.

7 PY. Mendoj se i thatë z. Misetić dje që ju kishit shumë pak
8 informacion lidhur me atë se çfarë po ndodhte në zonat e
9 tjera. A është e vërtetë kjo, Dëshmitar?

10 PË. E vërtetë është.

11 PY. Pra, sa për të qenë të qartë, kur keni thënë në
12 intervistën e ZPS-së që Shtabi i Përgjithshëm ka pasur
13 kontroll efektiv lidhur me personat që kanë në pozita
14 drejtuese ose në komandën e UÇK-së ky kuptim i juaji ka të
15 bëjë vetëm me atë çfarë ju keni ditur për zonën tuaj,
16 domethënë nuk është diçka që aplikohet ose është e vërtetë
17 edhe për zonat e tjera. A është e drejtë të thuhet kjo,
18 Dëshmitar?

19 PË. Po, zoti Avokat, realisht nisemi prej parimit aq sa unë
20 kam pas njohuri, respektivisht cili ka qenë raporti jem me
21 Shtabin e Përgjithshëm. E tash komanda të tjera kanë pas
22 raporte ma të rregullta respektivisht, ma nivel se unë, unë
23 ato nuk e di. Ose a kanë pas në nivel edhe më të ulëta, edhe
24 prapë atë nuk e di. Prandaj çdo herë diskutimet edhe
25 përgjigjet e mia janë të bazuar në përvojën teme që unë e kam

1 pas në atë kohë.

2 PY. Kur i keni bërë këto deklaratat, sa i takon Shtabit të
3 Përgjithshëm, ju e keni pas fjalën për Brigadën 123 në
4 periudhën tetor-nëntor kur keni qenë komandant i brigadës, apo
5 jo, Dëshmitar?

6 PË. Sigurisht.

7 Z. ROBERTS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, është momenti
8 i përshtatshëm për të bërë pushimin.

9 Faleminderit, Dëshmitar, do të takohemi përsëri bashkë
10 pas 30 minutash.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të bëjmë
12 pushimin e rregullt të planifikuar për orën 11.00 për 30
13 minuta. Do të kthehemi përsëri në orën 11.30. Mund të dilni
14 nga salla i shoqëruar nga Asistentja.

15 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të bëjmë
17 pushim deri në orën 11.30.

18 --- Pauza fillon në orën 10.29

19 --- Seanca rifillon në orën 11.29

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sillni
21 dëshmitarin, ju lutem.

22 Z. ROBERTS: [Përkthim] Për qëllime planifikimi, mund t'ju
23 njoftoj se mund të më nevojiten dhe rreth 45 minuta.

24 [Dëshmitari vijon dëshminë]

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull,

1 z. Fondaj, do vazhdojmë tani me pyetjet. Fjalën e ka ende z.
2 Roberts për të përfunduar pyetjet e veta.

3 Z. ROBERTS: [Përkthim] Faleminderit.

4 PY. Z. Fondaj, dëshiroj t'ju bëj disa pyetje për raportimet
5 që i bënin Shtabit të Përgjithshëm brigadat.

6 Para pushimit, ju thatë diçka, dhe thatë që "njohuria ime
7 lidhet kryesisht me kohën kur kam qenë vetë komandant brigade
8 i Brigadës 123, që nga data 8 ose 10 tetor deri në fund të
9 nëntorit, kështu?

10 PË. Po.

11 PY. Së pari, në intervistë flisni për raportimet që i bënte
12 Blerim Kuqi Bislime Zyrapit përpara se Blerim Kuqi të largohej
13 drejt Shqipërisë. Kjo ka ndodhur në gusht ose në fillim të
14 shtatorit 1998, saktë?

15 PË. Zoti Avokat, formën e raportimit që e ka pas Blerim Kuqi
16 në raport me Bislime Zyrapin unë nuk e di. Por Bislime Zyrapin e
17 kam pa gjatë asaj kohe disa herë në kuadër të zonës së
18 brigadës, respektivisht zonës ku ka operue fillimisht shtabi
19 rajonal e ma vonë edhe Brigada 123. E tash po nënkuptoj se ata
20 kanë pas në atë periudhë komunikim të rregullt. Kurse mënyrat
21 e komunikimit dhe çka ata kanë komunikuar, unë nuk jam në
22 dijeni.

23 PY. Po, më ndihmoi kjo. Por është supozim ama që ka pasur
24 raportime për faktin se ishin bashkë, por ama formalisht nuk e
25 ke parë asnjëherë z. Kuqi që t'i raportonte z. Zyrapit gjatë

1 kësaj periudhe kohore, apo jo?

2 PË. Jo, nuk e kam pa. Nuk kam qenë prezent unë gjatë
3 raportimeve të tij.

4 PY. Po ashtu i thatë ZPS-së që komandantët e brigadave
5 merrnin urdhra nga Shtabi i Përgjithshëm.

6 Z. ROBERTS: [Përkthim] Për referencë është në intervistën
7 për ZPS-në, Pjesa 3, faqja 6.

8 PY. Por a kam të drejtë unë kur them që dëshmia juaj në
9 lidhje me këtë është vetëm e bazuar në brigadën tuaj, dhe në
10 periudhën kohore tetor dhe nëntor? Apo po thoni ju që keni
11 dëshmi se dhe komandantët e tjerë kanë marrë urdhra nga Shtabi
12 i Përgjithshëm?

13 PË. Jo, unë çdo herë atë deklaratën që e kam dhanë e bazoj në
14 përvojën teme dhe punën teme që e kam pas si komandant
15 brigade. Ndërsa ma vonë komandantët e brigadave kanë raportu
16 në nivel zone, e jo në nivel Shtabi të Përgjithshëm. Po ajo
17 është periudha janar-shkurt e 1999.

18 PY. Keni qenë shef shtabi i zonës së Pashtrikut dhe të gjithë
19 komandantët e brigadave në atë kohë i raportnin komandant
20 Drinit, pra, Ekrem Rexhës?

21 PË. Saktë.

22 PY. Por përpara kësaj periudhe, në nëntor -- në tetor, në
23 nëntor, se po përpiqem ta kuptoj dëshminë tuaj më mirë, pra ju
24 dëshminë e kufizoni në faktin se ju besoni se keni marrë
25 urdhra nga Shtabi i Përgjithshëm. Apo po thoni ju që keni

1 njohuri që edhe komandantët e tjerë të brigadave kanë marrë
2 urdhra prej Shtabit të Përgjithshëm?
3 PË. Në fazën e nëntorit, po e përsëris, nëntorit 1998,
4 komandantët e brigadave kanë referue në Shtab të Përgjithshëm
5 edhe kanë pas takime të rregullta javore. Në 2-3 takime kam
6 marrë pjesë edhe unë, në, me, së bashku me komandantët e tjerë
7 të brigadave të zonës operative të Pashtrikut.

8 I kemi -- më falni -- i kemi raportue Sali Veselit që ka
9 qenë zëvendës i shefit të Shtabit në nivel -- të Shtabit të
10 Përgjithshëm.

11 PY. Këtu po përpiqesha të dilja dhe unë. Kur flisni për
12 Shtabin e Përgjithshëm është e rëndësishme të jemi të qartë se
13 për cilën person nga Shtabi i Përgjithshëm.

14 Ju nuk po flisni për z. Selimi sepse e bëtë të qartë se
15 s'e kishit parë më. Pra çdo lloj raportimi apo informacioni që
16 u jepej në atë kohë, i jepej Sali Veselit, apo jo? Këtë po
17 thoni?

18 PË. Ne kemi referu në drejtori operative të Shtabit të
19 Përgjithshëm edhe takimet kryesisht në q'atë periudhë i ka
20 mbajt Sali Veseli. Edhe një herë po e përsëris, me Rexhep
21 Selimin nuk jam taku në, gjatë luftës, përveç atyne dy rasteve
22 që i përmenda.

23 PY. Më falni, se mora një paralajmërim nga përkthyesit që të
24 pres, mos të nxitoj shumë që të bëj pyetjen se s'jam shumë i
25 zoti kështu për të pritur.

1 Që të jemi të qartë, z. Dëshmitar, ju nuk e dini se çfarë
2 ka bërë Sali Veseli me informatat që ju i jepnit atij?
3 PË. Këto nuk ka ditë -- nuk e dini çka ka bo? Por nuk e kam
4 pas unë, nuk kam qenë unë personi i cili është dashtë me ditë
5 çka është ka ban ai me ato të dhana dhe për çka është tuj i
6 marrë. Unë e kam kuptue se të dhanat që ne i kemi përcjell në
7 Shtabin e Përgjithshëm, respektivisht referimet që i kemi bo
8 atje, kanë qenë të karakterit operativ, respektivisht me to
9 është dashtë të manipulojë shefi i Shtabit dhe normale ta dijë
10 gjendjen qysh e ka mbrenda ushtrisë, respektivisht në bazë të
11 tyne të bajë edhe planifikimet e nevojshme.
12 PY. Por me siguri nuk e di, nuk e di me siguri, pra, nëse i
13 është përcjell pjesës tjetër të Shtabit të Përgjithshëm?
14 PË. Jo, nuk ka qenë e jemja me u marrë me atë problematikë.
15 Unë pikëpyetje punën teme a kam mujt me e kry në nivel, e le
16 ma të mirrem me çështje të punëve të të tjerëve.
17 PY. Qartë. Kur flisni për komandantët e tjerë të brigadave,
18 sepse ju kanë bërë pyetje edhe për Xhemajli Gashin, Xhemë
19 Gashin, në intervistë. Xhemë Gashi ishte larguar drejt
20 Shqipërisë në shtator, apo jo? Shtator 1998.
21 PË. Saktë datat nuk i di, por që ka qenë në territorin e
22 Shqipërisë në fazën e muajit tetor, e di. Që është kthi në
23 nëntor, gjithashtu e di.
24 PY. Dhe emërimi juaj si komandant i Brigadës 123, ka ndodhur
25 në periudhën ku kishte ofensiva të mëdha serbe gjatë verës,

1 dhe besoj se kolegu im dje foli dhe për shpartallimin që u
2 krijoi kjo, apo për dëmtimin e madh që u bëri forcave të UÇK-
3 së në atë zonë, apo jo?

4 PË. Emërimi jem vjen pas ofensivave, respektivisht thymjeve
5 të mëdha që i patëm në atë kohë.

6 PY. Dhe kjo krijoi goxha përçarje edhe brenda brigadës, sepse
7 disa persona u larguan drejt Shqipërisë, por pati edhe ushtarë
8 që u vranë gjatë ofensivës, apo jo? I shkaktoi dëm brigadës
9 suaj.

10 PË. Sigurisht që pat dame, edhe damet kenë jashtëzakonisht të
11 mëdhaja. Edhe humbje në njerëz, por edhe shkatërrim të të
12 mirave materiale, qoftë të ushtrisë, qoftë edhe të qytetarëve
13 në atë rajon.

14 PY. Tani dua të kaloj tek tema e fundit, që ka të bëjë me
15 Drejtorinë e Policisë Ushtarake. Për këtë ju bëri pyetje, ju
16 është bërë një pyetje gjatë intervistës me ZPS-në, veçanërisht
17 për një dokument. Besoj se ju e keni përgatitur këtë dokument
18 më 10 nëntor 1998 drejtuar policisë ushtarake të UÇK-së, për
19 shkak të pretendimeve se kishte persona që përfaqësoheshin si
20 polici ushtarake dhe ishin nën komandën e Ukë Gegaj, dhe bëhej
21 fjalë dhe për një automjet Land Rover që ishte pjesë e
22 brigadës që e kishte Brigada 123.

23 Në terma të përgjithshme, ju kujtohet ky shkëmbim me
24 Prokurorinë?

25 PË. Po.

1 PY. Sipas kërkesës që keni përgatitur ju vetë më 10 nëntor
2 1998, këta policë ushtarakë që erdhën në Nishor kishin një
3 vendim të nënshkruar prej Ukë Gegajt, që ju besonit se ishte
4 anëtar i policisë ushtarake të Shtabit të Përgjithshëm. Dhe në
5 atë urdhër, thuhej që duhej t'ia jepnin këtë automjet Brigadës
6 121, kështu?

7 PË. Në bazë të asaj që unë e kam lexue javën e kalume,
8 përmbajtjen e atij dokumenti, qëndron fakti se Ukë Gegaj ka
9 qenë brenda Brigadës 121, por e përdor një vulë që është
10 policia ushtarake e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së.

11 PY. Mirë, shohim dokumentin më mirë në ekran, që t'ju bëj
12 pyetje të mëtutjeshme.

13 Z. ROBERTS: [Përkthim] Bëhet fjalë për dokumentin që mban
14 numrin U003-3306 ndërsa shqipja është me numër IT-03-66 P29.
15 Besoj se është një provë materiale e Prokurorisë se shoh
16 kolegun që u çua në këmbë.

17 Z. HALLING: [Përkthim] Po, me të drejtë, është prova
18 materiale P1332.

19 Z. ROBERTS: [Përkthim]

20 PY. Që të jemi të qartë, në intervistën për ZPS-në, po edhe
21 gjatë kundërpjetjeve, ju thatë se drejtori i Drejtorisë Së
22 Policisë Ushtarake pranë Shtabit të Përgjithshëm nuk ishte në
23 gjendje t'ju lëshonte urdhra ju si komandant brigade, përgjatë
24 gjithë luftës. Pra, nuk ishte në gjendje që t'ju jepte ju
25 urdhra, kështu?

1 PË. Realisht kështu është dashtë me qenë. Dhe unë nuk kam
2 marrë urdhra nga drejtoria politike -- Drejtoria e Policisë
3 Ushtarake.

4 PY. Edhe rrjedhimisht, nëse do të vinte ndonjë urdhër, ju
5 mund ta shpërfillnit nëse dëshironit sepse nuk ishit të
6 detyruar që ta zbatonit, apo jo? Si komandant brigade, që të
7 jemi të qartë.

8 PË. Gjithsesi, por me siguri që do ta njoftoja shefin e
9 Shtabit për interferim, respektivisht për ndërhyrje nga
10 persona të paautorizuar.

11 PY. Kuptoj. Duke ndjekur këtë logjikë, atëherë iu takon që
12 Drejtoria e Policisë Ushtarake nuk mund të lëshonte urdhra për
13 njësitet e policisë ushtarake në një zonë sepse ata ishin nën
14 kompetencën e komandantit të brigadës, apo jo?

15 PË. Kështu është dashtë me qenë edhe realisht në kohën sa kam
16 qenë komandant brigade, q'ashtu ka funksionu.

17 PY. Faleminderit. Veçanërisht për këtë dokument i keni thënë
18 ZPS-së që ka qenë një dokument i falsifikuar prej z. Gegaj dhe
19 i panënshkruar nga z. Limaj. Është në Pjesën 8 të intervistës
20 suaj, faqja 14.

21 Tani, me sa kuptoni ju, nga ky dokument, dhe nga ky rast,
22 z. Gegaj mund të ketë menduar që duke i vendosur vulën një
23 dokumenti, një vulë pra që ishte vula e policisë ushtarake, do
24 t'i jepte atij më shumë legjitimitet, thjesht duke vendos një
25 vulë?

1 PË. Sigurisht, prandaj në këtë -- në këtë incident unë i kam
2 marrë Ukë Gegës këtë vendim që e quan ai, edhe të njëjtin, në
3 bazë të njëjtit kam ba ankesë, a kopjen e këtij vendimi ia kam
4 përcjellë shefit të Shtabit, Bislim Zyrapi.

5 PY. Pra, mund të ketë qenë, a mund të ketë ndodhur që z.
6 Gegaj të ketë vepruar me mendjen e vet, apo jo?

7 Z. HALLING: [Përkthim] Kundërshtoj, kjo kërkon spekulim.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet,
9 mund të përgjigjeni.

10 DËSHMITARI:

11 PË. Unë nuk i di realisht, tash për këtë çështje ndoshta
12 është ma mirë me pyet Ukë Gegën. Unë nuk e di. Kryesorja
13 nënshkrimi është i Ukë Gegës. A vula është e policisë
14 ushtarake të Shtabit të Përgjithshëm.

15 Z. ROBERTS: [Përkthim]

16 PY. Sa i takon marrëdhënies me Drejtorinë e Policisë
17 Ushtarake, ju keni qenë shumë i qartë në Shënimin përgatitor
18 numër 1, për referencë është me numër 1328, paragrafi 39. Pra,
19 ju keni thënë që askush nuk ka njoftuar se kur është krijuar
20 Drejtoria e Policisë Ushtarake, as nuk keni qenë pjesë e
21 policisë ushtarake, e andaj nuk e dini se kur është krijuar.

22 Tani, për faktin se ky dokument pretendohet se mban një
23 vulë të policisë ushtarake, kjo nuk do të thotë, kjo nuk do të
24 thotë se ky dokument vërtet ka qenë i lëshuar prej tyre, apo
25 jo?

1 PË. Në bazë të shkresës këtu është e citume komplet
2 përmbajtja e vendimit. Thuhet që Ushtria Çlirimtare e Kosovës,
3 Brigada 121, Agim Qelaj, Coli. E cila pastaj ma vonë edhe ka
4 ndërru edhe emrin kjo brigadë, por këtu fillimisht në q'atë
5 kohë q'ashtu është titullu. Vendim, me arritjen e komandës së
6 brigadës -- e kështu me radhë, ne jse mos ta lexoj tash
7 përmbajtjen saktë të këtij vendimi.

8 Thuhet që ata kanë një lloj autorizimi me ardh me marrë
9 këtë automjet. Edhe vijnë me marrë, edhe unë çka thashë e kam
10 ndal automjetin, por edhe këtë vendim. A vendimi mban vulën,
11 me përgjegjësi e them se është e shkruar këtu që është policia
12 ushtarake e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së. Prandaj, edhe
13 unë i kam bo kërkesë Drejtorisë së Policisë Ushtarake tuj pas
14 parasysh shënimin që ka qenë në vulë, që njoftohet me këtë
15 problematikë dhe t'i jep vërejtje personit në fjalë.

16 PY. Që të jemi të qartë, po ju vetë nuk e dini
17 drejtpërsëdrejti nëse në këtë kohë ka ekzistuar Drejtoria e
18 Policisë Ushtarake pranë Shtabit të Përgjithshëm. Pra, në
19 datën që mban ky dokument, 10 nëntor 1998, ju nuk e dini a
20 ekzistonte fare Drejtoria e Policisë Ushtarake, apo jo?

21 PË. Prej pozicionit të sotit nuk muj me spekuluar a e kam dit a
22 s'e kam dit.

23 PY. Faleminderit. Faleminderit, Dëshmitar.

24 Z. ROBERTS: [Përkthim] Në fakt mbarova përpara
25 planifikimit që kisha dhënë, por përfundova me pyetjet e mia.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Ellis.

2 Z. ELLIS: [Përkthim] Një çast, sa të organizohem.

3 Pyetje të palës tjetër nga z. Ellis:

4 Z. ELLIS: [Përkthim]

5 PY. Mirëdita. Mirëmëngjes, biles, Dëshmitar.

6 PË. Mirëdita.

7 PY. Quhem Aidan Ellis dhe unë përfaqësoj z. Jakup Krasniqi.

8 Z. ELLIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, për qëllime
9 planifikimi, mund t'ju them që unë do të vazhdoj deri në
10 pushimin e drekës.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
12 z. Ellis.

13 Z. ELLIS: [Përkthim]

14 PY. Z. Fondaj, do të doja të flasim pak për Negrocën dhe
15 datën 10 qershor 1998. Ju besoj se thatë që ju deshët të
16 shkonit atje që të takoheshit me Sokol Bashotën dhe se Sokol
17 Bashota ua shpjegoi se si të bëheshit anëtar i UÇK-së, kështu?

18 PË. Ditën e 10 qershorit 1998, unë kam shku në Negroc me
19 Blerim Kuqin i cili paraprkishtë ka pas biseda me Sokol
20 Bashotën në lidhje me sistemimin tim në Ushtrinë Çlirimtare të
21 Kosovës. Pra, për këtë qëllim kam shku, me u sistemu dhe me
22 qenë pjesë e UÇK-së.

23 PY. Por, nuk e kishit për qëllim që të takonit dhe Jakup
24 Krasniqi, ai thjeshtë rastisi atje sepse një prej takimeve u bë
25 tek shtëpia e tij, apo jo?

1 PË. Jo, unë nuk u nisa për me u taku me Jakup Krasniqin, por
2 me Rexhep -- me, më falni, Sokol Bashotën për qëllim të
3 sistemimit. Por, realisht takimi është mbajt në shtëpinë e
4 Jakup Krasniqit, aty e kam taku edhe z. Krasniqi. Tash, për
5 hir të rrethanave, po tregoj, komplet familja e tij ka qenë në
6 shërbim të luftës në atë periudhë, edhe realisht unë më duhet
7 me përmend dhe me thanë se kam hangër bukë atë ditë aty. Nuk
8 ka qenë obligim i familjarëve të tij të përgatisin lloj-lloj
9 ushqimi për ushtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, por e
10 kanë bo, edhe unë kam hangër bukë atë ditë.

11 PY. Faleminderit. Kjo ka ndodhur rreth periudhës kur u mor
12 dhe vendimi që të emërohej Jakup Krasniqi si zëdhënës i UÇK-
13 së, apo jo?

14 PË. Dëshminë e Nuhi Bytyqit e kam përcjell që e ka dhënë këtu
15 në Gjykatë, edhe del që domethënë deklarata e parë e Jakup
16 Krasniqit është e dikund e datës 14 qershor. Po atë e kam
17 mbajt mend në bazë të dëshmisë që e ka dhanë Nuhi Bytyqi.
18 Përndryshe nuk e di. Nuk e di, përpara nuk e kam ditë. Kam
19 harru.

20 PY. Faleminderit. Dje në përgjigje të pyetjes së z. Misetic
21 ju thatë se në atë kohë nuk kishit asnjë informacion lidhur me
22 postin apo pozitën e z. Bashota, ju kujtohet kjo dje?

23 PË. Nuk e di. Me të vërtetë s'po e kuptoj. Por megjithatë z.
24 Bashota ka pas një funksion udhëheqës edhe unë e kam prit që
25 ai me më sistemu mu në kuadër të ushtrisë. Ne kemi bisedu

1 rreth angazhimit tim në Ushtrinë Çlirimtare dhe ai më tha që
2 nuk ka materie për çështjen që mund me planifikue mue në
3 kuadër me më sistemu, prandaj më thotë që "rri dhe një
4 periudhë mos u angazho në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës".

5 Për faktin se fillimisht forma e veprimit ka qenë formë
6 guerile e ushtrisë. E unë si epror ushtarak normale që në atë
7 periudhë s'kam mujt me dhanë kontributin tem për veprime
8 guerile. Mirëpo, veç në atë periudhë Ushtria Çlirimtare e
9 Kosovës, respektivisht disa formacione ushtarake siç ishin
10 Lisi, por dhe Çeliku 50, fillun me qenë njësi të stacionuara,
11 me vendos barrikada në pjesë të caktume. Prandaj, kur u sqarum
12 mirë me Sokol Bashotën, atëherë ishte sugjerimi i tij që,
13 "shko ndihmoji Blerim Kuqit", edhe unë ashtu veprova.

14 Z. ELLIS: [Përkthim] Shohim në ekran provën materiale
15 P00847 si në shqip dhe në anglisht. Ose mund t'ju jap dhe
16 numrin SITF00243000, faqja e tretë të paktën tek anglishtja.
17 Ju lutem të shkojmë më poshtë tek anglishtja.

18 PY. Dëshmitar, ju kujtohet që gjatë intervistës me
19 Prokurorinë në 2019, ju treguam një kopje të intervistës që
20 kishte dhënë Azem Sylja?

21 PË. Po.

22 PY. Do t'ju lexoj një rresht. Thotë:

23 "Zëvendësi im Sokol Bashota u vendos në krye të Shtabit
24 të Përgjithshëm që kreu të dyja detyrat gjatë gjithë periudhës
25 mes dy takimeve të Rambujesë".

1 A ju kujtohet ta keni parë këtë fjali, Dëshmitar?

2 PË. Këtë dokument e kam pa pra në 2019. Ma herët, jo. Kështu
3 që për përmbajtjen e saj të plotë nuk jam i njoftum se nuk e
4 kam lexu këtë material. Por pjesa këtu me që janë diskutu në
5 fazën e marrjes në pyetje nga ZPS-ja ato figuronin në
6 stenogramet e deklaratës teme.

7 PY. Dhe nëse e ka thënë Azem Sylja këtë gjatë intervistës, ju
8 s'keni ndonjë arsye për ta kontestuar, sa i takon z. Bashota,
9 apo jo -- pozitës së z. Bashota?

10 PË. Jo -- nuk du me u lëshu në çështjet e kësaj problematike
11 se nuk i di.

12 PY. Në rregull. Pasi u takuat me Sokol Bashotën, atëherë, ju
13 jeni takuar dhe me Bislum Zyrabin, apo jo, Dëshmitar?

14 PË. Po, të njëjtën ditë pasdite, pra, jam taku edhe me Bislum
15 Zyrabin. Edhe atë natë, domethënë mbramje, kemi ndejtë bashkë
16 që po e përmendi edhe një herë, Bislum Zyrabi, Agim Qelaj edhe
17 unë, në një shtëpi në brendi të fshatit edhe kam bujt atë
18 natë. Të nesërit sërish, në shtëpinë e Jakup Krasniqit jam
19 kthy, edhe nga aty jam kthy për një, për Semetisht,
20 respektivisht në rajonin e Suharekës.

21 PY. E kuptojmë. Kur përmendët Blerim Kuqin, që ju ka njoftu
22 për aktivitetet ose veprimtaritë ushtarake, e keni fjalën këtu
23 që ka njoftu Sokol Bashotën dhe Bislum Zyrabin, apo jo,
24 Dëshmitar?

25 PË. Kështu, domethënë, Blerim Kuqi ka qenë në kontakt me

1 Sokol Bashotën deri më 10 qershor. Më 10 qershor unë kam
2 kontakti për herë të parë Bislime Zyrapi. Ai domethënë sipas
3 asaj që e di unë, ai ka qenë në Kosovë nga fundi i majit të
4 vitit 1998.

5 Kështu që, Blerim Kuqi nuk besoj ta ketë taku para 10
6 qershorit Bislime Zyrapi. Por kontaktet Blerim Kuqi i ka pas
7 me Sokol Bashotën, respektivisht me të tjerët, me krerët e
8 tjerë të asaj kohe të UÇK-së.

9 PY. E kuptojmë. Në këtë rast, kjo ka qenë hera e parë që e
10 keni takuar Jakup Krasniqin, apo jo, Dëshmitar? Ta bëj
11 ndryshe. Atëherë, përpara datës 10 qershor 1998, juve nuk e
12 kishit takuar ndonjëherë Jakup Krasniqin, apo jo, Dëshmitar?
13 PË. Nuk e di që e kam taku, nuk e kam njoft paraprakisht.
14 Prej asaj dite e njoh.

15 PY. Kur jeni përgjigjur pyetjeve të Prokurorisë në
16 intervistën e 1998 [Korrigjim i përkthyesit: në 2019] ju thatë
17 që rreth marsit ose majit të 1998, Blerim Kuqi ka kontaktuar
18 me Jakup Krasniqin. Ti personalisht vetë nuk është se ke qenë
19 pjesë e kontakteve që mund të ketë pasur Blerim Kuqi që thoni
20 që ka pasur me Jakup Krasniqin, apo jo, Dëshmitar?

21 PË. Nëse kam thanë, nuk e di, në çfarë informacioni kam mujt
22 me pas. Por është mendue me krerët e UÇK-së. Nëse kam thanë,
23 nuk e di, prej pozicionit të sotit mujt me thanë që ka qenë
24 gabim ajo.

25 PY. E kuptojmë. Dje mendoj që konfirmuat që Blerim Kuqi ishte

1 pjesë e LDK-së edhe se ai ka punuar si pjesë e shtetit paralel
2 në Suharekë, si pjesë e këshillit apo jo, Dëshmitar? Është e
3 saktë kjo?

4 PË. Po.

5 PY. A jeni në dijeni që në komunën e Glllogocit Jakup Krasniqi
6 ka qenë kryesuesi i komunës dhe se edhe ai ka punuar me
7 qeverisjen paralele në atë -- [Korrigjim i përkthyesit: ka
8 qenë kryesuesi i LDK-së në komunë në atë kohë]?

9 PË. Jam i njoftum.

10 PY. Blerim Kuqi dhe Jakup Krasniqi e njihnin njëri-tjetrin
11 nga puna në shtetin paralel, apo jo, Dëshmitar?

12 PË. Nuk isha lëshu në diskutime se nuk e di. Por ma merr
13 mendja që e njoft.

14 PY. Po, është me vend kjo përgjigje që sapo thatë, sepse në
15 qoftë se nuk e dini përgjigjen, është me vend të thoni që nuk
16 e dini, Dëshmitar. Megjithatë, Blerim Kuqi ka qenë bashkë me
17 ty kur keni shkuar në Negrovç më vonë atë ditë, apo jo,
18 Dëshmitar?

19 PË. Po, po, bashkë kemi udhëtu. Por, me qëllim edhe një herë
20 po e përmendi, të takohem me Dhjetëshin që ma vonë e kam
21 konstatu se është, bëhet fjalë për Sokol Bashotën.

22 PY. Blerim Kuqi ka qenë me ty kur keni ngrënë tek shtëpia e
23 Jakup Krasniqit, ju, Dëshmitar?

24 PË. Nuk më kujtohen detajet, po aty kemi hangër edhe drekë
25 edhe darkë. Edhe shtëpia e tij është kanë një thjesht, nuk

1 mundet të përshkruhet, nuk mund të përshkruhet me fjalë.

2 Nji shtëpi bamirëse edhe kontributdhanëse e
3 jashtëzakonshme. Prandaj dhe më dha emocion kur u kujtu kjo
4 çështja.

5 PY. Ishte një shtëpi bujare që ju priti juve dhe Blerim Kuqin
6 të dyve, apo jo, Dëshmitar?

7 PË. Jo vetëm neve të dyve, por shumë e shumë ushtarë të tjerë
8 e struktura të tjera të UÇK-së. Dhe njerëzve të tjerë që
9 kalonin asaj pari, asaj rruge.

10 PY. Besoj që Blerim Kuqin ju e keni njohur që kur keni qenë
11 në shkollë apo jo, Dëshmitar?

12 PË. Po, e kam njoft prej klasës së parë të shkollës fillore.
13 Unë kam qenë nja tri vite në gjeneratë pak ma i vjetër. E kam
14 njoft prej atëherë se ai ka qenë në klasë me vëllaun tim.

15 PY. Dhe në vitin 1998, ai ishte një person me ndikim në
16 Suharekë, në zonën e Suharekës, apo jo, Dëshmitar?

17 PË. Sigurisht. Ka qenë punëtor i madh.

18 PY. Njësitë Lisi dhe më pas Brigada 123 po rriteshin në numër
19 pjesërisht nga kontributi i Blerim Kuqit në ato ditët e
20 hershme, në ato ditët e para apo jo, Dëshmitar?

21 PË. Po, krahas kontributit të Blerim Kuqit, lidhet edhe
22 personaliteti i Ukë Bytyqit. Këta të dy kanë qenë njerëz me
23 autoritet ma të lartë në atë periudhë në komunën e Suharekës,
24 të cilët i kanë dhanë një kontribut të jashtëzakonshëm
25 çështjes së luftës për çlirimin e Kosovës.

1 PY. Tani do të kalojmë te disa pyetje që kanë të bëjnë me
2 arrestimin e Blerim Kuqit në janar të vitit 1999. Do të bëj
3 disa pyetje të shkurtra dhe do ju kërkoj që të përgjigjeshit
4 me "po" ose "jo" në qoftë se është e mundur, në mënyrë të
5 tillë që të vazhdojmë me pyetjet e radhës.

6 Juve vetë nuk keni qenë të pranishëm fizikisht në
7 momentin kur është arrestuar Blerim Kuqi, apo jo, Dëshmitar?

8 PË. Jo, nuk kam qenë.

9 PY. Dhe ju nuk e dini se kush e ka arrestuar Blerim Kuqin apo
10 kush ka urdhëruar arrestimin e tij, a është e drejtë të thuhet
11 kjo, Dëshmitar?

12 PË. Nuk e di.

13 PY. Ti vetë nuk është se ke folur ndonjëherë me Blerim Kuqin
14 lidhur me arrestimin ose ndalimin e tij pasi u lirua ai, apo
15 jo, Dëshmitar?

16 PË. Jo, nuk kam bisedu kurrë.

17 PY. Kur jeni intervistuar nga ZPS-ja në 2019, i keni thënë
18 Prokurorisë që Jakup Krasniqi e ka ftuar Blerim Kuqin për
19 konsultime. A të kujtohet ta keni thënë këtë, Dëshmitar?

20 PË. Kam mujt me thanë se mue, unë kam pas kontakte të
21 rregullta me Ekrem Rexhën, edhe pohimet e Ekrem Rexhës kanë
22 qenë se këta, domethënë Blerim Kuqi dhe Nexhmedim Kastrati
23 edhe Ekrem Rexha kanë shku për një konsultim në Shtab të
24 Përgjithshëm me ftesë të Jakup Krasniqit. Dhe si rezultat,
25 pastaj ka ndodhë ajo që Blerimi është ndalu. Pra ky është ai

1 informacion që unë e kam pas në atë periudhë, prandaj edhe kam
2 thanë, kam mujt me thanë.

3 PY. Dëshmitar, mund të vazhdojmë, apo keni nevojë për pushim?

4 PË. Jo, jo, mundmi të vazhdojmë.

5 PY. Faleminderit. Ti vetë personalisht nuk ke qenë asnjëherë

6 i pranishëm në këtë konsultim ndërmjet Drinit, Nexhmedin

7 Kastratit, Blerim Kuqit në Divjakë, apo jo, Dëshmitar?

8 PË. Jo, nuk kam qenë.

9 PY. Dhe si rezultat ju nuk e dini se çfarë është diskutuar në
10 këtë takim, apo jo, Dëshmitar?

11 PË. Realisht kur është kthyer Ekrem Rexha, nga Kleçka,

12 respektivisht Divjaka, ka qenë i frustrum dhe s'kemi mujt as
13 me zhvillu bisedë.

14 PY. A jeni në dijeni që Nexhmedin Kastrati ka thënë që në
15 takim janë diskutuar për çështje që kanë të bëjnë me kufijtë e
16 brigadave dhe çështje që kanë të bëjnë me kurset e përgatitjes
17 për udhëheqësit e batalionit? A jeni në dijeni të kësaj gjëje,
18 Dëshmitar?

19 PË. Jo, jo, nuk kam në dijeni fare rreth bisedës që ata kanë
20 pas.

21 PY. Në rregull. Pasi dëgjuat që Blerim Kuqi ishte arrestuar,
22 ju dëshironit të dini se çfarë kishte ndodhur dhe keni

23 biseduar me shumë njerëz domethënë me persona të ndryshëm

24 lidhur me këtë incident, apo jo, Dëshmitar?

25 PË. Ndoshta me shumë jo, por me disa kam bisedu.

1 PY. Në seancën përgatitore me Prokurorinë javën e shkuar, ju
2 sqaruat që nuk ju kujtohet në qoftë se keni folur
3 drejtpërdrejt me Jakup Krasniqin, për Blerim Kuqin, apo në
4 qoftë se të kishte thënë dikush tjetër ty se çfarë kishte
5 thënë Jakup Krasniqi? A është e saktë kjo, Dëshmitar?

6 PË. Vërtet nuk më kujtohet.

7 PY. Në intervistën tuaj thatë që Jakup Krasniqi më vonë ka
8 thënë që nuk ka qenë në dijeni të faktit që Blerimi ishte
9 arrestuar. A ju kujtohet kjo, Dëshmitar?

10 PË. Diçka sikur që thojmë na në gjuhën shqipe, si nëpër
11 mjegull, më duket, por nuk jam i sigurt.

12 PY. A ju kujtohet të keni folur me Bislim Zyrapin lidhur me
13 rastin e Blerim Kuqit?

14 PË. Me Bislim Zyrapin po, kemi bisedu në detaje. Dhe i kam
15 sqaru se Blerim Kuqi nuk bën të, domethënë, duhet të sqarohet
16 rasti se Blerim Kuqi nuk ka dezertu. Ekziston gabim në
17 interpretim rreth çështjes së arrestimit të tij, sepse Blerim
18 Kuqi veç në atë kohë, fakt, e kishte ndihmu dukshëm Ushtrinë
19 Çlirimtare të Kosovës.

20 PY. A e dini se Bislim Zyrapin ka qenë në komunikim me Sokol
21 Dobrunën lidhur me rastin e z. Kuqi, Blerim Kuqi, Dëshmitar?

22 PË. Nuk i di detajet edhe formën e organizimit edhe të
23 veprimit të tyre në nivel të Shtabit të Përgjithshëm, këtë
24 kohë nuk i di.

25 PY. Por në atë kohë e dinit që Bislim Zyrapin ka qenë shef i

1 Shtabit, apo jo, Dëshmitar?

2 PË. Sigurisht, e di.

3 PY. Dhe arsyeja se pse shkuaat për t'u takuar me të ishte se
4 ai ishte shefi i Shtabit, apo jo, Dëshmitar?

5 PË. Po. Por dhe ka qenë edhe, domethënë, në takim momenti kur
6 unë e kam dhanë deklaratën para Sokol Dobrunës. Po e përmendi
7 edhe një herë, deklaratën unë e kam dhanë para Sokol Dobrunës.
8 Prandaj edhe pretendoj se ai ka qenë prokuror e jo gjyqtar në
9 rastin e Blerim Kuqit.

10 PY. Dhe ju menduat që përderisa Bislime Zyrapi ishte shef
11 Shtabi ai kishte mundësi që të bënte diçka lidhur me rastin e
12 Blerim Kuqit, kështu, Dëshmitar?

13 PË. Unë kisha bindjen se deklarata e Bislime Zyrapit duhet me
14 qenë vendimtare për fatin e Blerim Kuqit, prandaj edhe kam
15 komunikuar me Bislime Zyrapi duke i sqaruar në detaje çështjen e
16 shkuarjes së tij në Shqipëri.

17 Z. ELLIS: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretarit që tani të
18 paraqesë në ekran provën materiale P1344, që njihet ndryshe me
19 numër SPOE0023264.

20 PY. Dëshmitar, besoj se ju kujtohet që ky dokument ju tregua
21 nga Prokuroria, e keni parë edhe dje, edhe një javë më herët,
22 dhe besoj që ju keni konfirmuar që këtë dokument nuk e keni
23 parë përpara se sa t'ju tregonte atë Prokuroria. A është e
24 vërtetë kjo, Dëshmitar?

25 PË. E vërtetë.

1 Z. ELLIS: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretarit të kalojmë
2 në fund të faqes që kemi përpara në ekran.

3 PY. Shoh emrin në fund të dokumentit, që është Arben Sejdiu.
4 A e keni njoh ndonjë person me këtë emër në atë kohë,
5 Dëshmitar?

6 PË. Jo. Dhe çuditem fort.

7 PY. Ju nuk e dini se kush mund ta ketë shkruar këtë dokument,
8 apo jo?

9 PË. Jo, nuk e di, edhe po them me të vërtetë jam i befasum,
10 dhe po më duket tamam si në filmat e Hitchcock-ut.

11 Z. ELLIS: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretarit të kalojmë
12 tek faqja e parë e të njëjtit dokument, nën pjesën ku lexohet
13 "Propozoj". Ju lutem kaloni pak më poshtë tekstin dhe në
14 shqip.

15 PY. Dje, Dëshmitar, thatë në faqen 32 të transkriptit
16 provizor që:

17 "... Ekrem Rexha më informoi që duhet të shkoja në Kleçkë
18 për një deklaratë të lidhur me Blerim Kuqin."

19 Dhe më pas ju sqaruat që mund të jetë e drejtë që mund të
20 keni shkuar atje me kërkesë të avokatit mbrojtës të Blerim
21 Kuqit.

22 Këtu thuhet që prokurori donte që, prokurori donte,
23 domethënë, që të lëshonte një fletëthirrje për të marrë pjesë
24 në atë proces, në seancën dëgjimore. Pyetja që kam për ju
25 është kjo, në fakt a ka ndodhur kështu, domethënë prokurori a

1 ka lëshuar një fletëthirrje për juve për të marrë pjesë në atë
2 seancë?

3 PË. Zotëri Avokat, edhe një herë po e përmendi, unë i jam
4 përgjigj një njoftimi që ma ka dhanë Ekrem Rexha për me shku
5 në Shtab të Përgjithshëm, respektivisht në Divjakë, për me
6 dhanë një deklaratë prokurorit të Ushtrisë Çlirimtare të
7 Kosovës për rastin e Blerim Kuqit. Unë kur kam shkue, edhe e
8 kam dhanë deklaratën, deklaratën e kam dhanë para Sokol
9 Dobrunës, e jo para prokurorit për të cilin, emri i të cilit
10 figuron këtu në këtë propozim, respektivisht këtë dokument që
11 e kam këtu përpara vetes.

12 PY. Shoh që ky dokument, i referohet "veprës penale të
13 dezertimit arbitrar të detyrës që specifikohet në nenin 29,
14 seksioni 1 dhe 2 të DLP-së të UÇK-së".

15 A ju kujtohet se për çfarë bëhet fjalë kur flitet për
16 nenin 29, paragrafi 1 dhe 2 i DLP-së së UÇK-së, Dëshmitar?

17 PË. Jo, jo. Nuk muj me u lëshu tash me dokumenta se i kam
18 harrue. Edhe nëse helbete i kam pas në dorë, por këso
19 dokumente s'besoj që unë i kam pas mundësi me pasë qasje në
20 to. Edhe nëse kanë ekzistuar.

21 PY. Ju thoni që edhe në qoftë se kanë ekzistuar, ju nuk i keni
22 parë, domethënë megjithatë ju nuk e dini në qoftë se janë
23 shkruar apo janë prodhuar dokumente të tilla nga UÇK-ja në atë
24 kohë, apo jo, Dëshmitar?

25 PË. Pikërisht, këtë deshta të thoja.

1 PY. Sipas pikëpamjes tuaj, mund të jenë hartuar dhe më pas
2 këto dokumente, këtë do të thuash, Dëshmitar?

3 PË. Jo, s'kam pas qasje domethënë nuk i dija edhe a kanë
4 ekzistuar ndonjëherë edhe a ekzistojnë edhe sot.

5 PY. Kur shkua në Divjakë, ju deklaratën e dhatë përpara
6 Sokol Dobrunës, apo jo, Dëshmitar?

7 PË. Saktë. Prezent ka qenë edhe avokati mbrojtës i Blerim
8 Kuqit dhe një procesmbajtës.

9 PY. Kur thoni "avokati mbrojtës i Blerim Kuqi", e keni fjalën
10 për Agron Berishën?

11 PË. Saktë.

12 Z. ELLIS: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretarit tani të na
13 paraqesë në ekran dokumentin që është pranuar në provë P1345,
14 që është SPOE002318141.

15 PY. Përsëri, ky është një dokument që jua tregoi Prokurori
16 gjatë dëshmisë dje. Megjithatë është një dokument që nuk e
17 keni parë gjatë konfliktit, apo jo, Dëshmitar? Që ta sqarojmë
18 këtë pikë përpara.

19 PË. Jo, këtë dokument e kam pa në javën që shkoi me, para
20 Prokurorit.

21 PY. Nuk keni mundësi të thoni se kush e ka shkruar këtë
22 dokument apo kur është shkruar ky dokument, apo jo, Dëshmitar?

23 PË. S'jam në dijeni realisht të këtij dokumenti -- të këtij
24 dokumenti.

25 Z. ELLIS: [Përkthim] Të kalojmë në fund të faqes -- jo,

1 në fakt, në fund të faqes së dytë. Ju kërkoj ndjesë, tek faqja
2 e fundit e dokumentit. Në fund të faqes së fundit.

3 PY. Në fund të këtij dokumenti nuk ka një emër. Nuk është se
4 ka, domethënë, thjesht thuhet "Mbrojtësi", por ndërkohë nuk
5 është se jepet një emër. A është kështu, Dëshmitar?

6 PË. Po, në ekran është i njëjti. Domethënë, veç "Mbrojtësi"
7 nuk figuron kurrëgjë për fundi.

8 PY. Në seancën përgatitore përpara një jave, një ndër gjërat
9 që i keni thënë Prokurorisë është kjo, që shumë pak njerëz në
10 UÇK kanë pasur kompjuter në atë kohë. A i qëndroni këtij
11 qëndrimi, kësaj deklaratë dhe sot, Dëshmitar? Këtij mendimi, i
12 qëndroni dhe sot?

13 PË. Po, po.

14 PY. Dhe në qoftë se do të ketë pasur ndonjë kompjuter të
15 disponueshëm, këtë kompjuter nuk mund ta përdorte gjithkush,
16 apo jo?

17 PË. Saktë.

18 PY. Prokuroria mendon që ky dokument, edhe dokumenti që pamë
19 më përpara, mund të jetë prodhuar nga i njëjti vend. A mund të
20 ketë ndodhur kështu në fakt që edhe prokuroria edhe dëshmitari
21 [Sipas përkthimit] të mund të kenë punuar nga i njëjti
22 kompjuter?

23 PË. Eh, gjithçka është e mundun, por megjithatë unë kurrë në
24 sende nuk isha lëshu në këtë diskutim se nuk kam kurrfarë
25 njohurie. Edhe supozimin ma të vogël s'muj me e pohu, se nuk

1 kam kurrfarë prove që muj me thanë se është kjo apo s'është.

2 PY. Na konfirmuat që keni folur me Bislím Zyrapi lidhur me
3 këtë rast. Bislím Zyrapi, a të tregoi ty që ishte konsultuar
4 me Sokol Dobrunën lidhur me këtë rast?

5 PË. Momentin kur unë e kam dhanë dëshminë, në lokalet e
6 komandës së UÇK-së, respektivisht Shtabit të Përgjithshëm, të
7 njëjtën ditë jam takue me Bislím Zyrapi. Edhe Bislím Zyrapi,
8 nëse s'gabo, duhet me ditë që unë kam dhanë, se i kam tregue,
9 dhashë dëshminë para Sokol Dobrunës, pra ai duhet me ditë që
10 unë dëshminë e kam dhanë para Sokol Dobrunës. Edhe të njëjtën
11 ditë kemi komuniku dhe i kam kërkue që të jetë vigjilent edhe
12 të ketë shumë kujdes në rastin e Blerim Kuqit.

13 PY. Ky ka qenë i vetmi komunikim që keni pas me Bislím
14 Zyrapi lidhur me këtë rast, Dëshmitar?

15 PË. Jo. Dhe në disa raste të tjera kemi komuniku edhe bisedu.
16 Por karakteristik është që ky rast sepse lidhet me momentin e
17 dhanjes së dëshmisë teme para prokurorit të UÇK-së, e në kokë
18 teme, Sokol Dobrunës.

19 PY. Do t'ju lexoj një pjesë nga dëshmia e Bislím Zyrapi të
20 dhënë më 5 qershor 2013.

21 Z. ELLIS: [Përkthim] Për personat që na ndjekin, është
22 dokumenti SITF00493427 [Sipas përkthimit] deri në SITF00339456
23 [Sipas përkthimit], faqja është 393433.

24 PY. Do t'jua lexoj, domethënë ka të bëjë me Sokol Dobrunën.
25 Bislím Zyrapi thotë:

1 "Më kujtohen disa raste ku ai ka ardhur për të marrë
2 këshillim dhe për të vepruar në veçanti me rastin që
3 përfshinte Blerim Kuqin."

4 Prokurori bën këtë pyetje:

5 "Çfarë ju kujtohet lidhur me këtë rast?"

6 Bislím Zyrapi thotë:

7 "Lidhur me këtë rast ne kemi pasur konsultime me të
8 përpara bombardimeve lidhur me një ushtar të UÇK-së që kishte
9 bërë gabime sipas gjykatës ushtarake. Dhe për të trajtuar të
10 burgosurit pas luftës."

11 A jeni në dijeni që Bislím Zyrapi ka pasur këto lloj
12 komunikimesh apo këto lloj shkëmbimesh me Sokol Dobrunën,
13 Dëshmitar?

14 PË. Nuk jam në dijeni në lidhje me bisedat edhe, domethënë,
15 rreth kësaj çështje që ka zhvillu Bislím Zyrapi me Sokol
16 Dobrunën. Nuk jam në dijeni.

17 PY. Por a përputhet kjo me natyrën e diskutimeve që keni
18 pasur me Bislím Zyrapi?

19 PË. Nuk e mbaj mend, por megjithatë, kemi pas disa raste që
20 kemi komunikuar, edhe po e përmendni, unë kam insistu që ai të
21 ketë kujdesin maksimal dhe të kërkojë që drejtësia të shkojë
22 në vend, dhe mos të vjen me u fajësu as me u dënue një person
23 i cili jep kontribut për diçka për të cilën jep ai kontributin
24 maksimal për atë çështje edhe me u dënu. Nuk ka kuptim,
25 faktikisht, ai ka punu me përforcim të ushtrisë e në anën

1 tjetër i mvishet dezertim. Kjo është me të vërtetë absurde,
2 edhe e dhimbshme.

3 PY. Diskutimet për këtë çështje ishin kryesisht të kufizuara
4 në ato që i kishit thënë Sokol Dobrunës, pra deklaratat që i
5 keni dhënë Sokol Dobrunës, dhe bisedat me Bislim Zyrapin,
6 kështu?

7 PË. Po. Por, mirëpo me Bislim Zyrapin, kemi mujt me bisedue
8 edhe çështje të tjera plus, për shkak se Blerim Kuqin e kemi
9 njoft edhe personalisht. Prandaj bisedat kanë qenë pak a shumë
10 ndoshta me i qujt edhe joformale.

11 PY. Po. E drejtë. Dhe ju e dini që Blerim Kuqi përfundimisht
12 u lirua nga fundi i marsit 1999, apo jo?

13 PË. Me fillimin e bombardimeve Blerim Kuqi lirohet, edhe
14 kthehet në njësi ushtarake. Edhe jep kontributin e vet në
15 Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës.

16 PY. Faleminderit. Tani do ta lëmë këtë temë. Do të doja që të
17 flisnim shkurtimisht për rolin e Bislim Zyrapit.

18 Besoj se në një përgjigje që i dhatë -- ose më ndryshe,
19 ju e konfirmuat që, para një çasti, se sipas jush Bislim
20 Zyrapit ishte shefi i Shtabit të UÇK-së, kështu?

21 PË. Po.

22 PY. Dhe ka pasur raste kur keni shkuar në Divjakë që t'i
23 raportoni Bislim Zyrapit, kështu?

24 PË. Ka pas raste të rralla, por kryesisht jem taku me Bislim
25 Zyrapin.

1 PY. Dhe pas nëntorit të 1998, kishte një ndërtesë në Divjakë
2 që ishte, ku qëndronte drejtorja e operacioneve? Kishte një
3 godinë?

4 PË. Po, ka qenë një godinë, e mbrenda saj ka qenë një dhomë,
5 e cila quhej dhoma e drejtorisë operative.

6 PY. Dua të flas për disa nga personat që keni takuar atje.
7 Besoj se atje keni takuar edhe Sali Veselin, më duket se thatë
8 emrin e tij, apo jo?

9 PË. Po. Dhe kryesisht raportimet tona prej, në nivel
10 brigadash në muajin nëntor i kemi bo me Sali Veselin.

11 PY. Sali Veseli ishte po ashtu një oficer ushtarak me
12 përvojë, apo jo?

13 PË. Po.

14 PY. Naim Maloku, po ashtu e keni parë te drejtorja e
15 operacioneve, apo jo?

16 PË. Gjatë fazës së janarit, po.

17 PY. Naim Maloku ishte një person tjetër që kishte studiuar me
18 ju në Zagreb dhe që kishte përvojë ushtarake, apo jo?

19 PË. Po.

20 PY. Dhe kur flisni për raportimin drejt Shtabit të
21 Përgjithshëm, në fakt ju e keni fjalën për raporte që
22 bëheshin drejt z. Zyrapi, drejt z. Veseli apo -- Sali Veseli,
23 që ta theksojmë, se thashë thjesht z. Veseli, apo i raportoni
24 dikujt tjetër brenda drejtorisë operationale, kështu?

25 PË. Brenda drejtorisë operative, pra çdo herë në vijën

1 ushtarake, ka qenë referimi jonë si komandantët e brigadave.

2 PY. Dje, z. Misetiç ju pyeti se me cilin nga anëtarët e

3 Shtabit të Përgjithshëm ishit në kontakt rreth tetorit 1998.

4 Që të jemi të qartë, asokohe i raportoni ju Jakup Krasniqit?

5 PË. Nuk e di. Në tetor 1998, nëse s'gaboj as Krasniqi nuk ka

6 qenë në territorin e Kosovës. Por unë nuk e kam takue, nuk e

7 di.

8 PY. Në Kosovë ka qenë në atë kohë, por ju mund të thoni që ju

9 në fakt as e keni kontaktuar dhe as e keni takuar në atë

10 periudhë, apo jo?

11 PË. Z. Avokat, falemderës në vërejtje, në rregull. Qëndron

12 faktikisht. Gabimi jem, Jakup Krasniqin në tetor dhe nëntor

13 nuk e kam pa.

14 PY. Dhe nuk i raportoni Jakup Krasniqit se sipas jush linja

15 e raportimit përfundonte tek drejtoria operative, apo jo?

16 PË. Sigurisht.

17 Z. ELLIS: [Përkthim] Të shohim bashkë provën materiale me

18 numër 1331, përndryshe ka numrin U000-6605.

19 PY. E njihni këtë dokument, a është ky një dokument që e keni

20 përgatitur ju personalisht?

21 PË. Po, është dokumenti i jem.

22 PY. Është me shkrim dore se në atë kohë nuk kishit kompjuter,

23 apo jo?

24 PË. Po, nuk kam pas kompjuter.

25 PY. Dhe në thelb kjo është një listë e pozicioneve të forcave

1 serbe, apo jo?

2 PË. Po.

3 PY. Nuk ka as numrin, as numrin e forcave, thjesht përshkruan
4 se ku ndodhen, apo jo, por jo sa persona ishin në këto, sa
5 ushtarë ishin?

6 PË. Kemi pas lëvizjen e tyne, nuk kemi pas informacione të
7 sakta. Prandaj edhe nuk është shkru me shifra, se nuk kam pas
8 informata -- q'atë informacion që e kam pas atë e kam shkru
9 edhe e kam prezantu.

10 PY. Kështu që kur flisni për raportime drejt drejtorisë
11 operative, këto ishin informacionet që raportoni ju, apo jo?
12 Ky lloj informacionesh, kështu?

13 PË. Kemi raportu në lidhje me gjendjen që e kemi në brigadë,
14 numrin e ushtarëve, elemente të tjera sa i përket çështjes
15 edhe kërkesave të nevojat tona që i kemi pas në nivel brigade,
16 por normale edhe një prej specifikave, pra është fjala për
17 pozicionet e forcave serbe në komunën e Suharekës. Pra të
18 gjitha këto problematikat që kanë të bëjnë me brigadën.

19 PY. Të flasim për rolin e Jakup Krasniqit. Nga mesi i
20 qershorit 1998, ju e dinit që ai ishte zëdhënësi i UÇK-së,
21 kështu?

22 PË. Nga mjetet e informimit publik, pra erdhëm në konstatim
23 se ai është zëdhënësi i UÇK-së. Jo përmes ndonjë informacioni
24 që ka qarkullu brenda UÇK-së.

25 PY. Kur ju intervistoi Prokuroria më 2019, ju u thatë se

1 Jakup Krasniqi ka qenë zëvendëskomandant i UÇK-së në periudhën
2 kur u arrestua Blerim Kuqi. Tani pyetja ime është kjo: ju këtë
3 e dinit në atë kohë pra në 1999, apo është diçka që e keni
4 mësuar më vonë?

5 PË. Për funksionin e zëvendëskomandantit, për me qenë shumë
6 korrekt, unë kam mësue derisa kam qenë shef shtabi në zonën
7 operative të Pashtrikut. Me ardhjen ose emërimin, e komandant
8 të Ushtria Çlirimtare e Kosovës Sylejman Selimit, është
9 përmend që zëvendëskomandant është Jakup Krasniqi. Pra, këtë
10 unë e kam mësua gjatë mujit prill të -- jo sa kam qenë shef
11 shtabi, por sa kam qenë në kuadër të drejtorisë operative të
12 Shtabi i Përgjithshëm në sektorin e shkollimit e stërvitjes,
13 pra në prill të 1999.

14 PY. Pra, në janar të 1999, dhe gjatë gjithë kohës që keni
15 qenë shef shtabi në zonën e Pashtrikut, ju nuk e keni ditur që
16 Jakup Krasniqi të ketë qenë zëvendëskomandant në UÇK, kështu?

17 PË. Po, nuk e kam dit. Për çështjen që ka qenë
18 zëvendëskomandant, çka e përmenda, e di në fund të prillit atë
19 më ka tregue Bislim -- ky, Ekrem Rexha, Drini. Deri atëherë
20 nuk e kam dit.

21 PY. Ju e dini që Jakup Krasniqi ka qenë pjesë e delegacionit
22 që shkoi në Rambuje, për negociatat në shkurt të 1999, kështu?

23 PË. Po.

24 PY. Dhe më pas, ka pasur një raund të dytë negociatash në
25 Paris, apo jo?

1 PË. Nuk i di detajet, nuk më kujtohen, por realisht e di që
2 ka qenë përfaqësuesi i jonë në bisedime në Rambuje dhe takime
3 të tjera.

4 PY. Jakup Krasniqi nuk u kthye në Kosovë pas negociatave të
5 Parisit, pra nuk ka qenë në Kosovë në prill dhe në maj të
6 1999, apo jo?

7 PË. Unë nuk e kam taku. Se para bana një gabim që thashë nuk
8 ka qenë, e ju ma konfirmut që ka qenë, e unë tash nuk po e bëj
9 të njëjtin gabim, pra nuk e kam taku.

10 PY. Që të jemi të qartë, ju nuk e keni parë në prill, në maj
11 të 1999 në Kosovë?

12 PË. Jo. Pas shkuarjes në Rambuje, domethënë prej muajit, kur
13 i bien, shkurt, unë nuk e di që jam taku ma me Krasniqin.

14 Z. ELLIS: [Përkthim] Atëherë, shohim në ekran një pjesë
15 të intervistës suaj me Prokurorinë që mban numrin P1372.9
16 [Sipas përkthimit]. Në anglisht është faqja 26, rreshti 9, në
17 shqip është faqja 34, dhe fillon në rreshtin 3.

18 PY. T'jua lexoj këtë paragraf, keni thënë:

19 "... në shkurt të 1999, filluan bisedimet në Rambuje.
20 Komandantët e zonave dhe anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm
21 mbajnë një takim në fshatin Likovc, Skenderaj komuna, dhe
22 vendosin që komandant i UÇK-së të jetë Sylejman Selimi.
23 Prandaj edhe ky thotë komandanti i parë. Pra pranon që
24 ndërkohë që ka ndryshu struktura.

25 "PY. Po".

1 Dhe ke shtuar:

2 "Po, ka ndodh në 7 shkurt.

3 "PY. Faleminderit.

4 "PË. Realisht, tash po e shtoj në këtë takim është
5 verifiku funksioni i zëvendëskomandantit për Jakup Krasniqin,
6 është kërkuar një zëvendës i dytë dhe është dhënë emri i Sokol
7 Bashotës, por nuk u aprovua. Kështu që takimi përfundoi."

8 Dëshmitar, a ju kujtohet t'ia keni dhënë këtë përgjigje
9 Prokurorisë në 2019?

10 PË. Po, më kujtohet. Informacionin që e kam dhënë e kam marrë
11 nga Ekrem Rexha, komandant Drini. Ai ka qenë prezent në këtë
12 takim dhe më ka spjeguar saktë rrjedhën që ka ndodhur gjatë
13 muajit prill, prapë e përmendi, të vitit 1999, kur unë me
14 Ekrem Rexhën kemi pas mundësi me komuniku për shumë çështje se
15 kemi pas kohë të mjaftueshme që, se kemi qëndruar bashkë në
16 Jezercë, dhe në fshatin Devetak, të komunës, njëna është e
17 Shtimes, tjetra e Ferizajit.

18 PY. Kuptoj. Ju thoni ky takim është mbajtur më 7 shkurt, por
19 ama ju mësuat për këtë takim në prill prej Drinit, Ekrem
20 Rexhës, kur ishit në Jezercë, kështu?

21 PË. Saktë.

22 PY. Jakup Krasniqi nuk mund të ketë qenë në takimin e 7
23 shkurtit të 1999 sepse ai në të njëjtën kohë ishte në Rambuje.

24 PË. Pikërisht, pikërisht.

25 Z. ELLIS: [Përkthim] Shohim në ekran provën materiale

1 P182, fillon në faqen SPOE00226397.

2 PY. Që të jemi të sigurt, ju nuk keni qenë në takimin e 7
3 shkurtit 1999 sepse ky ka qenë një takim me komandantët e
4 zonave, apo jo?

5 PË. Komandantët e zonave dhe stafin e Shtabit të
6 Përgjithshëm.

7 PY. Kështu, por ju vetë nuk keni qenë në takim.

8 PË. Unë në takim nuk kam qenë, por kam qenë shumë afër vendit
9 ku është mbajtur takimi. Kam qenë me një detyrë tjetër në
10 përgatitjen e një grupi ushtarësh për përdorim të raketës
11 kundërajrore Shigjeta 2.

12 PY. Kjo që po shohim në ekran janë disa shënime që mbajnë
13 datën 6 shkurt 1999, dhe shohim emrat Ramush Haradinaj,
14 Rrustem Mustafa, Ekrem Rexha, Sylejman Selimi, dhe më poshtë
15 shohim dy përfaqësues të Shtabit të Përgjithshëm.

16 Ky, mund të jenë këto shënime të takimit për të cilin po
17 flisni dhe ju? Sepse janë dhe komandantët e zonave dhe këtu
18 edhe përfaqësuesit e Shtabit të Përgjithshëm, dhe ju thotë që
19 atje ka qenë edhe Ekrem Rexha.

20 Z. HALLING: [Përkthim] Kundërshtoj, dëshmitari nuk është
21 personi i duhur për t'iu përgjigjur kësaj pyetjeje.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet
23 kundërshtimi, nëse e dini mund t'iu përgjigjeni.

24 DËSHMITARI: Pikërisht bëhet fjalë për të njëjtin takim.
25 Nuk e di mu pse m'u ka fiksuar në krye 7 shkurt, por unë po e

1 përmendi, është dita kur delegacioni jonë fillon bisedimet në
2 Rambuje. Pra, edhe para se e përmenda, ai që shkrun ma mirë,
3 edhe ky dokument, besoj që është i saktë.

4 Z. ELLIS: [Përkthim]

5 PY. A pajtohem që gjatë këtij takimi, komandantët e zonave
6 vendosën të emërojnë si komandant të përgjithshëm Sylejman
7 Selimin, kështu ka ndodhur, apo jo?

8 PË. Detajet rreth takimit nuk kisha dashtë t'i diskutoj,
9 megjithatë është mirë ndoshta të komunikoni, të kërkonit prej
10 pjesës tjetër që janë pjesëmarrës në këtë takim.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ndaloni një
12 çast. Sepse nuk po marrim përkthimin. Kam probleme me kufjen,
13 s'po marr përkthimin.

14 Vazhdoni tani.

15 Po, tani po.

16 DËSHMITARI: Pra, për specifikat si ka rrjedh takimi dhe
17 çka është bisedu, unë nuk muj me tregue se, megjithatë që
18 themi nga aspekti e kam me të ndime, prandaj nuk dua të
19 lëshohena në këtë diskutim.

20 Z. ELLIS: [Përkthim]

21 PY. A keni dëgjuar ju që komandantët e zonave të kenë pyetur
22 apo të kenë pasur pikëpyetje nëse Jakup Krasniqi ishte personi
23 i duhur për t'u emëruar si zëvendëskomandant në atë takim?

24 PË. Jo, unë veç jam informum për çështjen e zgjedhjes së
25 Sylejman Selimit si komandant dhe se kur është propozue

1 zëvendëskomandanti, është thanë që kemi zëvendëskomandant,
2 edhe u përmend emri i Jakup Krasniqit. Edhe atëherë është
3 kërkue edhe një zëvendës i dytë, por del propozimi për Sokol
4 Bashotën, që emri i tij nuk e shoh këtu, por më duket se ka
5 qenë prezent dhe ai. Nuk jam i sigurt fort. Por megjithatë,
6 është përmend emri i tij edhe nuk ka kalu respektivisht është
7 prish mbledhja. Q'kaq di.

8 Këto janë fjalë të Ekrem Rexhës edhe ma tepër çka do që
9 flas veç muj me bo huti, kështu që kisha kërkue të më kurseni
10 prej kësaj problematike.

11 PY. Unë po ju them se kam pasur dy zëvendëskomandantë. Një ka
12 qenë për operacionet dhe një ka qenë për mbështetjen. E keni
13 ditur ju këtë gjë?

14 PË. Jo.

15 PY. A e keni ditur që Jakup Krasniqi është emëruar
16 zëvendëskomandant për mbështetje në një takim që është mbajtur
17 më 12 dhe 13 nëntor të 1998?

18 PË. Jo, jo. S'jam kurrfarë në rrjedhat e kësaj, këtyne
19 informacioneve. Nuk i di.

20 PY. Në fakt, diskutimi në takimin e shkurtit të 1999 ka qenë
21 në fakt për ta hequr Jakup Krasniqin dhe Sokol Bashotën si
22 zëvendëskomandant dhe jo për t'i emëruar ata.

23 PË. Nuk i di detajet. Unë ato që e dita e thashë.

24 PY. Dhe pas takimeve të shkurtit 1999, ju nuk jeni parë me z.
25 Krasniqi deri në përfundim të luftës, kështu?

Dëshmitari: Kurtesh Fondaj (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Ellis

Faqe 91

1 PË. Nuk mbaj mend që të jem taku me z. Krasniqi edhe pas
2 luftës, se jo ma gjatë luftës.

3 Z. ELLIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, ky është
4 momenti më i përshtatshëm për ta mbyllur. Kam, mendoj, edhe
5 nevojë për 15 minuta, ose diçka më shumë.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
7 Dëshmitar, tani të bëjmë pushimin e drekës. Faleminderit.
8 Mund të dilni nga salla e gjyqit. Ju urojmë drekë të këndshme,
9 dhe do të kthehemi në orën 14.30.

10 DËSHMITARI: Falemnars.

11 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar]

13 --- Pauza e drekës fillon në orën 13.00

14 --- Seanca rifillon në orën 14.30

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

16 Asistente, mund ta sillni dëshmitarin në sallë.

17 [Dëshmitari vijon dëshminë]

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirë se
19 erdhët, z. Fondaj. Do të vazhdojmë më tej me pyetjet e z.
20 Ellis. Ju lutem, dëgjojeni me vëmendje z. Ellis.

21 Z. ELLIS: [Përkthim]

22 PY. Mirëdita, Dëshmitar.

23 PË. Mirëdita.

24 PY. Nuk kam më shumë se dhjetë minuta, mendoj, kështu që do
25 ju kërkoja që të më dëgjonit, domethënë, nuk është se kam

1 shumë kohë për t'ju bërë pyetje.

2 Së pari dua t'ju bëj një pyetje lidhur me një rast që
3 përfshinte Abdyl Ramën. Mendoj se keni thënë në seancën
4 përgatitore me Prokurorinë një javë më përpara që nuk keni
5 folur me Abdyl Ramën lidhur me atë çfarë i ka ndodhur atij,
6 dhe gjithçka që di ti për rastin e Abdyl Ramës ti e di nga ajo
7 çka të ka thënë nipi i Abdyl Ramës, a është e vërtetë kjo,
8 Dëshmitar?

9 PË. Po, është shumë e saktë.

10 PY. Në 2019, kur keni fol me Prokurorinë, i ke thënë
11 Prokurorisë që nipi i tij, Destan Berisha ende jetonte në
12 Suharekë. A është e vërtetë kjo, Dëshmitar?

13 PË. Po.

14 PY. Por, ju nuk e dini në qoftë se Prokuroria ka folur apo jo
15 me Destan Berishën, a është e saktë kjo?

16 PË. Nuk e di.

17 PY. Të kalojmë te një tjetër temë.

18 Z. ELLIS: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretares të paraqiste
19 në ekran provën materiale P00621 [Sipas përkthimit].

20 PY. Këtë dokument ta ka treguar më herët Prokuroria në
21 seancën përgatitore përpara një jave. Dhe përgjigjja që i keni
22 dhënë Prokurorinë është që nuk e keni parë asnjëherë më
23 përpara se sa t'ju tregohej këtë dokument. A është e vërtetë
24 kjo, Dëshmitar?

25 PË. E vërtetë.

1 PY. Dua t'ju tregoj dhe një tjetër dokument nga seanca
2 përgatitore përpara një jave.

3 Z. ELLIS: [Përkthim] Është dokumenti U000-5139.

4 PY. Ky është një dokument tjetër që ju nuk e keni parë
5 përpara se t'jua tregonte Prokuroria përpara një jave, apo jo
6 jo, Dëshmitar?

7 PË. Saktë.

8 PY. Dhe keni thënë që kjo listë reflekton ato dokumente që
9 duhet të kenë qenë në brigadë, por pjesa më e madhe e
10 brigadave nuk kanë pasur këto lloj dokumentesh. A është e
11 vërtetë kjo, Dëshmitar?

12 PË. Po.

13 PY. Keni thënë gjithashtu që nga kjo lista ju keni pasur
14 shumë pak dokumente kur keni qenë komandant i Brigadës 123, a
15 është e saktë kjo, Dëshmitar?

16 PË. Edhe kjo është e saktë.

17 PY. Edhe pse është bërë punë për përgatitjen e këtyre
18 dokumenteve, ju nuk e dini se deri në çfarë mase janë
19 realizuar ose në qoftë se janë hartuar këto dokumente, apo jo,
20 Dëshmitar?

21 PË. Ne kemi punu shumë në dokumente, por jo komplet këto nuk
22 muj me i mbërri, derisa unë kam qenë në zonën operative të
23 Pashtrikut.

24 PY. Ndonjëherë, dokumente të tilla pasqyrojnë atë çfarë do
25 kishte dashur ju të kishit, dhe jo domosdoshmërisht atë çfarë

Dëshmitari: Kurtesh Fondaj (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje vijuese nga z. Halling

Faqe 94

1 keni pas realisht nëpër duar, apo jo, Dëshmitar?

2 PË. Po.

3 PY. Faleminderit. Më lejoni vetëm një çast.

4 [Përfaqësuesit e Mbrojtjes këshillohen]

5 Z. ELLIS: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

6 Nuk kam pyetje të tjera.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,

8 z. Smith [Sipas përkthimit].

9 Prokurori, keni pyetje plotësuese?

10 Z. HALLING: [Përkthim] Kam një pyetje të shkurtër. Për sa
11 i takon dokumentit që kemi këtu përpara në ekran, duam që të
12 kërkojmë pranimin e tij në provë materiale. Nuk e di në qoftë
13 se kolegët e Mbrojtjes kanë kundërshtim në lidhje me këtë
14 kërkesë të Prokurorisë.

15 Z. ELLIS: [Përkthim] Dëshmitari nuk e ka parë këtë
16 dokument më përpara, dhe nuk mund të dëshmojë lidhur me
17 vërtetësinë e këtij dokumenti, kështu që nuk e di se çfarë
18 vlere mund të ketë.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
20 vazhdoni me pyetjet plotësuese.

21 Z. HALLING: [Përkthim] Kam vetëm një temë, dhe besoj që
22 ndërhyrja do jetë e shkurtër.

23 Pyetje vijuese nga z. Halling:

24 Z. HALLING: [Përkthim]

25 PY. Dëshmitar, kam pyetje për t'ju bërë lidhur me një temë.

1 Z. HALLING: [Përkthim] Do i kërkoja së pari Sekretares së
2 seancës që të paraqesë në ekran provën materiale P1327.8 në
3 faqen 21 në anglishte në faqen 26 në shqip.

4 PY. Ndërkohë që paraqiten këto faqen, Dëshmitar, dua t'ju
5 pyes, a ju kujtohet më herë gjatë ditës sot që keni thënë që
6 kur shkuat në Negroc më 10 qershor 1998, jeni vendosur në
7 kontakt me Numrin 10, me Dhjetëshin, që më pas e mësuat që
8 ishte Sokol Bashota. A ju kujtohet ta keni thënë këtë sot më
9 herët, Dëshmitar?

10 PË. Po, po. Më duket që e kam thanë.

11 Z. HALLING: [Përkthim] Për procesverbal kjo është thënë
12 në faqet 23 dhe 24 në transkriptin në kohë reale. Është
13 përmendur përsëri në faqen 61 të transkriptit në kohë reale.

14 PY. Dëshmitar, tani dua t'ju tregoj pjesë të dëshmisë suaj.
15 Dëshminë e keni përpara në ekran. Në intervistën që i keni
16 dhënë ZPS-së në fakt keni thënë që e kuptoni, e keni kuptuar
17 që Sokol Bashota, njihej si Dhjetëshi. Kjo jepet në provën
18 materiale P1327.1, në faqen 16 në anglisht. Por më vonë në
19 intervistë thoni si më poshtë.

20 "PY. Si e ka pasur pseudonimin Rexhep Selimi?

21 "PË. 7. Por nuk e di, nuk jam shumë i sigurt për
22 pseudonimi e vet."

23 Dhe pastaj thuhet:

24 "A e është e saktë, thoni që është tetor -- vazhdoni
25 shkoni."

1 "A është 7 apo 10, sepse ka pasur një emër tjetër Sokol
2 Bashota dhe nuk e di kush ka qenë kush. Njëri ka qenë 7 dhe
3 tjetri ka qenë 10. Por nuk jam i sigurt se kush ka qenë kush."

4 Dëshmitar, a je i sigurt që Sokol Bashota njihej me
5 nofkën Dhjetëshi kur e ke takuar atë në Negrovc në qershor të
6 1998?

7 PË. Në fazën kur e kam dhanë këtë në 2019, realisht ka pas aq
8 shumë ngarkesë, edhe normale që kam qenë pak konfuz për
9 momentin për sa i përket këtyne numrave. Mirëpo ndërkohë tash
10 edhe sa kemi bisedue javën e kalume, edhe këtë javë, e flas
11 me, domethënë, dhe e kam të kjartë se Dhjetëshi është Sokol
12 Bashota.

13 PY. Është interesante kjo. Atëherë, le të kalojmë tek ajo çka
14 keni thënë para një jave. Është prova materiale P1328, në
15 faqen 28. Kjo është e regjistruar nga seanca përgatitore me
16 ju.

17 "Sokol Bashota përmendet vetëm me emër kur jeni takuar me
18 të në Negroc, por ti nuk i mban mend mirë numrat dhe nuk të
19 kujtohet se me çfarë numri i drejtoheshin atij..."

20 A është e saktë kjo, Dëshmitar?

21 PË. Në fazën realisht që ne kemi bisedue, nuk m'u ka kujtu,
22 por tash më kujtohet se ka qenë Dhjetëshi në pyetje, Sokol
23 Bashota, e ka pas numrin 10.

24 PY. Pra, me sa e kuptoj unë, ky është informacion që nuk e
25 keni ditur në kohën kur i keni dhënë intervistë ZPS-së në

1 vitin 2019, a është e drejtë kjo të thuhet, Dëshmitar?

2 PË. Kam qenë konfuz, konfuz, realisht, m'u kanë ngatërrue
3 konceptet. Por megjithatë, e jam tash, jam i bindun që ka qenë
4 pyetje me Numrin 10, është Sokol Bashota.

5 PY. Dëshmitar, më 21 qershor, domethënë të premtën e shkuar,
6 juve ju është lexuar mbrapsht shënimi përgatitor. A është e
7 vërtetë kjo, Dëshmitar?

8 PË. Po.

9 PY. Pra, paqartësia lidhur me këtë numër ka qenë e pranishme
10 deri të premtën e shkuar, kështu i takon?

11 PË. Po mundet me qenë edhe me thanë edhe ndoshta edhe të
12 premtën, por të shtunën, të dielën, ndërkohë e kam kthj
13 kujtesën edhe flas me përgjegjësi se kemi të bëjmë me Numrin
14 10, Sokol Bashota. Mbaron q'është, muj gati me e përcaktue me
15 shumë bindje.

16 PY. Në qoftë se jeni aq i bindur sa ç'jeni tani, po Rexhep
17 Selimi çfarë nofke ka pas, çfarë numri ka pas?

18 PË. Tash deli që është Numri 7, por shumë i sigurt nuk jam.

19 PY. Pra, i takon që z. Selimi ka qenë Shtatëshi, por ku e
20 mbështesni ju këtë?

21 PË. Nuk e di, por realisht e di që me, janë disa prej
22 anëtarëve të Shtabit të Përgjithshëm janë identifiku me numra.
23 Nuk muj me u bazu në diçka konkrete, por bindja jeme është që
24 ai e ka pas numrin 7.

25 PY. Dëshmitar, me ç'kuptoj, ju thatë në përgjigje të pyetjes

1 time, që ju nuk e dini megjithatë, jeni i bindur që ai ka qenë
2 Numri 7, a thatë këtë, është e vërtetë kjo, Dëshmitar?

3 PË. Kështu e thashë realisht, këto koncepte gradualisht u
4 kujtu, këto janë shënime ndoshta ose informacion që m'u ka
5 këndell domethënë në kokën teme këto në këtë fazën sa jemi
6 këtu në Gjykatë.

7 PY. Dëshmitar, ju sapo thatë që nuk e dini. Me "po" ose "jo",
8 a mund të na thoni se çfarë numri ka përdorur Rexhep Selimi
9 gjatë luftës? "Po" ose "jo", e dini apo jo?

10 PË. Nuk më kujtohet mu saktë, por jam, tash praktikisht po më
11 duket diçka, po më sillet sikur numri 7, por megjithatë nuk
12 jam i sigurt.

13 PY. Dëshmitar, me përgjigje "po" ose "jo", ju lutem na thoni
14 a e dini se çfarë numri ka përdorur Sokol Bashota gjatë
15 luftës?

16 PË. Sokol Bashota është identifikuar me numrin Dhjetëshi.

17 PY. Dëshmitar, unë parashtroj që nuk ka fare asnjë shpjegim
18 se pse nga e premtja deri sot ju jeni kaq shumë i sigurt për
19 këtë fakt. Çfarë kundërpërgjigje keni për këtë që sapo
20 parashtrova unë?

21 Z. MISETIC: [Përkthim] Kërkojmë kundërshtimin e pyetjes.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem,
23 përgjigjuni pyetjes.

24 Z. HALLING: [Përkthim]

25 PY. Dëshmitar, ta përsëri dhe një herë pyetjen, apo e keni të

1 qartë?

2 PË. Jo, e kjartë, por megjithatë unë kam pas kohë mjaftueshëm
3 me mendu këtë problematikë. Edhe prej si jam këtu, domethënë,
4 sot është dita e tetë, unë tjetër punë nuk jam tu bo veç tu ju
5 kujtue rreth problematikës që ka ndodh në fazën e luftës, edhe
6 si rezultat i kësaj më ka ardh edhe pak kënellë memoria jeme.

7 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, dëshmitari u
8 përgjigj me përgjigjen e vet. Nuk kemi pyetje të tjera.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.
10 Gjykatësi Barthe keni ndonjë pyetje?

11 GJYKATËSI BARTHE: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Po,
12 faleminderit Gjykatësi Smith. Fatkeqësisht unë nuk e shikoj
13 dot dëshmitarin tani, mbase mund të ndryshojë kjo situatë. Po,
14 tani e shoh.

15 Pyetje nga Trupi Gjykses:

16 GJYKATËSI BARTHE: [Përmes videolidhjes] [Përkthim]
17 Mirëdita, z. Fondaj, shpresoj që të më dëgjoni mirë. Më
18 dëgjoni mirë, z. Fondaj?

19 PË. Po, jam tu dëgju, por nuk e shoh kush është duke fol.

20 GJYKATËSI BARTHE: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Unë po
21 e ndjek seancën përmes videolidhjes, përmes Zoom-it. Besoj
22 mund të të ndihmojë Sekretari për të më parë. Mirëdita, z.
23 Fondaj dhe një herë.

24 Z. Fondaj, Trupi Gjykses ka dhe disa pyetje të tjera për
25 ju, që janë pyetje që na ndihmojnë neve për ta kuptuar më mirë

1 dëshminë tuaj. Pyetja ime e parë ka të bëjë me takimin tuaj
2 personal me z. Thaçi.

3 Nëse nuk jam gabim, i keni thënë z. Misetiç nga Mbrojtja
4 e z. Thaçi dje se jeni takuar me z. Thaçi dy ose tri herë në
5 vitin 1998, dhe për ata që na ndjekin, e kam fjalën për faqen
6 1706, të transkriptit të përkohshëm, në rreshtin 22.

7 A ju kujtohet t'ia keni thënë këtë Avokatit Misetiç dje,
8 Dëshmitar?

9 PË. Po, [E pakuptueshme].

10 GJYKATËSI BARTHE: [Përmes videolidhjes] [Përkthim]
11 Gjithashtu, ju thatë që në këto dy apo tre takime, të gjitha
12 këto takimet, pra, kanë ndodhur në tetor dhe nëntor të 1998. A
13 është e saktë kjo, Dëshmitar?

14 PË. E saktë.

15 GJYKATËSI BARTHE: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] A mund
16 të na thoni dhe një herë se ku ka ndodhur mbledhja ose takimi
17 i parë, është në fshatin Marali siç keni thënë dje në faqen
18 17062, rreshtin 10, të transkriptit të përkohshëm?

19 PË. Po.

20 GJYKATËSI BARTHE: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Atje
21 jeni takuar me z. Thaçi në oborrin e një shtëpie private, apo
22 jo, Dëshmitar?

23 PË. Në Marali është takimi i dytë, apo i tretë. I pari është
24 në Fshat të Ri.

25 GJYKATËSI BARTHE: [Përmes videolidhjes] [Përkthim]

1 Faleminderit. Do kaloj dhe te ky takim më pas.

2 Thatë gjithashtu që përveç z. Thaçi dhe përveç teje, në
3 takimin që bëtë në Marali ka qenë i pranishëm vetëm z. Fatmir
4 Limaj, a i saktë ky informacion, Dëshmitar?

5 PË. Po.

6 GJYKATËSI BARTHE: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Z.
7 Fondaj, na keni thënë më herët sot paradite se jeni takuar me
8 z. Thaçi së bashku me Rexhep Selimin në shtator të vitit 1998.
9 A është e saktë kjo, Dëshmitar?

10 PË. Po, e saktë është.

11 GJYKATËSI BARTHE: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Sa
12 herë jeni takuar me z. Thaçi në shtator të 1998, në qoftë se
13 ju kujtohet?

14 PË. Dy herë.

15 GJYKATËSI BARTHE: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Kur
16 jeni takuar me z. Thaçi dhe me z. Rexhep Selimi për herë të
17 parë, nga e dinit ju që personat që kishit përballë ishin në
18 fakt z. Selimi dhe z. Thaçi?

19 PË. Takimi me ta ka qenë në fshatin Dobërdolan dhe ata kanë
20 qenë të shoqërumë dhe me Bislím Zyrápin, edhe disa të tjerë
21 anëtarë të komandës së Brigadës 123. Kështu që informacionin e
22 kam marrë edhe prej tyre. Në mesin e tyre ka qenë edhe
23 komandanti i Brigadës 122, në atë kohë Agim Kuqi. Kështu që
24 Agim Kuqi më ka njoftu me Rexhep Selimin. Dhe Rexhep Selimin
25 nuk e kam njoft, pra për herë të parë jemi përshëndet dhe jemi

1 njoftu në fshatin Dobërdolan, dikund kah data 10 shtator.

2 Ndërsa Hashim Thaçin e kam njoft edhe paraprakisht.

3 GJYKATËSI BARTHE: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Si e
4 njifnit, nga e njihnit z. Thaçi? E keni takuar personalisht?
5 PË. Jemi taku në situata lufte dhe përpara, por në rrethana
6 të cilat ma herët jam taku, nuk më kujtohen.

7 GJYKATËSI BARTHE: [Përmes videolidhjes] [Përkthim]
8 Faleminderit. Kur jeni takuar me z. Selimi për herë të parë, a
9 e dinit ju se çfarë posti kishte z. Selimi brenda UÇK-së?
10 Besoj se e keni thënë më herët sot, edhe kjo jepet në faqen 29
11 të transkriptit në kohë reale, që ju nuk e njihnit atë në atë
12 kohë, pra, nuk e njihnit se çfarë pozicioni kishte në atë
13 kohë, dhe as nuk e dini, në veçanti, domethënë, nuk e keni
14 ditur se çfarë detyrash dhe çfarë përgjegjësish ka pasur ai. A
15 është e saktë kjo, Dëshmitar?

16 PË. Po, e saktë është.

17 GJYKATËSI BARTHE: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] A
18 është po ashtu e saktë që ju tani nuk e dini që z. Rexhep
19 Selimi ka qenë ose pretendohet të ketë qenë, inspektor i
20 përgjithshëm për periudhën, të paktën, nga korriku i 1998 e në
21 vijim? Domethënë, nuk e dini fare këtë gjë, nuk keni fare
22 dijeni lidhur me këtë?

23 PË. Nuk më kujtohen detaje, ndoshta e kam dit por kam harru.

24 GJYKATËSI BARTHE: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Thatë
25 që ndoshta e ke dit por, a mund të ketë ngjarë që ta kesh dit

1 dhe e keni harruar që ai ka qenë inspektori i përgjithshëm i
2 UÇK-së prej verës, ose për të qenë më të qartë, ose më
3 precizë, të paktën nga korriku i 1998 e në vijim? Domethënë a
4 është e mundur që ta kesh pas dit këtë më përpara, por që ta
5 kesh harruar?

6 PË. Faktin që ju e përmendët, unë kurrë s'e kisha dit, por
7 tash derisa ju e thatë mu diçka prapë po më thotë që ka mujt
8 me qenë diçka ndonjë pjesë e informacionit që e kam dit, por
9 unë e kam harru këtë informacion.

10 GJYKATËSI BARTHE: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Z.
11 Fondaj, për të qenë të qartë lidhur me këtë pikë, unë nuk po
12 them që z. Selimi në fakt ka qenë inspektor i përgjithshëm,
13 por thashë që pretendohet që ai ka qenë inspektor i
14 përgjithshëm, nuk thashë që ka qenë inspektor i përgjithshëm
15 me siguri. Pra pretendohet që ai të jetë bërë inspektor i
16 përgjithshëm i korrikut të 1998, sa për sqarim ishte kjo.

17 Pyetja tjetër, z. Fondaj, është si më poshtë. A e dini
18 ju, z. Fondaj, se si kanë ardhur z. Thaçi dhe z. Selimi në
19 takimin që ke pasur ti me ta? Kanë ardhur me kerr, kanë ardhur
20 në këmbë, si kanë ardhur?

21 PË. Nuk jam i informuar në lidhje me detajet, por e di që ata
22 janë ardh nga një rajon i Brigadës 124. Edhe aty te ne në
23 Dobërdolan ka qëndru Bislir Zyrapi, ndërsa Rexhep Selimi
24 bashkë me Hashim Thaçin në përcjelljen e disa ushtarëve tanë,
25 kanë shkue në drejtim të zonës operative të Drenicës.

1 GJYKATËSI BARTHE: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Kjo
2 ishte pyetja ime e radhës, në fakt. Përveç z. Bislir Zyrapi,
3 dhe ushtarët e Brigadës 123, këta dy persona, domethënë z.
4 Selimi dhe z. Thaçi, a ishin të shoqëruar ose a ishin të
5 përcjellë nga anëtarë të tjerë ose ushtarë të tjerë të UÇK-së
6 kur je takuar ti me ta?

7 PË. Kur unë jam taku me ta, nuk mbaj mend që ka qenë dikush
8 në shoqërinë e tyre, por prej atij momenti i kanë shoqëru
9 ushtarët tanë ata.

10 GJYKATËSI BARTHE: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Ata
11 nuk është se kanë ardh me ushtarët e vet, domethënë, për
12 shembull?

13 PË. Me sa mbaj mend unë, nuk kanë pas në përcjellje ushtarë
14 përcjellës.

15 GJYKATËSI BARTHE: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] E
16 kuptoj. Faleminderit.

17 Pyetja e radhës është kjo: A ju kujtohet se çfarë kishte
18 veshur z. Thaçi gjatë takimeve, a ishte i veshur me uniform
19 apo jo? Në qoftë se ishte i veshur me uniformë, a mund të na e
20 përshkruani uniformën që kishte veshur, apo ka pas veshur
21 uniformë, rroba civile, tesha civile dhe jo uniformë
22 ushtarake?

23 PË. Po mundohem me këndëllë në mendjen time, por nuk po më
24 kujtohen detaje.

25 GJYKATËSI BARTHE: [Përmes videolidhjes] [Përkthim]

1 Faleminderit. A ju kujtohet në qoftë se z. Thaçi kishte armë
2 me vete? A kishte një armë me vete?

3 PË. Kam bindjen që i armatosun ka qenë.

4 GJYKATËSI BARTHE: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] A ju
5 kujtohet se çfarë lloj arme ka pas ai?

6 PË. Nuk jam i sigurt, por mundet me qenë një pushkë
7 automatike, që njihet me termin kallashnikov.

8 GJYKATËSI BARTHE: [Përmes videolidhjes] [Përkthim]
9 Faleminderit. Po z. Selimi, a kishte vesh uniformë? Kjo është
10 pyetja e parë, dhe pyetja tjetër, a kishte armë? Në qoftë se
11 ju kujtohet.

12 PË. Nuk më kujtohet, se takimi me ta që e kam realizu me
13 Rexhep Selimin ka qenë në oborr të objektit edhe ai në atë
14 moment derisa ne jemi kontakt, nuk e ka pas armën me vete.
15 Kështu që nuk e di për sa i përket armatimit çfarë e ka pas
16 edhe a ka pas.

17 GJYKATËSI BARTHE: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Po
18 lidhur me uniformën? z. Selimi a kishte vesh uniformë?

19 PË. Më duket që ka qenë i uniformum, por nuk jam i sigurt.

20 GJYKATËSI BARTHE: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Po z.
21 Zyrapi, po ai a kishte veshur uniformë?

22 PË. Po, Bislime Zyrapi mbaj mend se rregullisht ka qenë me
23 uniformë.

24 GJYKATËSI BARTHE: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] T'i
25 kthehem dhe një herë takimit që keni pasur me z. Thaçi dhe z.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Kurtesh Fondaj (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga Trupi Gjykses

Faqe 106

1 Limaj në Marali në tetor të 1998. A mund të na thoni dhe një
2 herë shkurtimisht se si u organizua takimi dhe çfarë ndodhi
3 aty? Ky ishte i njëjti takim ku ti more postin e komandantit
4 të Brigadës 123, apo ishte takim tjetër ai? Mund të na
5 shpjegoni pak se çfarë ndodhi në atë takim, Dëshmitar?
6 PË. Marrja e postit është në takim paraprak në Fshat të Ri.
7 Ky është takim pas atij momenti ku Hashim Thaçi më ka kërku
8 mue për çështje konsultimi dhe koordinimi të veprimeve tona me
9 njësi të tjera të brigadave të tjera që kanë vepru në atë
10 rajon. Kam pas një ftesë, por realisht takimit i jam përgjigj
11 pak me vonesë. Edhe në momentin kur jemi taku në oborr të asaj
12 shtëpie, kam pas një lloj vërejtjeje pse jam vonu. Por ka qenë
13 situatë lufte, realisht unë s'kam mujt me u përgjigj takimit
14 në orën e saktë, por jam, iu kam përgjigj me goxha vonesë. Por
15 pavarësisht aty kemi komunikue në këmbë në oborr të asaj
16 shtëpie që e përmenda.

17 GJYKATËSI BARTHE: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Pra,
18 që të jemi shumë të qartë lidhur me këtë pikë, mbledhja ku
19 keni marrë urdhrin e përgjithshëm për të sulmuar pozicionet
20 serbe nga z. Thaçi, siç thatë dje, ka qenë një takim tjetër
21 dhe ky takim ka ndodhur më vonë se sa takimi ku jeni emëruar
22 komandant i Brigadës 123, kështu ka ndodhur, Dëshmitar?

23 PË. Po, po e përmendi. Kjo ka ndodh në fshatin Marali gjatë
24 fazës së muajit tetor. Saktë data nuk po më kujtohet, por
25 është çdo herë mbasi që më është komunikue detyra e komandantit

1 të brigadës.

2 GJYKATËSI BARTHE: [Përmes videolidhjes] [Përkthim]

3 Faleminderit. A e dinit ju në atë kohë në takimin e dytë me z.

4 Limaj dhe z. Thaçi, e dinit ju se çfarë roli e çfarë pozite

5 kishte z. Limaj në UÇK në atë kohë, në qoftë se kishte ndonjë

6 pozitë?

7 PË. Në atë kohë Fatmir Limaj ka qenë komandant i Brigadës

8 121. Atë shumë saktë e di.

9 GJYKATËSI BARTHE: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] A e

10 dini nëse më vonë z. Limaj u bë anëtar i Shtabit të

11 Përgjithshëm të UÇK-së?

12 PË. Po, më vonë ka ndodh kalimi i tij në, si drejtor i

13 Drejtorisë së Policisë Ushtarake ndërsa vendin e tij e ka

14 marrë Haxhi Shala.

15 GJYKATËSI BARTHE: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] A e

16 dini kur e zëvendësuan z. Limaj dhe kur u bë anëtar i Shtabit

17 të Përgjithshëm të UÇK-së, apo shefi i policisë ushtarake?

18 PË. Nuk më kujtohen datat e detajet, por sipas perceptimit

19 tim kjo ka ndodh në fazën e muajit nëntor të 1998.

20 GJYKATËSI BARTHE: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Z.

21 Fondaj, kur e bëtë këtë kërkesë, për Drejtorinë e Policisë

22 Ushtarake, dhe e kam fjalën për provën materiale P1332, më 10

23 nëntor të 1998, e dinit ju atëherë që këtë kërkesë po ia

24 drejtonit z. Limaj në cilësinë e tij si drejtor apo shef i

25 Drejtorisë së Policisë Ushtarake?

1 PË. Nëse nuk gabohe, unë kur e kam bo shkresën iu kam drejtu
2 Drejtorisë së Policisë Ushtarake e nuk iu kam drejtu kurrfarë
3 autoriteti me emën. Nuk e di, nuk e di nëse atë kohë unë e kam
4 ditë që Fatmir Limaj është drejtor i Drejtorisë së Policisë
5 Ushtarake apo jo.

6 GJYKATËSI BARTHE: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Në
7 fakt kjo ishte pikërisht pyetja ime. Nëse kishit dijeni ju që
8 letrën apo kërkesën po ia drejtonit z. Limaj si shef i
9 Drejtorisë së Policisë Ushtarake. Unë e di që nuk e keni
10 përmendur z. Limaj, por thjesht doja të dija, e dinit ju
11 asokohe që letrën po ia dërgonit atij apo jo?

12 PË. Nuk e di. Nuk e di. Por edhe një herë po e theksoj se
13 është orientue letra në bazë të shënimeve që kanë qenë në
14 vulën e atij dokumenti.

15 GJYKATËSI BARTHE: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Po ju
16 pyes, z. Fondaj, sepse sikur sapo e konfirmuat para dy
17 minutash, z. Limaj ka qenë komandant i Brigadës 121, dhe nëse
18 më kujtohet saktë nga letra, letra përmendte problematikat me
19 të cilat po përballëshit ju me anëtarë të Brigadës 121. Të
20 paktën ishte rasti i këtij automjetit që u sekuestrua, që u
21 mor prej jush dhe duhet të përdorej nga Brigada 121. Prandaj
22 po jua bëj këtë pyetje.

23 PË. Realisht ashtu ka ndodh, por megjithatë unë e kam drejtu
24 ankesën, respektivisht njoftimin në shkresën, domethënë në
25 Drejtorinë e Policisë Ushtarake dhe një herë po e përmendi,

1 për faktin se dokumenti e ka pas vulën. Edhe personi në fjalë
2 më ka thanë që kam urdhër nga", është, domethënë, "policia
3 ushtarake". Domethënë, këto dy elemente pak a shumë kanë qenë
4 që unë të orientohej dhe të bëj ankesë në atë vijë.

5 GJYKATËSI BARTHE: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] E
6 kuptoj. Faleminderit.

7 Z. Fondaj, dje i thatë z. Misetic, Avokatit të z. Thaçi,
8 se:

9 "... të gjithë drejtorët që kishte UÇK-ja në Shtabin e
10 Përgjithshëm, ishin këshilltarë të shefit të Shtabit..."

11 Dhe:

12 "... në rolin e tyre si këshilltarë i jepnin këshilla
13 Shtabit të Përgjithshëm [Korrigjim i përkthyesit: shefit të
14 Shtabit] se si të formulonte një urdhër."

15 Ju kujtohet që e keni thënë këtë dje?

16 PË. Nëse e kam thanë, e kam thanë në kuptimin si është dashtë
17 me funksionu. Domethënë, në bazë të perceptimeve të mia edhe
18 njohurive të mia për sa i përket strukturës ushtarake. E jo a
19 ka funksionu në atë formë apo jo, unë nuk kam njohuri.

20 GJYKATËSI BARTHE: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Këtë e
21 keni thënë në kuadër të diskutimit, kur po diskutonit për
22 pozitën e z. Limaj si drejtor i policisë ushtarake. Po a vlen
23 e njëjta gjë për z. Thaçi? A ishte dhe z. Thaçi thjesht një
24 këshilltar i shefit të Shtabit të Përgjithshëm në pozitën e
25 tij?

1 PË. Po në fjalorin tonë ushtarak, shefi i Shtabit është ai i
2 cili thjesht është në hierarkinë ushtarake person numër tre.
3 Domethënë numër një është komandanti, zëvendësi dhe nën ta
4 vjen shefi i Shtabit. Në terminologji ushtarake. Në
5 organizimin tonë nëse ka pas ndonjë strukturë pak ma ndryshe,
6 atëherë është tjetër problematikë.

7 GJYKATËSI BARTHE: [Përmes videolidhjes] [Përkthim]
8 Supozojmë se z. Rexhep Selimi ka qenë në fakt inspektor i
9 përgjithshëm i tërë UÇK-së. Atëherë, edhe z. Selimi duhet të
10 kishte qenë këshilltar për shefin e Shtabit --

11 PË. Në princip -- po.

12 GJYKATËSI BARTHE: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] -- në
13 cilësinë e tij? Por ama ju nuk po thoni që në të vërtetë ishin
14 z. Selimi dhe z. Thaçi këshilltarë të shefit të Shtabit në
15 shtator, tetor të 1998, kur jeni takuar me ta?

16 PË. Po unë nuk i di saktë mënyrën edhe punën se si ata vërtet
17 kanë punu, por unë në princip them atë në bazë të asaj që kam
18 njohuri dhe mësu nga shkolla, ata duhet të jenë në, brenda
19 përgjegjësisë së shefit të Shtabit. Mirëpo, në fazën, edhe
20 njëherë, në fazën e shtatorit edhe tetorit, shefi i Shtabit
21 nuk është qujt shef Shtabi por është qujt shef i operacioneve.
22 Kështu që në atë periudhë, domethënë pjesa e Shtabit ka mujt
23 me e udhëheq ndoshta edhe dikush tjetër.

24 GJYKATËSI BARTHE: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Sapo
25 përmendët një shkollë, e kishit fjalën për shkollën ushtarake

1 të armatës jugosllave?

2 PË. Po.

3 GJYKATËSI BARTHE: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Po ajo
4 ushtri a kishte drejtori? Edhe shtab të përgjithshëm?

5 PË. Ushtria jugosllave?

6 GJYKATËSI BARTHE: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Po,
7 ushtria jugosllave.

8 PË. Po sigurisht që ushtria jugosllave ka pas shtabin e vet.
9 E tash pjesa në brendi e organizimit të saj, nuk e di saktë,
10 por realisht sipas asaj, po. A në, domethënë ka pas nën-
11 sektorët e vet, me emërtime ndoshta janë qujt ndryshe, por
12 sidoqoftë i ka pas.

13 GJYKATËSI BARTHE: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Edhe
14 drejtoria politike?

15 PË. Ushtrisë jugosllave nuk iu ka dash drejtoria politike se
16 ata kanë pas qeverinë, respektivisht i kanë pas organet e
17 tjera shtetërore. Edhe ne me fazën e prillit kur realisht u
18 formua qeveria e përkohshme, drejtori i Drejtorisë Politike
19 Ushtarake kaloi edhe u bë kryeministër në qeverisë së
20 përkohshme. Pra, kur ekzistojnë institucionet e shtetit
21 atëherë normale që shumë gjana dalin edhe nuk ka nevojë të
22 jenë pjesë e shtabit.

23 GJYKATËSI BARTHE: [Përmes videolidhjes] [Përkthim]
24 Faleminderit. Kam një pyetje të fundit lidhur me këtë temë. Ju
25 i përmendët se kush ishte shef i Shtabit në Shtabin e

1 Përgjithshëm të UÇK-së në atë kohë. Pra, kur them në atë kohë,
2 kam fjalën shtator-tetor të 1998. Për sqarim, ka qenë z.

3 Bislum Zyrapi?

4 PË. Ende në fazën e shtatorit u qujt si shefi i operacioneve.
5 Edhe në fillimin, ndoshta i tetorit. Ma vonë, është njoft me
6 emën shef i shtabit. Saktë, periudha e ndarjes mes shefit të
7 operacioneve dhe shefit të shtabit, nuk e di.

8 GJYKATËSI BARTHE: [Përmes videolidhjes] [Përkthim]

9 Faleminderit. Pyetjet e tjera i kam për hetimet kundër Blerim
10 Kuqit, edhe mbase kolegët e mi do kenë më shumë pyetje për
11 këtë, por unë do të doja të dija veç këtë. Në intervistën për
12 ZPS-në, në Pjesën 7, faqja 21, si dhe në seancën përgatitore,
13 ju keni thënë se ju besoni se ju ka marrë në pyetje një
14 prokuror, gjegjësisht Sokol Dobruna, në prani të avokatit
15 mbrojtës që ishte Agron Berisha dhe një procesverbalmajtësi,
16 kështu?

17 PË. Po.

18 GJYKATËSI BARTHE: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] A mund
19 të na shpjegoni, se nga e dinit ju që personi që kishit
20 përballë ishte Sokol Dobruna? Nuk e kam fjalën këtu për
21 funksionin e tij si prokuror a si gjykatës, por për personin.
22 E njihnit që më përpara Sokol Dobrunën?

23 PË. Po. Sokol Dobrunën e njoh bukur moti. E njoh prej vitit
24 dikund 1990.

25 GJYKATËSI BARTHE: [Përmes videolidhjes] [Përkthim]

1 Pyetjet e fundit për këtë temë. A keni dijeni të ketë pasur
2 raste të tjera apo hetime të tjera apo gjyqe të tjera të
3 drejtuara prej z. Dobruna apo ndonjë gjyqtari apo prokurori
4 tjetër të UÇK-së, por kundër personave që nuk ishin anëtarë të
5 UÇK-së, apo ndryshe civilë, dhe të cilët akuzoheshin se kishin
6 bashkëpunuar me armikun?

7 PË. Nuk jam në dijeni.

8 GJYKATËSI BARTHE: [Përmes videolidhjes] [Përkthim]
9 Faleminderit. A e dini se kush ishte përgjegjës për t'i
10 trajtuar këto raste, kush ishte përgjegjës për t'i hetuar këto
11 raste, kush arrestonte këto persona bazuar në dyshime?

12 PË. Po realisht, çka thashë, për sa i përket çështjes në
13 princip me fol, atëherë vjen struktura ushtarake që është
14 përgjegjësi e policisë. Por policia merr një lloj informacioni
15 nga sektori i zbulim-kundërzbulimit. Mirëpo, në praktika çka
16 ka ndodh a ka pas raste a s'ka pas, unë nuk mund të lëshohem
17 se nuk di. Nuk di.

18 GJYKATËSI BARTHE: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Z.
19 Fondaj, pyetjet e fundit i kam për një person që e keni
20 përmendur në intervistën për ZPS-në dhe keni thënë që ishte
21 një nga zëdhënësit e UÇK-së, e më konkretisht, z. Adem Demaçi.
22 Kjo është në Pjesën 7 të intervistës suaj për ZPS-në.

23 Pikë së pari, ju gjatë luftës, jeni takuar ndonjëherë me
24 z. Demaçi, dhe në qoftë se po, ku dhe me ç'rast?

25 PË. Jo, unë me Adem Demaçin nuk jam taku asnjëherë gjatë

1 luftës.

2 GJYKATËSI BARTHE: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Është
3 ende dëshmia juaj që z. Demaçi ka qenë një nga zëdhënësit e
4 UÇK-së?

5 PË. Këtë informacion e jap në bazë të asaj se është dhanë
6 edhe në mjetet e informimit publik.

7 GJYKATËSI BARTHE: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Z.
8 Fondaj, po jua bëj këtë pyetje sepse kemi dëgjuar disa herë në
9 këtë sallë gjyqi që z. Demaçi ka qenë figura më e rëndësishme,
10 në mos udhëheqësi i vërtetë i UÇK-së. Si i përgjigjeni ju
11 kësaj?

12 PË. Unë nuk kam pas informacion ma tepër se atë që e thashë.

13 GJYKATËSI BARTHE: [Përmes videolidhjes] [Përkthim]
14 Sidoqoftë, do ju bëj dhe dy pyetje të tjera. A e dini nëse z.
15 Demaçi ka qenë anëtar i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së në
16 1998 ose në 1999?

17 PË. Jo, nuk e di.

18 GJYKATËSI BARTHE: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] A e
19 dini nëse ka pasur ndonjë udhëzim a urdhëresë ushtarake qoftë
20 e përgjithshme apo ushtarake të jetë lëshuar prej z. Demaçi
21 për forcat e UÇK-së gjatë luftës? Keni parë a keni dëgjuar për
22 urdhëresa apo udhëzime të tilla?

23 PË. Udhëzimet të cilat i ka dhënë në cilësinë e zëdhënësit,
24 po. Domethënë, ato çka i ka dhanë në mjetet e informimit. Edhe
25 një prej elementeve që e përmenda edhe dje, është fakti ku ai

1 kërkon që ushtria të organizohet dhe të kalojë në formën e
2 veprimit gueril.

3 GJYKATËSI BARTHE: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Ishte
4 udhëzim apo urdhëresë nga pikëpamja juaj?

5 PË. Udhëzim. Se plus asaj ishte çështja që diçka të rritet të
6 lirohen edhe ata që e kanë mundësi të punojnë diçka në forma
7 të tjera të lirohen nga shërbimi dhe ushtria. Propozim ka
8 qenë, udhëzim i saj, që të kalojë në veprime guerile.

9 GJYKATËSI BARTHE: [Përmes videolidhjes] [Përkthim]
10 Faleminderit, z. Fondaj. Unë nuk kam më pyetje.

11 PË. Faleminderit, gjithashtu.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit
13 Gjykatës Barthe.

14 Do bëjmë një pushim të shkurtër tani, dhjetë minuta,
15 kthehemi në sallën e gjyqit për dhjetë minuta, pra.

16 Z. EMMERSON: [Përkthim] Nuk e di a është vetëm problemi
17 im, por duket sikur është goxha vapë në sallën e gjyqit, është
18 goxha nxehtë.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar]
20 [Përkthim] Okej, do sjellim dikë që të kontrollojë
21 temperaturën.

22 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

23 --- Seanca ndërpritet në orën 15.20

24 --- Seanca rifillon në orën 15.30

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

1 Asistente, mund ta sillni dëshmitarin në sallë.

2 [Dëshmitari vijon dëshminë]

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

4 Do të vazhdojmë më tej, z. Fondaj, do të kemi disa pyetje
5 tjera nga Gjykatësi Mettraux tani.

6 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit, Gjykatësi
7 Smith.

8 Mirëdita, z. Fondaj.

9 PË. Mirëdita, z. Gjykatës.

10 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dua t'ju bëj një pyetje
11 pasuese apo më mirë dua që të ndjekim disa tema të cilat janë
12 ngritur dhe më herët me ju. Së pari, dua që të sqarojmë pak
13 çështjen e kronologjisë lidhur me atë se çfarë i ka ndodhur
14 Blerim Kuqit nga momenti kur u kthyet në Kosovë në fillim të
15 dhjetorit të 1998. Dhe mesa kuptova unë nga dëshmia juaj, ju
16 thatë që ishit larguar nga Kosova për në Shqipëri rreth datës
17 10 shtator dhe ishit kthyer diku nga data 3 apo 4 dhjetor
18 1998, a është e saktë kjo, Dëshmitar?

19 PË. Është e saktë. Që Blerim Kuqi ka shkue diku ka 9, 10
20 shtatori edhe është kthye në dhjetor, në fillim të dhjetorit.

21 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Unë kuptova që ju
22 sugjeruat dhe, në qoftë se s'e kam kuptuar siç duhet ju lutem
23 më korrigjoni, por ju thatë ai kthye mbrapssh së bashku me
24 disa luftëtar të tjerë, disa prej të cilëve erdhën pas pak
25 tij, a është e saktë kjo, Dëshmitar --

1 PË. Jo, z. Gjykatës,

2 PY. -- pak përpara tij.

3 PË. Ai erdh bashkë me ta. Por realisht gjatë udhëtimit e
4 rrugëtimit mbet pak mbrapa përndryshe organizimi edhe ardhja e
5 tyne është rezultat ekskluziv i Blerim Kuqit edhe i punës
6 teme.

7 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A e kuptoj drejtë, a e kam
8 kuptuar drejtë dje, që sugjeruat që Bislime Zyrapi kishte
9 lehtësuar kthimin e Blerim Kuqit në Kosovë. A e kam kuptuar
10 drejtë që keni thënë këtë gjë, Dëshmitar, dje?

11 PË. Jo, diçka të tillë të ngjashme nuk e di kam mujt me
12 thënë. Po realisht vetëm kur është roli te Bislime Zyrapi unë
13 dje e pata përmend që Bislime Zyrapi ka qenë në dijeni të
14 organizimit të ardhjes të ushtarëve nga Ministria e Mbrojtjes
15 në territorin e Kosovës.

16 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] E kuptoj. Faleminderit që
17 ma sqaruat, Dëshmitar.

18 A e kuptova qartë dëshminë tuaj kur thatë që kur u kthye
19 Blerim Kuqi në dhjetor, në fillim të dhjetorit të 1998, ai ka
20 ardhur mbrapsht me një urdhër emërimi nga Halil Bicaj si
21 komandant i zonës së Pashtrikut, a është e vërtetë kjo, a
22 është e saktë kjo Dëshmitar?

23 PË. Në bazë të informacioneve që unë kam, që s'muj me i
24 dëshmue ndoshta apo bisedave, ai erdh, Blerim Kuqi, pra, kur
25 niset prej Shqipërisë në drejtim të Kosovës, ka qenë me

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Kurtesh Fondaj (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga Trupi Gjykses

Faqe 118

1 funksionin prej Ministrisë së Mbrojtjes në funksion të
2 komandantit të zonës operative të Pashtrikut.
3 Zëvendëskomandant ka qenë Sylejman Kollçaku. Mirëpo, gjatë
4 udhëtimit ata dy i kanë shkëmby pozicionet, domethënë Sylejman
5 Kollçaku ka marrë detyrën e komandantit të zonës, ndërsa
6 Blerim Kuqi zëvendëskomandant. Këto që po i them janë
7 informacione që nuk muj me i vërtetu me prova, por
8 informacione të këtij lloji i kam.

9 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Por besoj se pajtoheni, në
10 qoftë se Kuqi është prezantuar si komandant i zonës së
11 Pashtrikut, ju pajtoheni me mua që në atë kohë kishte në fakt
12 një komandant të zonës së Pashtrikut dhe ky person ishte Ekrem
13 Rexha, a është e saktë kjo, Dëshmitar?
14 PË. Zoti Gjykatës, çështja është pak më e komplikume edhe në
15 këtë fazë edhe Ekrem Rexha ka qenë në Shqipëri. Nuk ka qenë në
16 territor të Kosovës. Ai ka hy në territor të Kosovës më datën
17 14 dhjetor. Edhe është, domethënë, paraprakisht veç është dit,
18 unë e kam dit se ai do të vjen në funksion të shefit të
19 shtabit, se kam pas informacion nga komandanti i zonës, se kam
20 pas informacion nga shefi i shtabit Bislir Zyrapi.

21 Mirëpo, çështja e Blerimit që e përmenda, Blerimi nuk
22 është prezantue si komandant kur ka ardhë atje, domethënë, nga
23 Shqipëria, as nuk është prezantue as si zëvendëskomandant. Por
24 ka ardhë dhe e ka dit se emërimet sipas marrëveshjes ushtarake
25 bëhen nga Bislir Zyrapi dhe ai nuk ka pretenduar apsikisht

1 kurrfarë pozicioni. Kështu ka mbet dhe ka qenë i sistemum në
2 kuadër të Brigadës 123 si komandant i një kompanie vëzhguese
3 diversantë respektivisht e njohur me emrin njësiti ose
4 Kompania Kitrat.

5 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Atëherë për të qenë të
6 saktë, nga ajo çfarë thatë tani, z. Zyrapi nuk e konsideronte
7 që Blerim Kuqi ishte emëruar nga ndonjë person me rëndësi për
8 të qenë pjesëtar ose komandant i zonës së Pashtrikut, kështu
9 mund ta kuptoj, është e saktë kjo, Dëshmitar?
10 PË. Unë dhe dje e përmenda që në marrëveshjen që e kanë arrit
11 Halil Bica, si Ministër i Mbrojtjes i qeverisë Bukoshi dhe
12 Bislum Zyrapi si shef shtabi i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës
13 një prej pikave është që emërimet në territor të Kosovës,
14 domethënë, brenda Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës i bën shefi i
15 shtabit, pra, Bislum Zyrapi edhe të gjitha emërimet që vijnë
16 nga Shqipëria janë të përkohshme deri në momentin e ardhjes në
17 terren. Pastaj pasohen emërimet nga shefi i shtabit.

18 Kjo ka qe pjesë e marrëveshjes edhe ashtu është vepru.

19 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit. Është e
20 qartë tani.

21 Atëherë le të kalojmë tek hapi tjetër në këtë
22 informacion. Është informacion që në fakt jepet në provën
23 materiale P1204.

24 Do të mundohem që të kalojmë në aspektin kronologjik të
25 ngjarjeve që kanë ndodhur në atë kohë që kanë të bëjnë me z.

1 Blerim Kuqi dhe do të përqendrohem konkretisht në pjesën e
2 fundit të 1998 dhe në fillim të 1999.

3 Së pari, ju kërkoj që t'i hidhni një sy këtij dokumenti.

4 Ju lutem lexojeni me mendje. Do i kërkoja Sekretares që të
5 paraqesë të gjithë faqen kështu që lexojeni ju lutem. Dhe kur
6 të keni përfunduar së lexuari më thoni.

7 PË. Po, e lexova.

8 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ju lutem kalojmë tek faqja
9 tjetër për të vazhduar me leximin dëshmitari, mund ta kaloni
10 te faqja tjetër janë dy versionet në shqip edhe në anglisht.

11 Të kalojmë tek faqja e parë njëherë, sikur dhe mund ta
12 shihni duket që ky dokument është një procesverbal i mbledhjes
13 së Shtabit të Përgjithshëm në Divjakë më datë 29 dhjetor 1998.
14 Dhe kjo mund të jetë rendi i ditës i atij takimi. Pyetja ime e
15 parë është kjo: A jeni në dijeni që ka ndodhur një mbledhje e
16 Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së në Divjakë më 29 dhjetor
17 1998, Dëshmitar?

18 PË. Jo, nuk jam në dijeni.

19 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Tani le të shikojmë pak
20 këto zërat e ndryshme ose pikat e ndryshme që janë planifikuar
21 për diskutim në këtë takim. Atëhere tek pika 1 thuhet:

22 "Çështje të organizimit dhe strukturimit" dhe pastaj në
23 kllapa thuhet "(me theks të veçantë Pashtriku)".

24 Mund të kalojmë tek faqja tjetër.

25 Mund të shihni aty në mes të kësaj faqeje që është "për

1 rishqyrtimin e komandës së zonës operative të Pashtrikut". A e
2 lexoni këtë në mes të faqes, Dëshmitar?

3 PË. Po.

4 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pyetja ime e parë është
5 kjo: A jeni konsultuar ju vetë ose mesa dini ju, a janë
6 konsultuar persona të tjerë nga zona e Pashtrikut lidhur me
7 diskutimet e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së sa i takon
8 strukturimit të zonës tuaj dhe strukturës së komandës? A ju
9 kanë thënë ata nga Shtabi i Përgjithshëm që kanë diskutuar
10 çështje të tilla për zonën tuaj, Dëshmitar?

11 PË. Në këtë periudhë komandant i zonës ka qenë Ekrem Rexha.
12 Nëse ai ka pas dijëni është çështje tjetër. Unë për këtë
13 element ose këto që po i shoh tash është sot për herë të parë
14 dhe s'jam bash kurrfarë informacioni paraprak s'kam pas.

15 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A do të thotë kjo që Drini
16 nuk ka thënë asnjëherë ty që ka qenë i informuar për diskutime
17 apo biseda të tilla, a do ishte e drejtë të thuhej kjo?

18 PË. Nuk e di. Ndoshta e kemi bisedu, po nuk mbaj mend. Që ka
19 qenë diçka rreth kësaj teme, nuk besoj, se do të ma kish
20 thënë.

21 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Të kalojmë përsëri tek
22 faqja e parë.

23 Ndërmjet tema që diskutohen është rasti i një serbi të
24 liruar në Llap. A jeni në dijëni të një oficeri serb që quhet
25 Goran Zbilic? A keni dëgjuar ndonjëherë për ndonjë rast të

1 tillë që përfshin një peron me emrin Goran Zbiliq?

2 PË. Jo.

3 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pika tjetër në këtë
4 renditje është rasti i Blerim Kuqit, që më datë 29 dhjetor
5 përshkruhet si dezertor. Këtu thuhet se ai më vonë është
6 emëruar komandant i kompanisë vëzhguese të Brigadës 123. A
7 është ky roli që ky mendoni se ai është emëruar ose vendi ku
8 është emëruar, pozicioni ku është emëruar ai në atë kohë,
9 Dëshmitar?

10 PË. Atë kohë ai, fakt, domethënë, është në dhjetor që ka krye
11 detyrën e komandantit të kompanisë vëzhguese diversante në
12 Brigadën 123.

13 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A keni pas dijeni ose me
14 aq sa dini ju, a i është thënë Drinit që rasti i Blerim Kuqit
15 si dezertor është diskutuar në fund të dhjetorit të 1998 në
16 nivelin e Shtabit të Përgjithshëm?

17 PË. Duhet të ma kish thënë Blerimi -- po duhet tema kish
18 thënë Ekrem Rexha, po realisht nuk e di që ka qenë edhe ai i
19 informum. Unë jo se jo, por dyshoj që edhe ai nuk e ka dit
20 këtë çështje.

21 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Drini nuk ju tha që ishte
22 informuar për vendimin për arrestimin e Blerim Kuqit pas atij
23 takimi, apo jo, nuk ua ka thënë një gjë të tillë, kështu,
24 Dëshmitar?

25 PË. Jo. Sepse po të them një çështje sikur Ekrem Rexha ta

1 kish dit se Blerimi është në shënjestër, respektivisht në
2 dyshim të arrestimit, nuk do të shkonte me të në Divjakë në
3 datën kritike.

4 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit. Tani le të
5 kalojmë dhe një herë tek faqja e dytë për herë të fundit.

6 Këtu në fillim fare të faqes thuhet rasti i Ukë Bytyqit
7 dhe Isa Morinës. Na keni thënë gjatë dëshmisë tuaj dje se kush
8 janë këta dy persona. Kam vetëm një pyetje pasuese lidhur me
9 këtë temë. A është e saktë që dikur në janar dhe në muajt në
10 vijim Ukë Bytyqi, Isa Morina dhe kur u lirua edhe Blerim Kuqi
11 u bënë të gjithë pjesë e Brigadës 123? A është e saktë kjo
12 dëshmitar? Në role të ndryshme kuptohet.

13 PË. Ukë Bytyqi, Isa Morina kanë qenë pa ndërpre prej fillimit,
14 domethënë, prej qershorit deri në përfundim të luftës pjesë e
15 Brigadës 123. Blerim Kuqi ka pas gjithashtu luhatje të vogla
16 për të cilat realisht, pas kësaj që ju thatë, është fakt që ai
17 ka ushtruar dhe mandejna detyrën e komandantit të njësisë
18 vëzhguese diversante.

19 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pyetja e fundit lidhur me
20 këtë dokument ka të bëjë me këtë pikën që shkruhet këtu, rasti
21 i Kilaj-Krasniqit. A e dini për çfarë bëhet fjalë kur shkruhet
22 rasti Kilaj-Krasniqi.

23 PË. Për rastin Kilaj-Krasniqi mundet pak ndoshta me qenë
24 sepse në atë periudhë, domethënë, është fjala, fundi i muajit
25 dhjetor në kuadër të Brigadës 122 krijohen dy komanda

1 paralele, që njëna-tjetrën e quanin të paligjshme. Dhe
2 realisht që e përmenda në këtë periudhë ka ndërhy komanda e
3 zonës operative të Pashtrikut edhe e ka formue komandën e
4 Brigadës 1 edhe kemi arrit t'i pajtojmë këtë komandë.

5 Mu po më aludon se kemi të bëjmë me këtë problematik.

6 Nëse është diçka tjetër, tash nuk e di.

7 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit, Dëshmitar.

8 Tjetra gjë që dimë dhe që na e keni dhënë ju në fakt këtë
9 informacion është që ai pra, Blerim Kuqi, Nexhmedin Kastrati
10 dhe Drini thërriten për një takim në Shtabin e Përgjithshëm më
11 datë 16 janar 1999, a është e saktë kjo, Dëshmitar?

12 PË. Po, ata shkojnë në Shtab të Përgjithshëm, e saktë,
13 detajet dhe në forma e ftesës dhe mënyra unë nuk e kam dit
14 derisa ju tash po e konfirmoni me datë. Nuk po e kundërshtoj.

15 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do t'ju tregoj një
16 dokument për pak, Dëshmitar. Por para se ta bëj këtë gjë, a e
17 kam kuptuar drejtë që Drini të ka thënë ty që në atë takim ata
18 ishin thirrur nga Jakup Krasniqi?

19 PË. Po, këtë ma ka thënë.

20 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretares që
21 ta paraqesë në ekran provën materiale P1105. Ju lutem
22 zvogëloheni pak dokumentin në shqip.

23 Pyetja e parë që kam për ju, Dëshmitar, është kjo: A e
24 keni më përpara këtë dokument?

25 PË. Jo.

1 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Duke e parë kështu me një
2 vështrim të shpejt, është një dokument që mban titullin
3 "Urdhër për paraqitje në Shtabin e Përgjithshëm" dhe i vihet
4 në vëmendje komandantit të zonës operative të Pashtrikut,
5 Drinit në atë kohë. Dhe thuhet që:

6 "Në bazë të rregullores së punës së Shtabit të
7 Përgjithshëm të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës lëshoj këtë:
8 "Urdhëresë".

9 Urdhërohet të paraqitet në Shtabin e Përgjithshëm të
10 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës komandanti i zonës operative të
11 Pashtrikut, Drini, së bashku me komandantin e Brigadës 123 dhe
12 Blerim Kuqin më datë 16 janar 1999

13 Urdhëresa ka karakter obligativ. Dhe është urdhëresë që
14 është nënshkruar nga Jakup Krasniqi si zëvendëskomandant.

15 Së pari, përmbajtja e kësaj urdhërese a është në pajtim
16 me atë çfarë ju ka thënë Drini në atë kohë ju, pra, që ishte
17 urdhëruar që të shkonte në një takim në Shtabin e
18 Përgjithshëm?

19 PË. Atë me sa mbaj mend unë, Ekrem Rexha më ka thënë kanë pas
20 një ftesë, jo urdhnesë. Edhe paragrafi i dytë i urdhnesës
21 thotë urdhnesa ka karakter obligativ. Pak po më duket absurde
22 kjo në terminologjinë ushtarake se çdo urdhëresë është
23 obligative.

24 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Drini a të ka thënë ty se
25 kush tjetër përveç vetes së tij, domethënë, Nexhmedin

1 Kastratit dhe Blerim Kuqit, domethënë, përveç këtyre tre
2 personave që unë përmenda, a të ka thënë Drini ty se kush
3 tjetër ishte pjesë e atij takimi në janar të 1999?

4 PË. Nuk më kujtohen detajet.

5 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pra, nuk ju kujtohet se
6 cilët anëtarë të Shtabit të Përgjithshëm, për shembull, kanë
7 qenë të pranishëm në atë takim, mbështetur në atë çfarë të ka
8 thënë ty Drini?

9 PË. Nuk më kujtohen. Veç e di që realisht as që ka mujt me
10 fol Ekremi, pas ardhjes ka qenë jashtëzakonisht shumë i
11 frustrum edhe ka qenë në një gjendje shumë, shumë të keqe
12 emocionale.

13 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A është e drejtë të
14 supozohet që ai ishte i mërzitur për shkak të arrestimit të
15 Blerim Kuqit?

16 PË. Po, po. Pikërisht për këtë e kam fjalën.

17 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do flasim dhe për
18 arrestimin e Blerim Kuqit pas pak, por përpara sesa të
19 diskutojmë lidhur me këtë, të shohim pak këtë dokument dhe një
20 herë. Pra, është dokumenti i cili është nënshkruar nga Jakup
21 Krasniqi në pozicionin e tij si zëvendëskomandant i Shtabit të
22 Përgjithshëm. A e dini arsyen sepse nuk e ka nënshkruar Bislim
23 Zyrapi këtë urdhër, Dëshmitar?

24 PË. Nuk e di, po pak po më duket i diçka jo në rregull se nuk
25 ka as numër protokolli ky dokument.

1 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A mendoni që është e
2 mundur që Bislum Zyrapi nuk ka dashur që të ketë pikë lidhjeje
3 me arrestimin edhe burgosjen e Blerim Kuqit nga ato çfarë ju
4 keni diskutuar me të?

5 Z. ELLIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, ju kërkoj
6 ndjesë që kundërshtoj pyetjet e bëra nga Trupi Gjykses. Por ky
7 është një dokument që dëshmitari nuk e ka parë më përpara.
8 Thjesht po i kërkoj që të spekulojë për çështje të cilat ai
9 nuk ka dijeni. Pra, pyetja që i bëhet tani dëshmitarit është
10 në qoftë se Bislum Zyrapi ka treguar ndonjë gjë lidhur me
11 ndalimin dhe arrestimin e Blerim Kuqit, ndërkohë që nuk thuhet
12 gjë fare as për arrestimin, as për ndalimin e Blerim Kuqit në
13 këtë dokument.

14 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Në rregull. Do ta
15 formulojë ndryshe.

16 Kur keni folur me Bislum Zyrapi pas arrestimit a ju
17 kujtohet në qoftë se Bislum Zyrapi ju ka thënë në qoftë se
18 ishte dakord ose pajtohej me arrestimin e Blerim Kuqit ose në
19 qoftë se ishte kundër këtij arrestimi dhe ndalimi, ju kujtohet
20 ndonjë gjë lidhur me këtë, Dëshmitar?

21 PË. Nuk më kujtohen detajet rreth formës dhe mënyrës apo
22 shpjegimit të tij, por realisht e di që edhe ai ka qenë i
23 befasum me momentin e arrestimit të Blerimit.

24 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Drini ju ka thënë dhe mund
25 të shikohet dhe nga ky dokument që duket sikur mbështet atë

1 çfarë ju ka thënë Drini, që urdhri për të marrë pjesë në këtë
2 mbledhje ose në këtë takim është dhënë nga Jakup Krasniqi si
3 person ushtarak. Unë po ju pyes ju shefi i shtabit i cili
4 zakonisht trajtonte çështje të tilla, pse Drini, Kastrati edhe
5 Kuqi janë thërritur nga Bislim Zyrapi, pse është kjo arsye në
6 qoftë se jeni në dijeni kuptohet, në qoftë se dini përgjigjen
7 e kësaj pyetjeje?

8 PË. Jo, nuk jam -- nuk kam kurrfarë informacioni. Po
9 megjithatë në aspektin logjik komandant, zëvendës komandanti,
10 vjen si strukturë, domethënë, si emërtim ose si hierarki është
11 në një komandanti, dy zëvendëskomandantë, në të shefi i
12 shtabit. Pra, zëvendëskomandanti është mbi nivelin e shefit të
13 shtabit si hierarki ushtarake.

14 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Nëse e kuptoj siç duhet
15 këtë që thatë, zëvendëskomandanti i takon që mund të jepte
16 çdolloj urdhri që shefi i shtabit mund të ishte në gjendje që
17 të ekzekutonte, madje edhe më shumë se kaq, këtë thatë?

18 PË. Po. Prandaj po them shkresa si shkresë nuk domethënë
19 patjetër me qenë nga shefi i shtabit, po megjithatë ka mujt me
20 bë një shkresë pa kurrfarë problemi edhe zëvendëskomandanti,
21 respektivisht komandanti.

22 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] E kuptoj. Faleminderit.

23 Tani do i kërkoj Sekretares të paraqesë në ekran provën
24 P1106.

25 Me aq sa mundemi, po përpiqem që të ndjekim, të bëjmë

1 pyetje në mënyrë kronologjike. Gjithsesi të shfaqet një ekran
2 njëherë dokumenti dhe do ju kërkoj t'i hidhni një sy ta lexoni
3 atë dhe pasi ta keni lexuar do ju bëj disa pyetje. Lexoni dot
4 apo doni t'jua zmadhoj më, Dëshmitar?

5 PË. Jo, jo. Në rregull është. Në rregull. E lexova.

6 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Atëherë tani ne e dimë që
7 hapi i radhës në këtë proces është ajo që ka ndodhë në 16
8 janar 1999 është një shkresë që është nga Ushtria Çlirimtare e
9 Kosovë Shtabi i Përgjithshëm. Ka numrin e protokollit. I është
10 dërguar Prokurorisë Ushtarake të UÇK-së. Mban titullin raport.
11 Është nënshkruar nga Fatmir Limaj. Dhe ka lidhje me të
12 akuzuarin Blerim Kuqi. Dhe në këtë shkresë shpjegohet që më 11
13 shtator 1998 ka kryer vepër penale të dezertimit të paraparë
14 në kodin penal ushtarak dhe vijon përshkruan më tej.

15 Tani pyetja e parë që kam unë është kjo: A e dinit ju që
16 në atë kohë Ushtria Çlirimtare e Kosovës kishte kod penal
17 ushtarak?

18 PË. Nuk jam në dijeni të dokumentacioneve që ka posedu Shtabi
19 i Përgjithshëm. Nuk jam në dijeni.

20 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A keni pasur dijeni që të
21 ekzistonte vepra penale e dezertimit në UÇK në atë kohë?

22 PË. Si term dezertim, po. Po si të konsiderohet ose definohet
23 ose të klasifikohet si vepër penale, s'e di. Në terminologji
24 pak normale, që këtu kemi të bëjmë me huqe, shumë gjena. Edhe
25 pse këtu shkrun poshtë juristi diplomuar, po megjithatë, unë

1 për vete s'jam jurist, po megjithatë në këtë shkresë gjej
2 plotë lë hapësirë për debat.

3 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po ju pyes për këtë debat
4 dhe lirisht komentoni. Pyetja e parë që kam unë është kjo: A
5 keni pas dijeni ju që në atë kohë Fatmir Limaj si drejtor i
6 drejtorisë së policisë ushtarake ka qenë i përfshirë në hetime
7 dhe ndjekje penale të personave, në këtë rast të një anëtari
8 të UÇK-së? Pra, keni pas dijeni për këtë?

9 PË. Jo.

10 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Në mes të kësaj faqeje të
11 paktën tek anglishtja thuhet:

12 "Nga ajo Prokurori", pra, dukej sikur z. Limaj "i kërkon
13 Prokurorisë të urdhëroj zbatimin e hetimeve në lidhje me këtë
14 çështje penale".

15 Tani a e kam kuptuar unë siç duhet këtë raport, lexoni
16 dhe shqipen, pra e kam kuptuar unë siç duhet që është z. Limaj
17 ai që urdhëron çeljen e hetimeve - më falni - zbatimin e
18 hetimeve në lidhje me Blerim Kuqin?

19 PË. Po kjo fjali realisht për mu që përmenda është shumë,
20 shumë e pakjartë. Edhe cilido të ketë qenë pozicioni në këtë
21 rast që po përmendi i drejtorit të policisë ushtarake, këto në
22 një shkresë të kësaj natyre, po më duket që i tejkalon
23 kompetencat dhe veprimet e veta.

24 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pra, me fjalë të tjera dhe
25 nuk dua të tua diktoj unë fjalët, mos më keqkuptoni, po z.

1 Limaj në cilësinë e tij si drejtor i policisë ushtarake ka
2 tejkaluar kompetencat e veta, këtë po përpiqeni të thoni?
3 PË. Po unë një çështje tash nuk e di a në kuadër të saj a ka
4 pas rregullore pune ma së pari edhe në bazë të asaj rregullore
5 duhet me i definu edhe me i ditë cilat janë detyrat e policisë
6 ushtarake e jo me ardhë çështjen e me kry edhe punën e
7 prokurorit policia. Se policia vepron po vepron në bazë të një
8 urdhri të një prokurori jo në kryen e vet.

9 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit. Shohim
10 dokumentin tjetër, mban numrin e provës materiale P1174.

11 Po ju jap një çast ta lexoni. Nëse keni nevojë ta
12 zmadhojmë na thoni.

13 PË. Jo, në rregull është.

14 E lexova, z. Gjykatës.

15 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit. Tani do ju
16 lutesha të komentoni disa nga këto që thuhet këtu. Por siç e
17 keni bërë dhe më përpara, lirisht na jepni dhe pikëpamjet
18 tuaja. Këtu titulli është "Aktvendim mbi paraburgimin". Dhe
19 mban të njëjtën datë që ka pasur dhe takimi që ka pasur Drini
20 me Kastratin, pra, kjo është datë 16 janar 1999. Dhe aktvendim
21 mbi paraburgimin është marrë nga juristi i diplomuar Fatmir
22 Limaj. Dhe thotë se ka arsye të bazuara se Blerim Kuqi, pa
23 arsye të mjaftueshme dhe pa miratimin e Shtabit të
24 Përgjithshëm ka ikur nga kompania e UÇK-së dhe për rrjedhojë
25 policia ushtarake ka nxjerrë vendimin për paraburgim për një

1 periudhë paraprake tre ditore. Dhe më pas është bazuar në
2 kodin penal ushtarak edhe veprën penale të dezertimit.

3 Dhe në fund thuhet që:

4 "Lejohet apelimi, kundër këtij aktvendimi është lejuar
5 ankesa me afatin prej 24 ... orësh."

6 E njëjta pyetje si më herët. A e dinit ju që z. Limaj ,si
7 shef i drejtorisë së polici ushtarake, kishte kompetencë të
8 urdhëronte ndalimin e një anëtari të UÇK-së?

9 PË. Jo. Po realisht po ju them edhe kjo shkresë në të vërtetë
10 është mjerim, këtë jo jurist i diplomum po një nxënës i klasës
11 së tetë me i shkruar, është gabim. Edhe nuk i falet, pale më
12 një jurist i diplomum ku të lidhet edhe të thotë e ka lëshuar
13 kompaninë e UÇK-së edhe pse e kishte cilësinë e komandantit të
14 kompanisë në zonën e Pashtrikut. Pastaj thotë pa arsye të
15 mjaftuar dhe së bashku me kompaninë e tij ka ikur për në
16 Shqipëri.

17 Ku ka logjik kjo? E ka lëshu kompaninë, me kompaninë e
18 tij ka ik për Shqipëri? Nuk ka logjik.

19 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do t'ju pyes edhe për
20 arsyet e tjera pse mund të jetë arrestuar z. Kuqi. Por a e
21 kuptoj unë siç duhet që ju nuk keni pasur dijeni që
22 paraburgimi për z. Kuqi të jetë marrë nga z. Limaj si drejtor
23 i drejtorisë së polici ushtarake?

24 PË. Unë veç e di që polici ushtarake e ka ndalu. A format
25 edhe mënyrat edhe shkresat edhe mënyra si ka ardhë deri te

1 ajo, nuk i di.

2 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do bëj një shtesë. Ka
3 pasur rregullore të policisë ushtarake në fuqi në atë kohë në
4 UÇK. A ju kujtohen këto rregullore?

5 PË. Jo.

6 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po ju them unë çfarë
7 thuhet në to. Dhe për procesverbal është dokumenti P9. Është
8 një dokument që quhet "Policia ushtarake dhe detyrat e saj".
9 Ka një nen atje, neni 4, ku thuhet se:

10 "Organet e policisë ushtarake janë vartëse, janë në
11 varësi të drejtorisë së policisë ushtarake i cili emëron
12 komandantët në zonat operative të policisë ushtarake -- në
13 polici ushtarake - më falni - të zonave operative."

14 Tani, unë e kuptoj që nuk e mbani mend ju t'i keni parë
15 këto rregullore, megjithatë ky neni 4 që unë sapo ju lexova a
16 përputhet me atë që ju kujtohet dhe ju sa i takon funksionimit
17 të policisë ushtarake në zona dhe nënzona?

18 PË. Ka pas një bisedë rreth kësaj çështjeje se kjo formë ka
19 interferu, respektivisht ka qenë ndërhyrje në njësitë vartëse,
20 respektivisht në zona edhe në brigada. Policia ushtarake në
21 nivel qendror ka mujt me dhënë informacione të caktme që
22 personi, domethënë, i emnum ka një informatë, domethënë, ka
23 një *background* negativ dhe si i tillë nuk mund të vendoset në
24 krye të njësisë, por jo ata në mënyrë ekskluzive me e vendosë.
25 E vendosë komandanti i brigadës, komandanti i zonës

1 komandantin e polici ushtarake në njësinë e vet.

2 Po kjo është fol edhe ka qenë një prej gabimeve që e ka
3 bë drejtorja e policisë ushtarake në atë kohë.

4 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Nga sa shohim ne është
5 vetë drejtori këtu që ka urdhëruar paraburgimin e një anëtari
6 të UÇK-së, apo jo?

7 PË. Po.

8 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Mirë. Shohim provën
9 materiale P1344. Ua kanë treguar dhe më herët këtë dokument.
10 Po kam edhe unë disa pyetje në lidhje me të.

11 Këtë dokument e keni parë dhe më përpara. E ka titullin
12 "aktakuzë", data 4 mars 1999. Edhe këtu është çështja e z.
13 Kuqi dhe keni parë disa pjesë të këtij dokumenti tashmë.

14 Megjithatë unë dua të shohim fundin e faqes së parë. E
15 shihni numrin, e shihni këtu thotë deklaratë e dëshmitarëve me
16 shkronja romake tek paragrafi -- me shkronja romake III, me
17 III romak "III-Deklarata dëshmitarësh ..."

18 PË. Po, po. Po.

19 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Të paktën anglishtja thotë
20 kështu që deklaratat e dëshmitarëve, gjegjësisht deklarata e
21 Habib Elshanit e 5 dhjetorit 1998, procesverbali i marrjes në
22 pyetje të shefit të shtabit operativ të zonës operative të
23 Pashtrikut ... të datës 20 janar 1999 dhe deklarata e ushtarit
24 Ilaz Kadolli e datës 7 dhjetor 1998, duhet të lexohen në këtë
25 seancë."

1 Thjesht dua që të më konfirmoni nëse deklarata e Habib
2 Elshanit dhe Ilaz Kadollit ishin marrë një ditë apo tre në
3 rastin e Kadollit pasi është kthyer Blerim Kuqi në Kosovë?
4 Pra, menjëherë pas rikthimit të tij për afërsisht.

5 PË. Nuk jam në rrjedhë të këtyre informacioneve. Nuk i di
6 detajet.

7 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Shohim faqen tjetër. Këtu
8 flitet për Prokurorin e Përgjithshëm Ushtarak të policisë
9 ushtarake, Prokurori i Përgjithshëm i policisë ushtarake me
10 mbiemër Sejdiu, me emrin Arben Sejdiu, më duket se na thatë që
11 ju këtë person nuk e njihni, pra, Arben Sejdiun?

12 PË. Nuk e njoh. Dhe për mua është emën i ri. S' di që kam
13 dëgju ndonjëherë me emër Arben Sejdiu.

14 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Thatë që krahas Sokol
15 Dobrunës, ju thatë, që ishte dhe një procesverbalmbajtës. A e
16 dini si e kishte emrin ky personi që mbante procesverbalin
17 gjatë kohës që po jepnit deklaratën për z. Dobruna?

18 PË. Jo.

19 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] E kuptoj që ju nuk e dini
20 se çfarë ka ndodhur në të vërtetë, po unë do ju pyes të më
21 tregoni sesi duhet të kishte funksionuar UÇK-ja. Ne pamë para
22 një çasti që z. Limaj, si drejtor i drejtorisë së polici
23 ushtarake, kishte lëshuar vendim për arrestimin e Blerim
24 Kuqit.

25 Nëse kjo është bërë me kërkesë të Jakup -- në qoftë se do

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Kurtesh Fondaj (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga Trupi Gjykues

Faqe 136

1 thoja unë që kjo është bërë me kërkesë të Jakup Krasniqit,
2 pra, se Jakup Krasniqi e ka informuar policinë ushtarake dhe
3 z. Dobruna lidhur me vendimin për ta arrestuar z. Kuqi, ju
4 keni ndonjë arsye për ta kontestuar këtë?

5 Z. ELLIS: [Përkthim] E kundërshtoj këtë pyetje. Kjo është
6 një pyetje që duhet ta bëjë Prokuroria nuk bëj ta bëj Trupi
7 Gjykues këtë pyetje. Mbi ç'baza mund të përgjigjet dëshmitari
8 e të thotë a e ka informuar Jakup Krasniqi policinë ushtarake?

9 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Mirë. Z. Ellis, po e bëj
10 pyetjen ndryshe.

11 Nëse Bislim Zyrapi atëherë do të thoshte që vendimi i
12 Shtabit të Përgjithshëm për të arrestuar z. Kuqi u është
13 përcjellë nga zoti apo është komunikuar nga z. Jakup Krasniqi
14 keni ndonjë arsye për ta kontestuar?

15 Z. ELLIS: [Përkthim] Sërish, kjo është një pyetje
16 tërësisht sugjestionuese nuk është kjo një pyetje që duhet të
17 bëhet nga paneli. Nëse ka ndonjë dëshmitar që ka dëshmi për
18 këtë atëherë ta thotë ky dëshmitar, po jo një person i cili
19 nuk ka dijeni në lidhje me këtë. Ky dëshmitar nuk ka thënë
20 asnjëherë që e ka thënë një gjë të tillë Bislim Zyrapi.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,
22 mund t'i përgjigjeni pyetjes.

23 DËSHMITARI: Unë me profesion nuk jam jurist, po mesa di
24 çështjet juridike shkojnë kësi lloj: Prokurori, domethënë,
25 nëse ka ndonjë vërejtje diçka i jepet Prokurorit informacioni,

1 Prokurori vlerëson a duhet a s' duhet personi i caktum të
2 arrestohet. Pastaj policia vepron me urdhër të Prokurorisë. E
3 jo ajo me qenë edhe Prokuror edhe ekzekutues në këtë rast.

4 E pastaj gjykata në rast se ka baza, respektivisht
5 gjyqtari, e konstaton a duhet të mbahet në paraburgim apo të
6 lirohet ose e kundërta për çështje dënimi. Pra, në këtë rast
7 nuk po e shoh që është përcjellë kjo vijë. Prandaj për mue po
8 më duket që ka shkelje. Po, megjithatë edhe një herë po e
9 përmendi, unë jam përgatit në këtë nivel. Dhe realisht nuk kam
10 të bëj me një dokument që nuk është i jemi, respektivisht po
11 flasim për një diçka që ka plot anomali.

12 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit.

13 Të flasim pak më shumë për këtë. Nga personat që u kthyen
14 bashkë me Blerim Kuqin nga Shqipëria në fillim të dhjetorit
15 1998, a ishin këta persona ose të paktën disa nga personat që
16 u kthyen me të, a ishin të njëjtët persona që u larguan me të
17 në shtator të 1998?

18 PË. Blerim Kuqi kur ka shku për në Shqipëri ka pas afër vetit
19 dy, tre persona, jo ma tepër. Edhe ata i ka pas shoqërues në
20 kuptimin e realizimit të rrugës, se rruga ka qenë -- nuk ka
21 qenë edhe aq e thjesht e të realizohej maleve të Pashtrikut.
22 Por kur është kthi, janë kthye 120 ushtarë dhe eprorë në fund
23 të nëntorit edhe në territorin e Suharekës kanë mbërrit pas
24 mesnate, domethënë, e datës më 1 dhjetor. A kufini është kalue
25 nga këto njësi me 28 nëntor. Pra, rrugëtimi i këtyne ushtarëve

1 që i përmendëm 120 ushtarëve ka zgjatë më 28 nëntor, 29, 30
2 nëntor dhe kanë arrit në territorin e Suharekës, me çka e
3 përmenda, në fund më datën 1 dhjetor menjëherë pas mesnate.

4 Domethënë, ka qenë një dimër që rrallë ndodhë dimra të
5 tillë, jashtëzakonisht dimër i ashpër, borë ka pas shumë.
6 Kështu që ata që kanë ardhë dinë me e spjegu edhe me e tregue
7 për peripetitë e problemet që i kanë pas në rrugëtim. Por,
8 vullneti i tyre i madh, sikurse i gjithë Ushtrisë Çlirimtare
9 të Kosovës ka qenë që me i përballue pengesat dhe problemet
10 dhe me dhanë kontributin për aq sa kanë pas mundësi dhe kanë
11 dit.

12 Prandaj edhe një herë po e përmendi, Blerim Kuqi në këtë
13 proces ka ndihmu çështjen nuk e ka pengu. Edhe tjetra. Pas
14 këtij momenti realisht Ministria e Mbrojtjes fillon me e
15 përkrah materialisht Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, e në
16 veçanti zonën operative të Pashtrikut, pavarësisht që brenda
17 zonës operative të Pashtrikut ka pas edhe brigada tjera që nuk
18 kanë qenë këta eprorë. Po megjithatë edhe diçka ndoshta vlen
19 me përmend, një numër i konsiderueshëm i këtyne eprorëve janë
20 shpërnda dhe kanë marrë detyra të ndryshme në të gjithë
21 Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës e jo vetëm në kuadër të
22 Brigadës 123 dhe në zonën operative të Pashtrikut.

23 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Mbase po ju bëj një pyetje
24 kështu. Po Sabit gashi a ka qenë ndonjë nga personat e tjerë
25 që u largua me Blerim Kuqin në shtator të 1998, nëse mund t'i

1 përgjigjeni më shkurt, ju lutem?

2 PË. Nuk e di.

3 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A e dini nëse ndonjë
4 person tjetër prej Blerim Kuqit që u largua në shtator të 1998
5 është ndjekur penalisht dhe është burgosur për dezertim?

6 PË. Nuk e di.

7 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Gjatë seancës përgatitore
8 javën e kaluar, kjo është reflektuar në Shënimin Përgatitor
9 numër 1, paragrafi 41, ju thatë që disa persona janë përpjekur
10 ta karakterizojnë Blerim Kuqin si bashkëpunëtor. A e dini se
11 mbi ç'baza i bënë këto pretendime këta persona?

12 PË. Nuk e di. Veç muj me dhënë me hamendje. Në bazë të
13 xhelozisë edhe kontributit që Blerim Kuqi ka dhënë. Shumë ma
14 shumë sesa ata të tjerët. Diçka tjetër këtu s'ka.

15 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do të doja që për sot të
16 përfundonim dhe me një grup pyetjesh të tjera.

17 Kemi marrë informacione që z. Kuqi është mbajtur i
18 ndaluar për një periudhë kohore në një burg në Kleçkë. Keni
19 dijeni për këtë?

20 PË. Që është ndalu e di. Po saktë ku ka qenë i ndalum nuk e
21 di. Unë në bazë të informacioneve dhe ato që kam fol kam
22 pretendu dhe respektivisht kam përmend që bëhet fjalë për
23 Fshat të Ri, por nuk jam i sigurt.

24 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Në fakt e kisha për
25 vendndodhjen, a ke pas dijeni që ai është mbajtur i ndaluar në

1 një burg në Kleçkë për një periudhë kohore?

2 PË. Nuk a që ka pas burg, po ka qenë i improvizum diçka, po
3 megjithatë saktë nuk e di. Nuk i di rrethanat.

4 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Kleçka nga pikëpamja
5 gjeografike është brenda zonës së Pashtrikut, apo jo?

6 PË. Po.

7 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe ky burgu, ju thatë një
8 objekt i improvizuar si burg nuk ka qenë nën komandën e zonës
9 së Pashtrikut, apo jo?

10 PË. Në Kleçkë ka qenë Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë
11 Çlirimtare të Kosovës. Ai ka rastis me qenë mbrenda zonës
12 operative të Pashtrikut po ka mujt me qenë edhe ndonjë zonë
13 tjetër Shtabi i Përgjithshëm. Po përveç asaj Shtabi i
14 Përgjithshëm e ka pas edhe një zyrë në Nishor.

15 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pra, a kuptoj unë siç
16 duhet, që burgu apo ky burgu i improvizuar ka qenë nën
17 autoritetin e Shtabit të Përgjithshëm apo po përpigëni të
18 thoni diçka tjetër?

19 PË. Z. Gjykatës, për mos me bë gabim. Kur po flasim për burg.
20 Nuk e di unë që ka pas burg. Po unë vetëm po e di që Blerim
21 Kuçi kur është ndalu edhe u ka qëndru me një objekt. E atë po
22 e quajmë na si dhoma, shka po di, paraburgimi, por megjithatë
23 për çështje burgu nuk di që ka pas në atë rajon.

24 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] E bëj pyetjen ndryshe.
25 Flasim dhoma ku është mbajtur i ndaluar, kjo dhoma ka qenë nën

1 përgjegjësinë e komandës së zonës apo ka qenë nën autoritetin
2 e dikujt tjetër sipas jush?

3 PË. Në autoritetin e Shtabit të Përgjithshëm, respektivisht
4 jo të zonës. Kaq muj me thënë.

5 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar, do
7 të duhet të ktheheni sërish nesër në orën 9.00. Do përpiqemi
8 të përfundojmë nesër shkurtimisht pas fillimit.

9 Tani mund të largoheni me Asistenten e sallës. Mos
10 harroni nuk duhet të flisni me askënd për dëshminë tuaj jashtë
11 sallës së gjyqit.

12 DËSHMITARI: Faleminders. Ditën e mirë.

13 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

14 Z. MISETIC: [Përkthim] I nderuar Kryegjykatës, kemi disa
15 gjëra për të trajtuar.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dhe ne kemi
17 disa gjëra për të trajtuar.

18 Kishit dy pika ju, z. Roberts, që deshët t'i trajtonit?

19 Z. TULLY: [Përkthim] Po, jam gati. Po unë shoh që këtu
20 Prokurori është z. Halling dhe nuk mendoj që z. Halling është
21 Prokurori i duhur për këtë, se nuk e ka trajtuar ai këtë
22 çështje.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Duhet ta
24 trajtojmë.

25 Z. TULLY: [Përkthim] E kuptoj po nuk është z. Halling

1 Prokurori i duhur. Unë mund ta bëj po do të duhet kohë.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

3 [Përkthim] Ju keni bërë një parashtrim me shkrim?

4 Z. TULLY: [Përkthim] Jo, jo, nuk ka lidhje me
5 parashtrimin me shkrim.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po flas për
7 parashtrimin e protokolluar 4846.

8 Z. TULLY: [Përkthim] Jo, ajo që dua të trajtoj unë nuk
9 lidhet me parashtrimin e protokolluar.

10 Dua të trajtoj diçka që është trajtuar *inter partes* mes
11 nesh dhe Prokurorisë. Janë dy aspekte që kanë dalë nga seanca
12 përgatitore.

13 Z. TULLY: [Përkthim] Prokurori në fakt i duhur donte që
14 ta trajtonte, megjithatë ne kemi dërguar dhe një email ku jemi
15 kundërpërgjigjur dhe në thelb ai është parashtrimi që kemi ne.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po ju janë
17 përgjigjur me shkrim atëherë.

18 Z. TULLY: [Përkthim] Okej atëherë.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A keni ju gjë
20 shtesë për të thënë?

21 Z. TULLY: [Përkthim] Doja të flisja me pretendimet e reja
22 që kanë dalë se emaili në vetvete nuk i përmban të plota.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar]

24 [Përkthim] Ju lutem trajtojeni me shkrim se s'mund të rrimë

25 një orë këtu për të trajtuar argumente juridike. Ju lutem bëni

1 parashtrimin me shkrim, ta kemi dhe ne gati deri nesër në orën
2 8.00.

3 Z. TULLY: [Përkthim] Në rregull. Për sa kohë do zgjidhet
4 kjo para se të vij dëshmitari i radhës.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të
6 zgjidhet.

7 Tani, z. Misetic.

8 Z. MISETIC: [Përkthim] Në rregull.

9 Kam dy pika, një në seancë publike. Më kanë thënë që një
10 dokument që ka përdorur Gjykatësi Mettraux që autor i të cilit
11 ka qenë Fatmir Limaj, ka një gabim në përkthimin me shkrim, ku
12 thuhet "Prokuroria kërkon të urdhërohet zbatimi i hetimeve",
13 është përkthyer gabim pra kjo.

14 Dhe përkthimi i duhur është që "Prokurorisë i është
15 kërkuar të urdhërojë zbatimin", sepse kjo është e rëndësishme
16 për sa i takon kuptimit.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do t'i
18 kërkojmë dhe përkthyesve me gojë të bëjnë verifikimin dhe të
19 na njoftojnë në lidhje me këtë.

20 Dhe të kalojmë në seancë private për aspektin e radhës.

21 Po ndërkohë ju kishit dhe një aspekt të 4445, z. Roberts?

22 Z. ROBERTS: [Përkthim] Po. Për këtë në fakt e kemi
23 trajtuar dhe unë doja t'ju informoja por kemi marrë një
24 informacion nga Prokuroria para gjysmë ore në lidhje me këtë.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

1 [Seancë private]

2 [Seancë private teksti i fshirë]

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19 [Seancë e hapur]

20 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,

21 jemi në seancë publike tani.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

23 E mbyllim seancën për sot do të takohemi përsëri nesër në

24 orën 9.00 të mëngjesit.

25 --- Seanca mbyllet në orën 16.36